**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE**
**2023**

| Nr. Rendor[1] | Data e kërkesës[2] | Objekti i kërkesës[3] | Data e përgjigjes[4] | Përgjigje[5] | Mënyra e përfundimit të kërkesës[6] | Tarifa[7] |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 19.12.2022 | BIRNI<br><br>Përshëndetje,<br><br>Së pari ju uroj të jeni mirë. Bashkëngjitur këtij e-maili gjeni një kërkesë për informacion. Shpresoj të kem mirëkuptimin tuaj dhe të kem një përgjigje në një kohë sa më të shpejtë.<br><br>Punë të mbarë,<br><br>Në bazë të ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Kushtetutës së Republikës së<br><br>Shqipërisë,kërkoj informacion për çështjet e mëposhtme:<br><br>1. Kur ka nisur dhe kur parashikohet që të përfundojë aksioni “Bregdeti ynë”, i cili parashikon lirimin e hapësirave të | 05.01.2023 | 1. Aksioni “Bregdeti Ynë” Ka filluar në Qershor 2021<br>2. Janë shembur 449 objekte. Prishja e objekteve në zonat bregdetare vijon dhështë pjesë e punës së IKMT-së, IMT-ve si dhe strukturave të tjera që ushtrojnë përgjegjësi dhe ndërveprojnë në këto zona. Ndërtimet e prishura deri tani kanë qenë pa leje me funksione shërbim: Social – Ekonomik.<br>3. Mungesa e lejes së ndërtimit, zona ku ndodhet në raport me pjesën e zhvilluar në tërësi të infrastukturës turistike e bregdetare.<br>4. Sipas ndryshimeve ligjore dhe udhëzimeve të përbashkëta në cdo rast i referohet Policisë së Shtetit e cila ndjek në vazhdim procedurën për cdo rast.<br>5. Referuar të dhënave arkivore | Deleguar IKMT DIBER | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | zaptuara në bregdet?2. Sa objekte (hotele, godina të braktisura, lokale etj.) janë shembur deri tani nga IKMT dhe sa parashikohen që të shemben deri në fund të këtij operacioni?3. Me çfarë rendi përzgjidhen objektet për t'u shembur (koha e ndërtimit, hapësira e zaptuar, mungesa e dokumentacionit për ndërtimin e godinave etj.)?4. Sa raste ka dërguar IKMT në prokurori, për hetime të mëtejshme për pronarët e godinave pa leje që kanë zaptuar në mënyrë të jashtëligjshme territor në bregdet?5. Sa punonjës të IKMT janë dërguar në prokurori për ndjekje penale, për moszbatimin e ligjit dhe lejimin e ndërtimit të godinave pa leje?6. Nëse është e mundur, dëshiroj të më vihet në dispozicion një listë e objekteve të shembura dhe me kohën kur janë shembur, në cilin muajt dhe në cilin vit?7. A ka pasur raste të shembjes së objekteve me leje për shkak të këtij operacioni | | të institucionit nuk na rezulton të ketë inspector të shkarkuar me motivacionin moszbatim të ligjit.<br>6. Shprehim pamundësi të vënies në dispozicion të një liste të objekteve të shëmbura në zonën, muajin, vitin, pasi është një proçes kompleks i cili përfshin disa struktura vendore dhe qëndrore.<br>7. Deri tani nuk ka asnjë rast të shëmbjeve të objekteve me leje ndërtimi. | | |
| 2 | 07.01.2023 | **Sami Kamberi**<br>Pershendetje! | | Përshëndetje! | | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Duke Ju falenderuar per korespondencen, doja te sqaroj dhe vertetoj, lidhur me e-mail e dt. 21 Nentor 2022 drejtuar Ju, nga Alfred Gjini.<br><br>1- Naim KAMBERI ( vellai im, polic ) ka ndertuar objekt dy katesh, mbi 120 m2 sip.nderimore, pa leje ndertimi, gjate vitit 2015, **perpara se te kryente rregjistrimet e tokes**, kur me deklaraten e dt. 13.12.2009 kane qene te percaktuara, te kufizuara ne terren :<br>* Rruga per te gjithe.<br>* Rruga per te shtepia ime<br>* Oborri i shtepise time.<br>dmth. 6 vite me pare se Naimi te ndertoj objektin ne fjale. | | Në lidhje me ankesën tuaj , institucioni jonë ka vijuar me ndjekjen e problematikës, në bashkëpunim me<br>IKMT Rajonale Qarku Dibër dhe nga Drejtoria është marrë përgjigjia si më poshtë.<br>Bashkangjitur keni email-et e ardhura nga Drejtoria Rajonale Dibër.<br><br>Bashkëlidhur gjendet foto e aplikimit për legalizimin e ndërtimit pa leje ,nr.aplikimi 13624, dt 07.10.2022.Objekt ky i ndërtuar para vitit 2015, ndërtim ekzistues .<br>Trualli (pemëtore) mbi te cilin është ndërtuar objekti disponon certikatë pronësie e cila gjendet e bashkëlidhur. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2- Topografi (Gjeodeti) ka kryer matjet per rregjistrimet kur objektet e mesiperme kane qene ekzistuese dhe jane shmangur duke mos i paraqitur ne dokumentacionin perkates, nuk jane prezantuar, duke manipuluar dhe prezantuar trullin si te lire.<br>( Nuk po futem ne tjera veprime te manipulumit, ne procesin e rregjistrimit)<br>3- Shkalla metalike e objektit projektohet horizintalisht brenda oborrit tim, ne anen fundore, duke me zvogluar oborrin me 5 m2 (si c'ju kam shpjeguar ne email e meparshem shoqeruar dhe me foto).<br>4- Oborri i shtepise time, me pjerrsi 8-9%, me ndertimin e stalles per lopet dhe magazines ne katin siper (bare, kashte e jonxhe | | Duke ju falenderuar dhe uruar punë të mbarë! | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | te thate), jo me larg se 50-60 cm me kufirin, me deren 2 m dhe hapsiren ne cati po nga ana e shtepise time, doli jashte perdorimit si efekt i ndotjes dhe shtepia rrezikohet nga zjarri.<br>Por duke pare tendencen e Naimit per te me zaptuar forcerisht siperfaqe te oborrit, ne dt. 20, 21 qershor 2022 kam filluar te rrethoj oborrin dhe rrugen time, ( pa prezencen time) me nje mur rrethus betoni, me gjersi 20 cm dhe lartesi max deri ne 1 m. ku nga 24 m rrethim u kryen vetem 3 m, gjithsej 2,5 - 3 m3 beton dhe jo shtese sic pretendohet (shif foton ne attach), dhe ky rrethim u nderpre forcerisht nga Naim KAMBERI ne dt. 22.06.2022 ne oren 07:00. | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 4- Ne jetojme jashte shtetit, gjate periudhes 17 Gusht deri 15 shtator qe kemi qene ne shtepine tone ne Zall Sopot, nuk kemi kryer asnje punim ndertimi, asnje cm3 llac apo beton, vetem pune bujqesore ne bacen tone dhe gjate jesaj periudhe ne dt. 6 dhe 12 shtator kane ardhur punonjesit e IMT-Bashkia Bulqize, zt. Spartak Zogu dhe Biordi Cupi te cilet ishim "paqsor" me objektin dy katesh pa leje,por me benin presion mua pse kam ndertuar rrethimin pa leje. Ata perkundrazi nuk mbajten asnje procedure, deri me dt.15.09.2022, kur ne u larguam nga Shqiperia.<br>5- Nga Drejtoria Rajonale Diber, objekti dy katesh stalle- magazine, ne kundershtim me cdo ligje dhe norme morale e te bashkjeteses ne | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | fis e vllazri, trajtohet si objekt i rendesise vecante qe nuk mund te procedohet, sepse nderkohe Naim KAMBERI ka te depozituar nje aplikim per legalizim<br>ne dt.07.10.2022, pikerisht 25 dite mbas ankeses time drejtuar Ju dhe mbas 7 viteve te ndertimit te ketij objekti.<br>Kur IMT- Bulqize ishte ne objekt (dt 06 shtator 2022 dhe 12 shtator 2022), un Ju kerkova te procedonin sipas ligjit 9780 (i ndryshuar dt 16/07/2007) dhe funksionit tyre!<br>Pse nuk mbajten procedure, kush i pengoi?<br>Punimet per rrethimin nuk u insprktuan dhe nuk u bllokuan nga shtetit me punonjesit e tij, por privatisht nga Naim KAMBERI, polic! | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 6- Babai im Sali KAMBERI eshte pronari i vetem qe me ka trasheguar shtepi, oborr, rruge, uje per vaditje dhe toke, qe pervec dokumentit me firmen e tij (dhe i firmosur nga te gjith tashegimtaret dhe perfaqesuesit e komunes Zerqan), per arsye te ligjit 7501 nuk kam mundur ti rregjistroj, deri tani, **por kjo nuk i jep te drejten askujt per ta zaptuar**.<br>7- Prej dt.13. 09.2022 deri me sot, nuk kam marre asnje pergjigje nga IMT Bulqize dhe Drejtoria Rajonale Diber, si ankues, me gjithe kerkesen e znj. Dallendyshe Bici ku u thote qe ti ktheni pergjigje dhe ankuesit!<br><br>Jam ne pritje te nje pergjigje zyrtare mbi ankesen ndaj Naim | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Kamberit per nderitmin pa leje, si e parashikon ligji.<br>Ju lutem te vini ne dijeni dhe znj. Dallendyshe Bici.<br><br>Me respekt Ing. Sami Kamberi (ish punonjes INUK Tirane). | | | | |
| 3 | 09.01.2023 | **IRVI HYKA**<br>Përshëndetje<br>Agjencia e Bashkëqeverisjes dhe IKMT,<br><br>Unë Irvi Hyka pas ankesave email të vazhdueshme akoma çështja nuk është zgjidhur pavarësisht se kanë kaluar shumë muaj. Nuk di çfarë të them, por<br>korrupsioni është shpërndarë si metastazë në gjithë hallkat e Bashkisë Durrës dhe për secilin kemi bërë kallëzim penal. | 27.01.2023 | Përshëndetje!<br><br>Në vijim të problematikës së përsëritur nga ana juaj, ju bëjmë me dije se shkresa zbatim ligjshmërie nr.614 Prot, datë 26.01.2023 është dërguar pranë IMT Bashkia Durrës për zgjidhjen e problematikës tuaj. Faleminderit. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Imagjinoni që një kryeinspektor IMT Bashkia Durrës ka kaq fuqi sa të shpërfilli drejtuesit e IKMT dhe madje edhe Këshillin e Ministrave.<br><br>SPAK e ka deleguar në Prokurorinë e Durrësit çështjen në ngarkim të shtetasit Dorjan Mema për veprën penale "Shpërdorim i detyrës" dhe zoti Dumani është shumë i saktë në shkresën që po bashkëngjis se ka përmendur Vendimin Nr. 66 datë 22.06.2022 për prishjen e ndërtimit pa leje.<br><br>Për shkak se IMT Durrës do të procedohet penalisht për këtë ngjarje kërkohet ndërhyrja e IKMT për: | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | <ul><li>rikthimin e çatisë së objektit në vendin e sajë;</li><li>prishjen e platformës së betonit në dyshemenë e kundërvajtësit Silvio Peqini;</li><li>heqjen e kapotës të vendosur nga ana e kundërvajtësit Silvio Peqini sepse cenon pronën tjetër ngjitur me godinën nr. 26 në rrugën Egnatia, në pronësi të familjes Hyka.</li></ul> | | | | |
| 4 | 10.01.2023 | **Eliza Gjediku**<br><br>Përshëndetje<br>Në vijim të kësaj përgjigje që me keni vënë në dispozicion, në bazë | 16.01.2023 | Përshëndetje!<br><br>Në vijim të kërkëses për informacion, ju bëjmë me dije se për pyetjen : | Deleguar IKMT Tirane | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | të ligjit për të drejtën e informimit kërkoj informacion mbi:<br><br>1- Sa është numri i ndërtimeve pa leje dhe i shtesave të kateve pa leje që janë identifikuar deri më tani nga IMT vendore? Në cilat qytete?<br><br>2- Sa është sipërfaqja në metër katror që keni identifikuar si ndërtim pa leje?<br><br>Të dyja këto pyetje ishin pjesë e kërkesës së parë për informacion mbi të cilat nuk kam një përgjigje. Bashkëlidhur gjeni edhe kërkesën e parë për informacion!<br><br>Faleminderit<br>Eliza Gjediku | | **1.Sa është numri i ndërtimeve pa leje dhe i shtesave të kateve pa leje që janë identifikuar deri më tani nga IMT Vendore? Në cilat Qytete?**<br>IKMT me qëllim zbatimin e VKM-së nr.589, datë 07.09.2022 po kryen veprimet përkatëse në drejtim të verifikimeve dhe marrjes së informacionit pranë autoriteteve vendore përkatëse të Planifikimit dhe Inspektimit, ky process është në vijim dhe për konkluzionet do të jepet informacion në bazë të ligjit për të Drejtën e Informimit.<br><br>**2. Sa është sipërfaqja në metër katror që keni identifikuar si ndërtim pa leje?** | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Nga Inspektimet e kryera dhe në zbatim tëVKM-së së cituar më sipër,  IKMT ka përcjell propozim për konfiskim për 25 objekte, ndaj të cilave nga ana e Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), është marrë një vendim për secilin object.Vendime të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të AZHT-së për secilin objekt me siperfaqet në tejkalim të lejes së ndërtimit. | | |
| 5 | 22.12.2022<br><br>11.01.2023 | **Naltor Metaj**<br><br>Pershendetje, struktura metalike eshte hequr por profilet e hekurit qe ishin mbajtese te struktures metalike jane te pahequra sikurse i shihni ne foto. Duke u bere shkak per nje rivendosje te ndonje strukture tjeter. Kerkoj zgjidhjen | 10.01.2023 | Përshëndetje!<br><br>Në vijim të ankesës tuaj, ju bëjmë me dije përgjigjen e ardhur nga IKMT Drejtoria Rajonale Tiranë.<br><br>Faleminderit për bashkëpunimin. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | shteruese te ketij problemi.<br>Faleminderit per bashkepunimin.<br><br>---Pershendetje, ju falenderoj per korrektesine dhe zgjidhjen e problemit. Pune te mbare | | -Përshëndetje,<br><br>Në vijim të korrespondencës, lidhur me ankesën e z. Naltor Metaj, për mosheqje<br>të profileve anësorë të hekurit, duke u bërë shkak për një rivendosje sipas pretendimeve të ankuesit, ju bëjmë me dije se:<br>Inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tiranë, pas kontaktit të marrë me subjektin, vendosën që këto profile hekuri të hiqeshin nga vetë subjekti në mënyrë vullnetare, në prezencën e Inspektorëve. | | |
| 6 | 20.12.2022 | **Deshira Mena**<br>Pershendetje. | | Përshëndetje, | Deleguar DR.Mjedisit | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 13.01.2023 | Faleminderit per materialin e derguar por me duhet te ve ne dukje qe problemi yne si banore te Kompleksit Alb Adriatik nuk eshte shqyrtuar ne konteksin qe ne e kemi shtruar. Na keni vene ne dispozicion lejen e ndertimit te Pallati te investitorit LTE Invest, nderkohe qe duhet te na kishit vene ne dispozicion Lejen e ndertimit te **Kompleskit Alb Adriatik ne te cilin NE banojme**, dhe kjo eshte zanafilla e shqetesimit tone. Sic e kemi shprehur ne ankesen tone ka mbivendosje te Lejeve te ndertimit, dhe materiali qe keni derguar nuk e ezauron kete problem per sa kohe nuk kemi Lejen e Kompleksit per te cilen NE si banore kerkojme te jemi ne | | Në vijim të korrespondecës sonë, në lidhje me ndërtimin e një pallati brenda kompleksit “ALB- Adriatik”, Golem, Kavajë, siç ju kemi informuar dhe më parë, IKMT në ushtrim të detyrave të përcaktuara në Ligjin Nr.9780 datë 16.07.2007, “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme“, i ndryshuar, ka kryer inspektime në terren nga ku ka konstatuar ‘’Objekt me Leje Ndërtimi me Nr.3950, datë 05.10.2022’’, për **’’RIDIMENSIONIM PLAN VENDOSJE PËR OBJEKTIN STRUKTURË TURISTIKE 5KT + PAPAFINGO ME BODRUM + PISHINË’’,** lëshuar nga Bashkia Kavajë. | (24.01.2023) | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dijeni si nje e drejte qe na takon.<br>Keto materiale qe keni derguar ne i kishim dhe jua derguam edhe ju per verifikim, por ato nuk bejne gje tjeter vetem se theksojne qe shqetesimi yne eshte  i drejte.<br>Per dijeni po ju ve ne dispozicion edhe njehere materialet qe ju kemi derguar ne te cilen shikohet qarte qe ka mbivendosje te Lejeve te ndertimit, pra mbi nje prone qe eshte dhene leja me pare nuk mund te kete edhe nje leje te dyte ndertimi. NA materialin bashkangjitur dallohet qarte me ngjyre te kuqe kufiri i prones se Lejes Alb Adriatik dhe me ngjyre blu kufiri i perdorur per lejen LTE Invest. A mund te qendrojne keto dy leje ndertimi njesoj te vlefshme dhe te ligjshme? Si eshte dhene koeficenti i shfrytezimit per | | Lidhur me kërkesën tuaj, për vënie në dispozicion të Lejes së mëparshme të Ndërtimit, ju bëjmë me dije se:<br>Institucioni jonë nuk e disponon këtë Leje.<br>Për sa më sipër, lutemi t’i drejtoheni organeve kompetente.<br><br>Bashkëlidhur gjenden kopje të dokumentacionit që ne disponojmë. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ndertim ne Lejen Alb Adriatik dhe si eshte dhene ne Lejen LTE Invest ? A jane konsideruar keto koeficente ne te dyja lejet pa ndikuar ne njera tjetren ? Ju lutem na vini ne dispozicion Lejen e nderitimit me kufirin e sakte per Kompleksion Alb Adriatik dhe Inspektoret qe vijne per verfikim duhet te marrin kontakt jo vetem me firmen ndertuese por me Banoret e Kompleksit te cilet kane ngritur shqetesimin.<br>Ne pritje te reagimit tuaj te menjehershem.<br><br>Me respekt Deshira Mena<br>Ne emer te banoreve te Kompleksit Alb Adriatik.<br>--ershendetje. | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Jemi ne pritje te informimit tuaj lidhur me ankesen tone te shprehur ne emalin e dt 03.12.2022 si dhe ne emailin e dates 20.12.2022, per te cilet nuk kemi marre pergjigje sipas kerkeses sone.<br>Ju lutem na vini ne dipozicion lejen e ndertimit te Kompleksit Alb-Adriatik leje e cila zbardh edhe situaten e krijuar me ndertimin e pallatit brenda prones se Kompleksit.<br>Ky email eshte edhe nje ankese drejtuar Zyres se Komisionerit per te drejten e Informimit per te konsideruar shqetesimin tone dhe te ndihmoje ne marrjen e pergjigjes se kerkuar si nje e drejte qe na takon. | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Faleminderit paraprakisht. | | | | |
| 7 | 24.01.2023 | **Arta Çano** (Gentjana Zallumi IQ)<br>Përshëndetje.<br>Pranë Inspektoratit Qendror është administruar në formë elektronike kërkesa për informacion e Znj. Arta Çano, korrespondente e BIRN Albania, e cila kërkon informacion nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, si më poshtë:<br><br>1. Sa inspektime ka kryer IKMT apo dega juaj rajonale, në Parkun Kombëtar të Tomorrit gjatë viteve 2020, 2021, 2022? Kanë qenë inspektime në bazë të një kalendari, apo të | 02.02.2023 | Përshëndetje!<br><br>Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije informacionin e ardhur si më poshtë.<br>Faleminderit për bashkëpunimin!<br><br>IKMT ka kryer inspektime në Parkun Kombëtar të Tomorrit gjatë viteve të fundit. Këto inspektime kanë qënë inspektime të planifikuara dhe të paplanifikuara. Inspektime kur ka pasur indicie të ardhura nga qytetarët, ose informacione në rrugë operative, nga policia etj. Në mungesë të kërkesave për bashkëpunim nuk ka patur | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | njoftimeve të caktuara? Ju lutem specifikoni rastet përkatëse dhe nga vinin njoftimet?<br>2. Procesverbalet e mbajtura gjatë këtyre inspektimeve.<br>3. Çfarë masash ka marrë IKMT ndaj shkelësve për aktivitetin e guroreve, 3 vitet e fundit. Dokumentet përkatëse.<br><br>Në zbatim të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", bashkëngjitur gjeni kërkesën për informacion.<br>Faleminderit.<br>Genta | | edhe urdhër pune për inspektim me qëllim evidentimin e shfrytëzimit pa kriter dhe në mënyrë të paligjshme në malin e Tomorrit. Në malin e Tomorrit nuk ka karriera që ushtrojnë aktivitet pasi Tomorri është një zonë e mbrojtur.<br>Për sa i takon në rang qarku, bazuar në kërkesa të mëparshme për bashkëpunim të AKBN dhe AKM, është ngritur grupi i punës në IKMT dhe janë marrë 3 masa administrative për Dënim me Gjobë, me vlerë totale 2 300 000 lekë, bazuar në ligjin Nr. 10 448, datë 14.7.2011, PËR LEJET E MJEDISIT. dhe ligjit Nr. 10 463 date 22.09.2011, PËR MENAXHIMIN E | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | INTEGRUAR TË MBETJEVE.<br>Njëkohesisht, mbetemi në dispozicion për bashkëpunim, me qëllim mbrojtjen e mjedisit.<br>**Drejtoria Rajonale Berat** ka kryer 3 inspektime për vitin 2020 , në fondin pyjor dhe atë kullosor në Parkun Kombëtar Tomorr.<br>Për vitin 2021, janë kryer 11 inspektime në fondin<br>pyjor dhe kullosor , gjuetisë si dhe në monitorimin e zjarreve.<br>Për vitin 2022, janë kryer 11 inspektime në fondin pyjor e kullosor, gjuetisë dhe në monitorimin e zjarreve.<br>*Ç*do muaj nga ana e AdZM Berat, na jepet informacion për gjendjen e fondit pyjor e kullosor si dhe kundravajtje | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | administrative , pasi AdZM ka në administrim Parkun Kombëtar Tomorr. Nga Sektori i Mjedisit, janë ushtruar inspektime të herëpashershme në bashkëpunim me Qëndrorin, nga ku nuk janë konstatuar shkelje.Kjo zonë është e bllokuar nga Policia e Shtetit për ushtrimin e aktivitetit. | | |
| 8 | | **Dashamir Gega**<br><br>Lënda: **Kundërshtim i Vendimit** Përfundimtar i Inspektimit të degës rajonale Elbasan. Drejtuar:Komisionit të Ankimimit të Inspektoriatit Kombëtar i Mbrojtjes Teritorit. Subjekti “Shebeniku-G” me NIPT K98220601B dhe adresë : | 25.01.2023 | Përshëndetje!<br><br>Në vijim të ankesës tuaj, ju bëjmë me dije se brenda afateve ligjore, ju duhet të bëni një kërkesë/ankesë me shkrim dorë pranë Komisionit të Shqytimit të Ankimeve Administrative, që ndodhet | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Lunik,Lagja Lugjet,rruga LunikLibrazhd,Impianti i përpunimit të kuacit Lunik,bashkia Librazhd me administrator: Inxh gjeolog Dashamir Gega ka qenë objekt kontrolli nga IKMT të qarkut Elbasan me dt 29/12/2022 me objekt: Inspektim të aktivitetit privat të subjektit. Grupi i Inspektimit të IKMT të degës rajonale Elbasan ka vendosur subjektit : | | pranë Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.<br><br>Faleminderit për bashkëpunimin. | | |
| 9 | 30.01.2023 | **Neki Frasheri**<br><br>Pershendetje.<br><br>Interesohem per te kontaktuar me Degen e IKMT ne Korce. Duhet te sinjalizoj per rezikun e nje nderhyrje jo legale ne nje banese private. Eshte e mundur te | 30.01.2023 | Përshëndetje!<br><br>Ankesën tuaj mund t'a dërgoni në këtë adresë e-maili.<br>Më pas, institucioni jonë ia delegon ankesën tuaj IKMT Drejtoria Rajonale Korçë. | Deleguar Mjedisit (06.02.2023) | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | komunikoj me kete zyre edhe me email?<br>Faleminderit<br>Neki Frasheri | | Faleminderit për bashkëpunimin. | | |
| 10 | 06.02.2023 | **Armand Kullau**<br><br>Në bazë të ligjit nr. 119/2014 për të drejtën e informimit, kërkojmë si informacion:<br>1. Sa subjekte janë gjobitur nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit për shkarkimin e ujërave të ndotura në bregdetin e bashkive Shkodër, Kurbin, Lezhë, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë,<br><br>Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë dhe Sarandë për vitin 2019?<br>2. Sa subjekte janë gjobitur nga Inspektoriati Kombëtar i | 17.02.2023 | Përshëndetje!<br><br>Pasi u njohëm me kërkesën tuaj, dërguar me e-mail pranë Drejtorisë së Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave në datën 06.02.2023, ku ju kërkoni:<br><br>1.Sa subjekte janë gjobitur nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit për shkarkimin e ujërave të ndotura në bregdetin e bashkive Shkodër, Kurbin, Lezhë, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë,Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë dhe Sarandë për | Deleguar Ikmt vlore (07.02.2023) | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Mbrojtjes së Territorit për shkarkimin e ujërave të ndotura në bregdetin e bashkive Shkodër, Kurbin, Lezhë, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë dhe Sarandë për vitin 2020?<br>3. Sa subjekte janë gjobitur nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit për shkarkimin e ujërave të ndotura në bregdetin e bashkive Shkodër, Kurbin, Lezhë, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë dhe Sarandë për vitin 2021?<br>4. Sa subjekte janë gjobitur nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit për shkarkimin e ujërave të ndotura në bregdetin e bashkive Shkodër, Kurbin, Lezhë, Durrës, Kavajë, | | vitin 2019, 2020, 2021dhe 2022.<br><br>Kjo kërkesë ju delegua Drejtorive Rajonale përkatëse dhe bashkëlidhur keni përgjigjet e tyre.<br><br>Drejtoria Rajonale **Durrës**<br><br>Përshëndetje,<br><br>Përsa i përket shkarkimeve të ujërave të ndotura në bregdetin që përfshin Bashkinë Durrës, nga kontrollet e kryera nga ana e inspektorëve përpara sezoneve turistike, është konstatuar se subjektet janë të pajisura me gropa septike dhe me kanalizime të rregullta me Ujësjellës Kanalizime Durrës. Nisur nga fakti që nuk janë | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë dhe Sarandë për vitin 2022?<br>5. Listën e plotë me subjektet e gjobitura për vitin 2019 nga IKMT-ja.<br>6. Listën e plotë me subjektet e gjobitura për vitin 2020 nga IKMT-ja.<br>7. Listën e plotë me subjektet e gjobitura për vitin 2021 nga IKMT-ja.<br>8. Listën e plotë me subjektet e gjobitura për vitin 2022 nga IKMT-ja.<br><br>Ju faleminderit për vëmendjen! | | konstatuar shkarkime apo ndotje të ujërave, nuk janë marrë masa administrative ndaj subjekteve të kontrolluara gjatë vitit 2020, 2021 dhe 2022.<br><br>Duke iu uruar punë të mbarë,<br>IKMT Durrës.<br><br>Drejtoria Rajonale **Vlorë**<br><br>Përshëndetje!<br><br>Nuk ka patur marrje masash administrative lidhur me ujërat e ndotura.<br><br>Drejtoria Rajonale **Lezhë**<br><br>Përshëndetje! | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Në përgjigje të e-mailit tuaj “Kërkesë për informacion”, ju informojmë se:<br><br>IKMT,Drejtoria Rajonale Lezhë ka filluar të ushtrojë aktivitet në Korrik të vitit 2020, në zbatim të VKM nr.893, datë 4.11.2015 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit”,(Ndryshuar me VKM nr. 513, datë 1.7.2020, nr. 606, datë 29.7.2020).<br><br>Gjatë kësaj periudhe, Sektori i Inspektimit, Mjedisit dhe Ujërave, në përputhje me Planet e Punës të miratuara, ka ushtruar inspektime në fusha dhe aktivitete të caktuara.<br>Në muajin Maj 2022, jemi | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | përfshirë në sistemin online “e-inspektime”, në zbatim të ligjit Nr.10443, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Krahas inspektimeve të programuara përgjatë sezonit turistik veror, nga ana jonë është bërë edhe monitorimi i zonës bregdetare, për të evidentuar shkarkimet e ujërave të përdorura nga subjekte të ndryshme tregtare. Theksojmë se zona nga Porti Detar Shëngjin deri në afërsi të zonës së Kunes, ka rrjet të kanalizimeve të ujërave të zeza, të cilat shkarkohen në Impiantin e Ujërave të Përdorura në Lagjen Sake. Aksi nga Porti deri te Rana e Hedhur, ujërat e përdorura | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | depozitohen në gropa septike dhe tërhiqen nga subjekte të licensuara. E njëjta situatë paraqitet edhe në Plazhin e Tales, ku nuk ka rrjet të shkarkimeve të Ujërave të Zeza.<br>Nga monitorimet që kemi bërë, nuk kemi konstatuar shkarkime në sipërfaqe të ujërave të përdorura dhe nuk kemi patur asnjë indicie nga ente shtetërore apo subjekte private. Nga ana jonë nuk kemi vendosur asnjë sanksion për asnjë subjekt.<br><br>Drejtoria Rajonale **Shkodër**<br><br>Përshëndetje!<br><br>Në përgjigje të e-mailit tuaj, ku kërkohet informacion se sa | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | subjekte janë gjobitur nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Drejtoria Rajonale Shkodër, për shkarkimin e ujërave të ndotura në bregdetin e Bashkisë Shkodër për vitet 2019, 2020, 2021, 2022, ju bëjmë me dije se:<br><br>Nga ana e institucionit tonë nuk janë konstatuar raste të shkarkimeve të ujërave të ndotura. Si rrjedhojë nuk janë mbajtur procedura administrative.<br><br>Faleminderit,<br>IKMT Shkodër.<br><br>Drejtoria Rajonale **Fier** | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Kthim përgjigje.<br><br>IKMT Drejtoria Rajonale Fier , për vitet e kërkuara 2019-2020-2021-2022, nuk ka marrë asnjë masë adminsitrative për shkarkimin e ujërave të ndotura në vijën bregdetare të Bashkisë Fier dhe vijën bregdetare të Bashkisë Divjakë. Subjektet që ushtrojnë aktivitet në keto vija bregdetare janë subjekte që ushtrojnë aktivitetin si stacione plazhi sezonale. | | |
| 11 | 07.02.2023<br><br>08.02.2023 | **Altin Xhaferaj**<br>Pershendetje.. Jam nje qytetar nga vlora jetoj ne Itali, ne Vlore banojn prindit e mi<br>Lefter Xhaferaj kane nje shtepi private te rrethuar me mur dhe ndodhet ne rajonin n5 rruga | 08.02.2023 | Përshëndetje!<br>Në vijim të ankesës tuaj, ju bëjmë me dije përgjigjen e ardhur nga IKMT Vlorë.<br>Ju lutem, dërgoni dokumetacionin tuaj pranë IMT Bashkia Vlorë. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | transballkanike ngjitur me karburant kastrati. Shtepia dhe trualli eshte e pajisur me certifikate pronesie..<br>Sot paradite prezantohet tek shtepia nje punonjes i ikmt Vlore pa asnje lloj dokumenti dhe duke bere presion tek prindit per prishjen e murit rrethues duke u arsyetuar se muri eshte pa leje ,gje qe nuk eshte e vertet sepse ky mur eshte ndertuar ne vitin 91 bashke me shtepin dhe jane legalizuar ne vitin 2014.<br>E gjitha kjo nderhyrje prej ikmt Vlore kryhet ne menyre korruptive dhe ne sherbim te nje eksponenti te njohur ne vlore qe quhet Julian Metushi ,ky person u bene presion prinderve per tu grabitur truallin ne cfardo lloj menyre ,kemi 6 vite qe jemi ne | | Faleminderit për bashkëpunimin.<br><br>-Përshëndetje!<br>Në lidhje me ankesën e deleguar nga ana juaj për problematikën e Z. Altin Xhaferraj , ju bëjmë me dije se nga ana e institucionit tonë I.K.M.T Dega Vlorë, nuk është kryer asnjë inspektim.<br>Nga komunikimi me Z. Xhaferraj, na është bërë me dije se inspektimi është kryer nga I.M.T Bashkia Vlorë. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | proces gjyqesor per servitut sepse ky eksponent na e ka hequr me forcen e ikmt vlore, tani ikmt kerkojn te prishin murin per ti plotesuar deshiren te fortit e vlores.<br>Ju lutemi verifikoni kete padrejtesi qe po na behet per perfitime korruptive nga ikmt Vlore .<br>Faleminderit.<br>Watcap 00393292853795<br>--Faleminderit per pergjigjen e menjehershme nga institucioni juaj gjithashtu me ka kontaktuar me telefon edhe dega juaj e vlores,,ju kerkoj ndjes per ankesen e ikmt vlore por realisht ka qene punonjes I imt bashkia vlore,, prindit e mi jane pleq dhe ma komunikuan gabimisht institucionin tuaj. Faleminderit | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 12 | 10.02.2023 | **Mimoza Picari**<br>Pershendetje! Jam Mimoza Picari gazetare nga Zeri i Amerikes. Jam e interesuar te di sa objekte jane konfiskuar bazuar ne vendimin e qeverise se shtatorit 2022, ne lidhje me ndertimet pa leje per qellim fitimi. Dhe nese mundeni, kujt insitutcioni i jane derguar materialet per vijimin e procedures.<br>Me Konsiderate Mimoza Picari.<br>-Nje saktesim rreth kerkeses se meparshme, sa objekte jane konstatuar ne terren ne kundershtim me vkm e shtatorit 2022<br>--Pershendetje serish! Une po mbyll materialin dhe doja te isha e sigurt nese IKMT mund te jape nje pergjigje dhe mbi nje moment tjeter qe do trajtoj, ate se cfare | 10.02.2023<br>15.02.2023 | Përshëndetje,<br>Në lidhje me kërkesën tuaj, ju bëjmë me dije si më poshtë: Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit në zbatim të V.K.M-së Nr.589, datë 07.09.2022 "Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi", pas kontrollit të ushtruar për verifikimin e zbatimit të lejes së ndërtimit pranë subjekteve ndërtuese, ka konstatuar dhe ka përcjellë dokumentacionin përkatës pranë Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, e cila është në cilësinë e sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit, për 25 subjekte | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ndodh me qytetaret qe kane blere apartamente apo njesi sherbimi me kontrate porosie, sipemarrje apo premtim shitje ne objektet e konfiskuara. A jane investimet e tyre te mbrojtura. Edhe perse verbalisht m'u me me dije qe kjo nuk eshte kompetence e IKMT per te qene korrekt vendosa t'ju shkruaj.undershtim me vkm e shtatorit 2022. | | ndërtuese të cilat kanë kryer sipërfaqe shtesë në shkelje të kushteve të lejes së miratuar.<br>Për këto 25 objekte, nga ana e Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT) janë miratuar Vendimet në kuadër të procedurës së konfiskimit për interes publik, të sipërfaqeve të objekteve të ndërtuar në tejkalim të lejes së ndërtimit të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të AZHT-së.<br><br>Ju urojmë ditë të mbarë!<br><br><br><br><br>¯Përshëndetje!<br>Në lidhje me kërkesën tuaj, mbi atë se “çfarë ndodh me qytetarët që kanë blerë | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | apartamente apo njësi shërbimi me kontratë porosie, sipëmarrje apo premtim shitje në objektet e konfiskuara" , ju bëjmë me dije se IKMT nuk mund të shprehet në lidhje me kërkesën tuaj.<br>Referuar ligjit nr. 107/2014 ''Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit''<br>dhe V.K.M-së Nr.589, datë 07.09.2022 "Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi, **"*Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit konstaton sipërfaqe ndërtimore në shkelje të lejes së ndërtimit, si dhe bën propozimin pranë Agjencisë së Zhvillimit të Territorit.*** | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Faleminderit! | | |
| 13 | 21.02.2023 | **Bleona Metushi**<br>Përshëndetje! Unë e nënshkruara Bleona Metushi, gazetare në Tv Klan, në kuadër të detyrës dhe bazuar në ligjin për të drejtën për informim, kërkoj informacion nga IKMT si më poshtë vijon:<br><br>1. Sa vendime sekuestrimi janë marrë në kuadër të VKM-s Nr 589 datë 07.09.2022?<br>2. Cilat janë këto vendime dhe ju lutem më vini në dispozicion ato?<br>3. A ka pasur raste kur vendimet e sekuestrimit në kuadër të kësaj VKM-je, janë kundërshtuar në gjykatë?<br>4. Nëse po, a është dhënë vendim që ka liruar nga sekuestro ndonjë nga objektet dhe cilin? | 27.02.2023 | Përshëndetje,<br><br>Në lidhje me kërkesën tuaj për dy pyetjet e para, ju bëjmë me dije si më poshtë:<br>Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit në zbatim të V.K.M-së Nr.589, datë 07.09.2022 “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”, pas kontrollit të ushtruar për verifikimin e zbatimit të lejes së ndërtimit pranë subjekteve ndërtuese, ka konstatuar dhe ka përcjellë dokumentacionin përkatës pranë Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, e cila është në cilësinë e sekretariatit | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Faleminderit paraprakisht!<br>Bleona Metushi, gazetare Tv Klan | | teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit, për 25 subjekte ndërtuese të cilat kanë kryer sipërfaqe shtesë në shkelje të kushteve të lejes së miratuar.<br>Për këto 25 objekte, nga ana e Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT) janë miratuar Vendimet në kuadër të procedurës së konfiskimit për interes publik, të sipërfaqeve të objekteve të ndërtuar në tejkalim të lejes së ndërtimit të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të AZHT-së.<br>Për sa i përket pyetjes "*A ka pasur raste kur vendimet e sekuestrimit në kuadër të kësaj VKM-je, janë kundërshtuar në gjykatë?*" ;<br>Ju informojmë se proceset gjyqësore janë të hapura për | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | publikun dhe ka raste që janë kundërshtuar.<br>Përsa i përket pyetjes "*A është dhënë vendim që ka liruar nga sekuestro ndonjë nga objektet dhe cilin*?" ;<br>Deri më tani nuk ka vendime të formës së prerë të ardhur nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë.<br><br>Ju urojmë ditë të mbarë! | | |
| 14 | 07.03.2023 | **Besian Leli**<br>Drejtuar: Z/nj Besjona Cenaj !<br>Ankes , në Fshatin Vllahine Bashkia Selenicës Vlore ne hyrje te fshatit Vllahine 200 metra krahu majte rrethe 20 metra mbi Gjimnazin Mynyre Xhindi Vllahine behet fjal per nje ndertim pa lejen ne prone Publike para pallateve ku jan disa qytetare qe | | Përshëndetje!<br><br>Në vijim të ankesës tuaj, ju bëjmë me dije se IKMT Drejtoria Rajonale Vlorë, ka dërguar shkresën për kompetencë, me nr. 144, Prot. datë 09.03.2023, pranë Bashkisë Selenicë. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ju është hequr e drejta e lirisë, ky ndertim eshte nje mure rrethus 15 metra i gjatë edhe 5 metra i gjer më lartësi 2 metra eshte ber nga shtetasi gezim mucaj. Gëzimi Mucaj ka ber si një lulishte me mbas nga brenda Lulishtes ka ber murin per interesat e tij personale përfitime e tijë personale duhet me patjeter te hiqet menjëherë lulishtja nga aty edhe prishja e mureve pa leje përkatëse duke ndjekur penalisht nga O.P.GJ e IKMT por jo kaq heqjen e lires te fëmijve edhe familjarëve se ju ka zen frymën qytetarëve. Por kam besim nga ana juaj qe puna do behet paansi trasparente sepse Gezim Mucaj mendon se ka miqe edhe nuk ja ndjen fare per njeri. Faleminderit për | | Në momentin e marrjes së një përgjigjeje, do të njoftoheni në vijim.<br><br>Faleminderit. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | mirëkuptim. Mbetemi Anonim ju lutem! | | | | |
| 15 | 09.03.2023 | **Erion Mesi**<br><br>Përshëndetje Besjona,<br><br>Të lutem më ndihmo për të gjetur përkufizimin zyrtarë të fjalës "gjurmë" dhe çfarë nënkupton ajo për IKMT-në?<br><br>E kuptoj që IKMT ka krijuar koefiçientin për gjurmën e bazamentit të një objecti në lidhje me sipërfaqen e pronësisë të truallit.<br><br>Dua të dij specifikisht nëse këto situata llogariten në "gjurmën" e objektit: | 13.04.2023 | Përshëndetje!<br><br>Pasi u njohëm me të gjitha kërkesat tuaja, ju bëjmë me dije se këto kërkesa nuk janë pjesë dhe kompetencë e IKMT-së.<br><br>Për të marrë informacionin e kërkuar, ju lutemi të drejtoheni pranë Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, pranë insitituconit të Bashkisë.<br><br>Faleminderit. | Deleguar IKMT Elbasan | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1. Ballkonet në katin e dytë dhe në katet më sipër?<br><br>2. Ballkonet me kolona për suport?<br>A) Llogaritet sipërfaqja e kolonave që zë në tokë?<br>B) Llogaritet sipërfaqja projeksion e ballkonit të suportuar nga kolonat?<br><br>3. A Llogaritet në gjurmë Konsuli në object?<br>C) Llogaritet sipërfaqja e Konsul-it PA kolona?<br>D) Llogariten sipërfaqja e Konsul-it me kolona?<br>E) Llogariten vetëm sipërfaqja e kolonave që mbajnë Konsul-in?<br><br>4. A llogaritet sipërfaqja në "gjurmë" e një tuneli mes dy | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | objekteve, pra objekteve në form H?<br>F) Llogaritet sipërfaqja e tunelit që nuk ka kolona mbajtëse?<br>G) Llogaritet sipërfaqja e tunelit pavarësisht nëse ka kolona mbajtëse?<br>H) Llogaritet vetëm sipërfaqja e kolonave që mbajnë tunelin?<br><br>5, Si llogaritet gjurma në qoftë se i gjith kati pëdhe është me kolona (pra hapësirë, pa mure)?<br><br>Dhe pyetja e fundit:<br><br>Nëse NUK llogariten sipërfaqet që NUK prekin tokën, sa centimetra larg/lart tokës mund të ndërtohet para se të llogaritet në "gjurmë"? | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Faleminderit,<br>Me respekt<br>Erion Mesi | | | | |
| 16 | 12.03.2023 | **Renato Leka**<br>Pershendetje<br>Shpresoj qe ky e-mail tju gjej mire!<br>Quhem Renato Leka nga Librazhdi dhe arsyeja qe po ju shkruaj eshte sepse do te doja me shum informacion se cfar hapash duhet te ndjek per te ber nje denoncim mbi nje ndertim qe po kryhet ne tok shtet ( qe gjithashtu eshte rruga ku un mund te shkoj ne token time) per te cilen un mendoj se eshte pa leje.<br><br>Sic e permenda me lart toka ku po ndertohet eshte tok shtet dhe e vetmja mundesi qe un te aksesoj | 12.03.2023<br>21.03.2023 | Përshëndetje!<br><br>Ju lutem të dërgoni adresën ku ndodhet toka.Më pas ne do t'ia dërgojmë atë Drejtorisë Rajonale IKMT përkatese . Faleminderit per bashkëpunimin.<br><br>- Përshëndetje!<br>Në përgjigje të e-mailit tuaj dhe për zgjidhjen e ankesës në fjalë, kemi nisur shkresën me Lëndë: "Per Kompetencë, IMT Bashkia Librazhd", ku i | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | token time si me makin ashtu dhe ne kemb.<br><br>Dy vite me perpara personi hodhi themelet dhe pas denoncimit tonë IMT Librazhd njoftoi te ndaloj punimet dhe te prish themelet.<br><br>Me posht do gjeni dhe disa foto te tokes ku po ndertohet dhe te objektit qe po ndertohet.<br><br>Gjithashtu keto jan kordinatat e tokes ne google map :<br>(41.1945213,<br>20.3164277) 58V8+RH3 Librazhd<br><br>Shpresoj te marr nje pergjigje sa me par<br><br>Ju falenderoj<br>Renato Leka | | kerkojmë të kryhen procedurat sipas ligjit.<br>Menjëherë sapo bashkia të na vë në dispozicion informacionin në lidhje me këtë ankesë, do t'ju njoftojmë.<br>Bashkëlidhur po ju dërgojmë shkresën.<br><br>Duke ju falenderuar për bashkëpunimin. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 17 | 13.03.2023 | Duke uruar të jeni mirë, po Ju shkruajmë për t'Ju dërguar informacionin e mëposhtëm për mundësi studimi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në nivelin Master. https://mip-aadf.org/master/master/ Programi Master dhe Internship (MIP) është krijuar në vitin 2016 nga Fondacioni Shqiptaro–Amerikan për Zhvillim (AADF), për t'u ofruar profesionistëve të rinj dhe me potencial lidershipi, mundësi studimi në nivel Master në SHBA. AADF ka lidhur partneritet me American Councils for International Education e cila ndihmon gjatë fazës së përzgjedhjes së | | Deleguar Burimeve Njerëzore | Deleguar IKMT Tirana | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | aplikantëve, identifikon universitetet në SHBA sipas programit të studimit përzgjedhur nga kandidatët, si edhe asiston të përzgjedhurit gjatë studimeve në SHBA duke monitoruar ecurinë e tyre akademik.<br>Ky program bashkëfinancohet nga Fondacioni Biberaj, themeluar në SHBA.<br>Do ta vlerësonim shumë nëse do t’ua përcillnit këtë informacion punonjësve Tuaj që mund të jenë të interesuar. Afati i aplikimit është 31 mars 2023.<br><br>Me respekt<br>Linda | | | | |
| | | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 18 | 13.03.2023 | Pershendetje!<br>Jame nje banore ne zonen e freskut,<br>Prane rruges xhon Belushi, pallati gjitur me palestren Premium.<br>Nje person qe ka blere dyqanet poshte atij pallati ben punime pa leje .<br>Ne shkalla e pallatit ka nderhyr ne projekt ne bordure duke na shkaktuar pluhur,jemi ber te telefonojm medjat pasi asnje drejtori shteterore se kontrollon ate njeri i cili quhet Gurim Jaho (Ish Polic)na shqetson nga 2 jave me zhurmen e tepert pluhurin dhe ndenjuren para deres kryesore te ketij pallati.Institucioni duhet te nderhyje ne ndalimin e punimeve pasi realisht po e tepron,plus e | | Konkluzione:<br><br>· Pas shyrtimit të dokumentacionit ardhur nga IMT Bashkia Tiranë, Nr.Prot. 3395/1, Dt.12.04.2023, e cila na ka vënë në dispozicion:<br><br>· Proces verbal me Nr. 5228, datë 31.10.2022<br><br>· Vendim Nr. 4502, datë 09.11.2022, për Dënim me Gjobë.<br><br>· Vendim Nr. 1658, datë 31.10.2022, për pezullim të punimeve.<br><br>· Vendim Nr. 2122, datë 09.11.2022, për prishje të objektit të kundërligjshem. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kemi te sigurt nga punonjesit qe punojn tek ai qe jo<br>Qe leje ska por qe eshte mare vesh me policine,imt,ikmt dhe policin bashkiake<br>Fakt qe e tregon pasi pas ketij pallati ka nje objekt 3 katesh me vendim prishje nga IMT ku Nuk meret asnje mase as per ndalim punimesh as per prishjen e ketej objekti.(ne baze te fotove shikohet e puna qe esht ber pa leje)dhe pas asaj rruge objekti ku ka nje tabel bashkie te themi leje po ku nderkoh ka tejkaluar lejen dhe ka vendimin e prishjes nga Imt ku nderkoh vazhdon punimet)<br>Kjo problematik duhet te zgjidhet menjeher,po i drejtohem te gjitha instucioneve per zgjidhje te menjehershme. Ju | | Për sa më sipër, në zbatim të Ligjit 9780, datë 16.07.2007, “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar, si dhe VKM Nr 894, datë 04.11.2015,”Për Unifikimin e Procedurave të Kontrollit të Territorit, nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”, ekzekutimi i akteve të mbajtur si dhe zbatimi i tyre është detyrë e këtij Inspektorati, me qëllim kthimin e ligjshmërise në territor. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | faleminderit!Pres nje pergjigje zyrtare sipas afateve. | | | | |
| 19 | 13.03.2023 | Pershenderje! Jam kryeplaku i fshatit Drashovice, pasi kam marre disa ankesa nga banoret e fshatit sepse lavatricja e zhavorrit prane fshatit Drashovice me pronar Krenar Mehillaj po na shkaterron lumin pa leje dhe ne po humbasim tokat e mbjella me ullinje. Ju lutem kerkojme ndihmen tuaj pasi kemi njoftuar prefektin e Vlores i cili e ka pare ankesen tone nga afer duke lajmeruar edhe policine e Vlores edhe policine bashkiake Selenice dhe nuk veprojne.Firma nuk disponon asnje dokumentacion per shfrytezimin e lumit. Ju lutem te merren masa sepse jemi nje fshate i tere. Po jua | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dokumentojme dhe me foto.<br>Faleminderit! | | | | |
| 20 | 14.04.2023 | Pershendetje<br>Ne katin e pare te nje godine 5 kateshe eshte zaptuar kati -1 dhe hapsira e perbashket dhe shiten rroba te perdorura. Nga ana banoreve i eshte kerkuar personit qe zhvillon aktivitetin te largohet por nga personi ne fjale eshte rrefuzuar. Presim nje zgjidhje te problemit dhe rikthimin e ksaj hapsire ne gjendjen fillestare dhe ne sherbim te banoreve.<br>Faleminderit<br><br>ADRESA : BLV. BAJRAM CURRI; Nd. 168; H. 36; NJËSIA BASHKIAKE NR. 1; 1010; TIRANË | 14.04.2023 | Përshëndetje!<br><br>Për problematikën që ju keni adresuar në adresën zyrtare të e-mailit të IKMT, ju bëjmë me dije se nuk jemi në organi kompetent për trajtimin e këtij rasti.<br>Ju lutemi, drejtohuni Policisë Bashkiake për këtë problematikë.<br><br>Faleminderit. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 21 | 18.04.2023 | Pershendetje<br><br>Do doja te beja nje denoncim per kompanine SALI FISH me NIPT L71724501P dhe gjithashtu ortaken e vetme dhe administratoren e saj zonjen Anila Sali. Kjo kompani ushtron aktivitetin e saj ne "Zhame Sektor Lushnje, Zona kadastrale 3916, me nr pasurie 44/6-N1 volumi 6 faqe 163 me sip totale 500m2 dhe nr pasurie 44/6-N2 volumi 6 faqe 164 me siperfaqe totale 500m2" prej pothuajse 4-5 muajsht e pashqetesuar duke mos patur leje mjedisore perkatese per aktivitetin qe ajo zhvillon dhe mbi te gjitha ajo qe eshte me e renda dhe me e keqja ne gjithe kete situate, kjo kompani derdh ne mjedisin perreth dhe ne lumin mbetje | | Deleguar 18.04.2023<br><br>Përshëndetje!<br><br>Në adresën elektronike të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit pranë Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit ka ardhur ankesa nga qytetari Z.Andi Hoxha, ku parashtron ankesën e tij:<br><br>1. Denoncon për kompaninë SALI FISH, me NIPT L71724501P dhe gjithashtu ortaken e vetme dhe administratoren e saj zonjen Zj.Anila Sali<br>2. Kjo kompani ushtron aktivitetin e saj prej pothuajse 4-5 muajsh pa leje mjedisore përkatëse | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | teknologjike te pa perpunuara, duke shkaktuar nje ndotje kolosale mjedisore dhe duke e bere te pabanueshme zonen perreth. Ju lutem qe te verifikonin kete denoncim qe un po bej dhe te merrni masat qe kjo kompani te mos zhvilloje me aktivitetin ne te tille forme duke shperfillur cdo rregullore e ligj te shtetit shqiptar e mbi te gjitha duke ndotur haptazi mjedisin.<br><br>Ju pershendes duke shpresuar qe denoncimi im te merret parasysh e te gjeje zgjidhje sa me te shpejte. | | për aktivitetin që ajo zhvillon dhe mbi të gjitha kjo kompani derdh në mjedisin përreth dhe në lumin pranë, mbetje teknologjike të pa përpunuara, duke shkaktuar një ndotje kolosale mjedisore dhe duke e bërë të pabanueshme zonën përreth.<br><br>Ju dërgojmë ndjekjen e kësaj problematike deri në zgjidhjen përfundimtare.<br><br>Në përfundim, **brenda 5 diteve** të dërgohet informacion në adresën | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | eletronike të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit. | | |
| 24 | 29.04.2023 | **Denada Bushi**<br><br>Pershendetje, kam nevoje te denoncoj nje person qe vijon te kryeje punime te brendshme me matrapik dhe pervec zhurmes, keto punime po behen brenda nje ndertimi pa leje dhe te ozorpuar nga ai. Prona ndodhet ne Lagjen Ahmet Haxhia Rruga Sami Repishti (prane pallatit te kengetarit Bujar Qamili) Shkoder ne pronesi te Gezim e Durine Mlloja. Kemi bere dhe para nje jave denoncim ne polici por sipas verifikimeve te tyre ato thjesht po zhbllokonin tubin e wc. Nderkohe qe ato vijojne punimet edhe pas nje jave ( gje qe me ben te dyjoj se po ben punime te tjera. Ju lutem sillni nje ekip ekspertesh nga Tirana qe te bejne verifimet ( sepse keto ne Shkoder mesa kam kuptu ai i kercenon gjithnje). Per kete kemi hapur dhe proces gjyqesor, por u be me shume se nje vit dhe akoma nuk eshte caktu data e gjyqit. Prandaj kemi nevoje te beher ekspertiza ne terren dhe nga ana juaj. Ju faleminderit, por ju lutem anonim sepse ai kercenon | 04.05.2023<br>24.05.2023<br>05.07.2023 | Deleguar IKMT Dr Rajonale SHKODËR (02.05.2023)<br><br>Përshëndetje Zj.Bushi<br>Uroj të jeni mirë!<br><br>Në vijim të ankesës tuaj, ju informoj se ankesa juaj po trajtohet .<br>Me shkresën me nr. 117 Prot, datë 02.05.2023 "Kërkesë për informacion" i jemi drejtuar IMT-së Bashkia Shkodër që të përcjellë pranë IKMT-së Shkodër informacion të detajuar në lidhje me inspektimet e kryera në këtë subjekt.<br>Jemi në pritje të përgjigjes nga IMT Shkodër.Do t'ju njoftojmë në vijim.<br>Faleminderit për bashkëpunimin.<br><br>--- Përshëndetje Zj.Bushi.<br><br>Në vijim të kërkeses tuaj për informacion se mbi ankesën | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | gjithnje me jete babin tim ( madje dhe shpif sikur babi i ngacmon vajzat e tij, shpifje kjo per te hequr vemendjen nga ndertimi i paligjshem qe ka bere ne tetor 2021, por edhe per kete kemi hapur gjyq tjeter). Ngelem duke angazhu avokate sepse nuk shqyrtohet ne k9he ceshtja gjyqesore...te pakten mos te vijoje me punimet ne menyre qe ekspertet ta shohin se eshte ne punime e siper...e jo si shprehet IKMT e Shkodres qe punimer kane perfundu). Ju lutem anonim sepse tani nuk besoj me tek askush ketu ne Shkoder.. ( ketu ose kercenohen ose njihen ose..... persa kohe rasti eshte krejt i qarte e keto nuk verejne asnje shkelje). Ju lutem anonim e ju faleminderit paraprakisht sepse prinderit i kam ne moshe e me probleme me zemer e mos te shqetesohen nga askush.<br>Mbes ne shpresen e nje zgjidhjeje nga ana Juaj.<br>ershendetje, edhe nje here, bashkangjitur ndodhet kartela e prones, plani i rilevimit dhe pergjigja kontradiktore e IMTse Shkoder ku thote se ndodhet ne toke te vet ku per mendimin tim | | tuaj,ju bëj me dije se ankesa po trajtohet.<br><br>Ju bëjmë me dije se:<br><br>• Nga Inspektorët e Sektorit të Inspektimit të Territorit është ushtruar kontroll në objektin në fjalë. Gjatë kontrollit nuk janë konstatuar procese ndërtimore si dhe nuk janë gjetur materiale ndërtimore në objekt.<br>• Në lidhje me pretendimin e ankueses se po kryhen punime të brendshme, i jemi drejtuar me shkresën me nr. 117/2 Prot, datë 22.05.2023 Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër, ku kemi kërkuar informacion nëse shtetasit e lartpërmendur kanë certifikatë për vërtetim pronësie ose nëse janë në proces legalizimi për pronën në fjalë, si dhe i është kërkuar të na | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ka dy kontradikta: 1. e para se nuk eshte ne token e vet sepse dallon dhe me sy te lire qe pronat kane hapesire ndermjet tyre nderkohe qe ato jane te ngjitura; 2. edhe kur eshte ndertim ne token e vet duhet leja kur eshte ndertim i ri.<br>Prandaj kerkoj eksperte ndertimi per te bere verifikimin pa hile e dredhi. | | vihen në dispozicion kopje të planimetrisë së objektit nëse disponohen.<br>• I jemi drejtuar IMT-së Bashkia Shkodër me shkresën me nr. 117/1 Prot, datë 22.05.2023 “Kërkesë për informacion” , duke kërkuar në mënyrë të përsëritur informacion për rastin në fjalë.<br><br>Jemi në pritje të përgjigjeve nga IMT-ja pranë Bashkisë Shkodër dhe ASHK Drejtoria Vendore Shkodër.<br>Sapo të na përcillet informacioni i kërkuar do t’ju vëmë në dijeni dhe do të merren masat e nevojshme për zgjidhjen e kësaj ankese.<br><br>Faleminderit per bashkëpunimin.<br><br>--Përshëndetje Zj.Bushi<br><br>Në vijim të ankesës tuaj ju informojmë se ankesa është | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | trajtuar nga Drejtoria Rajonale IKMT Shkodër në bashkëpunim me IMT Bashkia Shkodër, nga ku na infomojnë se:<br><br>• Nga Inspektorët e Sektorit të Inspektimit të Territorit është ushtruar kontroll në objektin në fjalë. Gjatë kontrollit nuk janë konstatuar procese ndërtimore si dhe nuk janë gjetur materiale ndërtimore në objekt.<br>• Në lidhje me pretendimin e ankueses se po kryhen punime të brendshme, i jemi drejtuar me shkresen me nr. 117/2 Prot, datë 22.05.2023 Agjencisë Shtetërore të Kadastres, Drejtoria Vendore Shkodër, ku kemi kërkuar informacion nëse shtetasit e lartpërmendur kanë certifikatë për vërtetim pronësie ose nëse janë në proces legalizimi për pronën në fjalë, si dhe i | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | është kërkuar të na vihen në dispozicion kopje të planimetrisë së objektit nëse disponohen.<br>• Jemi drejtuar IMT-së Bashkia Shkodër me shkresën me nr. 117/1 Prot, datë 22.05.2023 “Kërkesë për informacion” , duke kërkuar në mënyrë të përsëritur informacion për rastin në fjalë.<br><br>Nga IMT-Shkoder ka ardhur përgjigjja me:<br><br>• Shkresen me nr.117/3 Prot, datë 08.06.2023 nga ku grupi i inspektimit ka ushtruar kontroll në vend dhe nuk ka konstatuar punime për të cilat nevojitet leje ndertitmi apo deklarata paraprake punimesh<br>• Bashkëlidhur ju përcjellim shkresën e sipërcituar.<br><br>Ju faleminderit! | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| 25 | 02.05.2023 | **Marie Moco**<br><br>Pershendetje,<br>Uroj te jeni mire.<br><br>Prane IKMT me date 20.03.2023 eshte protokolluar nje kerkese per inspektim nga Marie Muço, e cila ende nuk ka marre nje pergjigje.<br><br>Lutem te me ktheni nje pergjigje zyrtare shkreses time sipas parashikimeve ligjore.<br><br>Pune te mbare! | 04.05.2023 | Përshëndetje Zj.Moco!<br>Uroj të jeni mirë.<br>Në vijim të informacionit që ju kërkoni në lidhje me ankesën tuaj, po ju informoj se :<br>Referuar nenit 4 dhe 5 të ligjit nr.9780 datë 16.7.2007 ,“Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, iu dërgua për verifikim dhe trajtim si organi kompetent për territorin e Tiranës Bashkisë Tirane duke i kërkuar që të evidentohet çështja thelbësore e trajtimit të rastit: A ka ndërtim? Nëse ka, a është me leje ndërtimi?<br><br>Ju informoj që Koordinatori për të Drejtën e Informimit të Bashkisë Tiranë ka këtë adresë e-mail zyrtare: edrejtaperinformim@tirana.al.<br><br>Faleminderit. | | |
| 26 | 27.04.2023<br><br>03.05.2023 | **Alban Turja**<br>Pershendetje! | 27.04.2023 | --- Përshëndetje!<br><br>U njohëm me ankesën tuaj. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Jam nje menaxher i nje biznesi te prodhimeve te betonit. Kam nje problem te madh. Po me dalin produktet e pllakave, blloqeve etj me shume difekte. Arsyeja e ketyre difekteve vjen prej mbetjeve te firmes DEKOLL sepse ato nuk i cojn ne landfiller apo ne pikat e grumbullimit dhe perpunimit te posacem por i shesin ne treg si rere e bardhe. Kjo gje me ka shkaktuar shume deme ne biznesin tim. Kerkoj nga ju te meren masa per kete firme ne menyre qe mos ta shesin ne menyre te paligjshme ne treg duke abuzuar si me ligjin edhe duke demtuar bizneset dhe familjaret duke shkaktuar edhe deme mjedisore<br><br>ne pritje te nderhyrjes tuaj!<br>Faleminderit!<br>-- Pershendetje!<br><br>Faleminderit per pergjigjen tuaj. Firma DEKOLL ndodhet ne autostraden Durres-Tirane km5. Ato e shesin ne menyre ilegale kete mbetje qe e nxjerrin nga produktet e tyre. Ato e nxjerrin nga fabrika e tyre dhe e shesin me kamiona ne biznese ndertimi. Ato e shesin si rere te | | Ju lutem na dërgoni të dhëna më të sakta lidhur me adresën ku ndodhet DEKOLL dhe vendi ku i keni blerë këto produkte.<br><br>Faleminderit për bashkëpunimin.<br><br>DELEGUAR Dr.Përpunimit të Materialeve të Ndërtimit<br><br>Përshëndetje Z.Turja<br><br>Në vijim të ankesës tuaj, ju bëjë me dije se ankesa juaj është trajtuar dhe konkluzionet janë si më poshtë:<br><br>Nga grupi i inspektimit u krye kontrolli në të dyja subjektet dhe u administrua dokumentacioni teknik në lidhje me këtë problematikë.<br>® Nga subjekti “K.TURJA” me administrator Alban Turja dhe Genci Turja,informojnë se ankesa e depozituar pranë IKMT nuk është bërë nga ana e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | bardhe. kjo gje nuk lejohet me ligj pasi duhet te cohet ne vende te posacme perpunimi.<br>ju lutem merni masa se po me ben nje dem shume te madh ne biznesin tim.<br>Faleminderit per mirekuptimin! | | tyre, nuk janë në dijeni për këtë ankesë dhe nuk ngrejnë pretendime lidhur me cilësinë e lëndës së parë marrë nga subjekti Dekoll pasi produkti që prodhojnë;pllakë betoni, është conform standartit shtetëror.<br><br>Subjekti na vuri në dispozicion:<br>**Për produktin rërë e bardhë ( Filler filtri).**<br>· Faturë elektronike Tatimore shoqëruar me certifikatë cilësie (skedë teknike me të dhënat e produktit)<br>**Për produktin pllakë Betoni u paraqit dokumentacioni si më poshtë:**<br>· Lënda e parë rërë, granil, çimento shoqërohet me certifikatë cilësie.<br>· Disponon analiza laboratorike për produktin pllakë betoni që prodhon dhe hedh në treg.<br>· Produkti hidhet në treg shoqëruar me certifikatë cilësie. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | · Është hartuar Deklaratë konformiteti për produktin që prodhon dhe hedh në treg.<br><br>® **Nga subjekti "Dekoll" shpk** me administrator Z. Sokol Petriti dhe në prezencë të përfaqësueses të subjektit Yllka Koka u paraqitën këto dokumenta si më poshtë:<br>· Analiza laboratorike për produktin rërë mali dhe granil nga laborator i akredituar (EGC) të marra nga subjekti " Mustafai" shpk.<br>· Skedë Teknike për produktin rërë e bardhë ( filler filtri) me të dhënat teknike e kryer në laboratorin e subjektit " Dekoll".<br>· Disponon kontratë shërbimi pastrimi për mbetjet e shoqëruara me faturën përkatëse për vend depozitimin e mbetjeve. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Për sa më sipër nga administrimi i dokumentacionit dhe verifikimi në terren,vlerësojmë si më poshtë:<br>Subjekti “ K. Turja “ shpk nuk është në dijeni me këtë ankesë dhe nga dokumentacioni i administruar figuron se produkti pllakë betoni që ai prodhon është konform standartit shtetëror kjo bazuar dhe në analizat laboratorike nga laborator i akredituar. Si dhe lënda e parë është marrë me faturë tatimore,shoqëruar me skedë teknike lëshuar nga subjekti Dekoll dhe nuk ngre pretendime për këtë produkt të blerë.<br><br>Subjekti Dekoll disponon kontratë shërbimi pastrimi për mbetjet e shoqëruara me faturën përkatëse për vend depozitimin e mbetjeve gjithashtu produkti rërë e bardhë (filler filtri) nuk konsiderohet mbeturinë por hidhet në treg shoqëruar me skedë teknike pasi është pranuar me analiza laboratorike. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Nga verifikimet e kryera në të dyja subjektet dhe dokumentacionin e paraqitur, vlerësojmë se produkti lënda e parë dhe produkti final pllakë betoni është komform standartit, sipas analizave të paraqitura nga subjekti.<br>Bashkëngjitur po ju dërgojmë të gjithë dokumentacionin e administruar për këtë rast në format pdf. | | |
| 27 | 27.04.2023 | **Y L**<br>Përshëndetje! Do doja te denoncoja një ndërtim (zgjerim te shkalleve, konstruksion metalit dhe pllaka mermeri) qe eshte bere perballe hyrjes se parkimit te spitalit te Durresit duke ndryshuar fasaden e pallatit dhe duke demtuar bizneset qe ka prane. Ju lutem ta merrni ne konsiderate. Ju faleminderit!<br>Bashkangjitur po ju dergoj foto te shkeljes se siperpermendur! | 27.04.2023<br>17.05.2023 | Deleguar IKMT Durrës 27.04.2023<br>--- Në lidhje me ankesën e qytetarit me iniciale Y.L, ju bëjmë me dije se ankesa iu përcoll për trajtim Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Bashkia Durrës, me shkresën protokolluar tek ne me nr.289 prot datë 27.04.2023.<br>Ju falenderojmë për bashkëpunimin.<br>---Përshëndetje!<br>Në vijim të ankesës tuaj dërguar në datë 27.04.2023, ju bëjë me dije se ankesa është | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | trajtuar nga Drejtoria Rajonale IKMT Durrës, nga e cila kemi marrë informacionin si më poshtë:<br><br>Bashkëlidhur ju dërgojmë shkresën përkatëse me anë të së cilës IMT-Bashkia Durrës na ka bërë me dije se pas verifikimit të rastit;<br><br>1. Është konstatuar procesverbal nr.10 datë 12.05.2023 me kundërvajtje: shkallë me konstruksion metalik veshur me pllakë mermeri në hapesirë publike të pallatit<br>2. Vendim për prishje të objektit të kundërligjshëm nr.33 datë 17.05.2023. | | |
| 28 | 02.05.2023 | **Marie Muco**<br>Pershendetje, | 04.05.2023 | Përshëndetje Zj.Muco!<br>Uroj të jeni mirë. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Uroj te jeni mire.<br>Prane IKMT me date 20.03.2023 eshte protokolluar nje kerkese per inspektim nga Marie Muço, e cila ende nuk ka marre nje pergjigje.<br><br>Lutem te me ktheni nje pergjigje zyrtare shkreses time sipas parashikimeve ligjore.<br><br>Pune te mbare! | | Në vijim të informacionit që ju kërkoni, në lidhje me ankesën tuaj, ju informoj se :<br>Referuar nenit 4 dhe 5 të ligjit nr 9780 datë 16.7.2007 ,"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", ju dërgua për verifikim dhe trajtim si organi kompetent për territorin e Tiranës Bashkisë Tirane duke i kërkuar që të evidentohet çështja thelbësore e trajtimit të rastit: A ka ndërtim? Nëse ka, a është me leje ndërtimi?<br><br>Ju informoj që Koordinatori për të Drejtën e Informimit të Bashkisë Tiranë, ka këtë adresë e-maili zyrtare : edrejtaperinformim@tirana.al.<br><br>Faleminderit. | | |
| 29 | 11.05.2023<br><br>25.05.2023<br><br>26.05.2023<br><br>30.05.2023 | **Azmi Stringa**<br>Ne menyre te perseritur kemi derguar kerkesa dhe paralajmeruar per ndertim te paligjshem ne pronen ku jemi bashkepronar.<br><br>Kemi kontaktuar dhe me Bashkine Elbasan, por pa sukses. | 11.05.2023<br><br>25.05.2023<br><br>09.06.2023<br><br>12.06.2023 | Deleguar DR IKMT Elbasan<br><br>Pershendetje Z.Stringa.<br><br>Ne vijim te ankeses tuaj ju bej me dije se ankesa juaj eshte trajtuar, nga Derejtoria Rajonale IKMT Elbasan ne | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 09.06.2023<br>22.09.2023 | Na ka ardhur informacion nga terreni qe ne ate prone jane kryer/ose po kryen punime pa lejen tone si bashkepronare dhe ne kundershtim me ligjin.<br><br>Kerkojme ju lutem nderhyrjen tuaj, si dhe na vendosni ne dispozicion nje kopje te procesverbalit dhe cdo vendimi me te cilin do dilni pas inspektimit tuaj ne terren.<br><br>Po ju dergojme bashkengjitur per reference ankesen e pare me kerkesen per informacion, fotografimin si ka qene objekti perpara nderhyrjeve per te bere cdo krahasim. Ankesat e derguara ne Bashkine Elbasan.<br>--Pershendetje Besjona,<br><br>Shume faleminderit per fotot.<br><br>Shoh qe punimet nuk kan perfunduar ende.<br><br>Duke ju falenderuar, kerkojme si bashkepronar sa me poshte vijon: | 16.06.2023<br>13.07.2023<br>02.08.2023<br>29.09.2023 | bashkepunim me IMT Bashkia Elbasan.<br><br>Nga Drejtoria Rajonale IKMT Elbasan kemi kete informacion deri tani: bashkelidhur po ju dergojme proceduren e mbajtur nga **IMT Bashkia Elbasan** :<br><br>1. Shkresen "Kthim pergjigje", te IMT bashkia Elbasan, me nr 291/1 Prot date 23.05.2023.<br>2.Procesverbali i konstatimit të kundravajtjes është mbajtur nga IMT-Bashkia Elbasan me Nr.serie 0000018 datë 15/05/2023<br>3. Vendimin per denimin me gjobe me nr 18 date 17.05.2023Nr.serie 0000078<br>4.Vendimin per prishje e objektit te kundraligjshem me nr 17 date 17.05.2023Nr.serie 0000017<br><br>Ne vijemesi do ju njoftojme per cdo zhvillim tjeter. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1. Te mos lejohet me te vijohet me asnje punim tjeter ne objekt ku jemi bashkepronar.<br>2. Te zbatohet me perpiktmeri vendimi per prishjen e objektit pa leje.<br><br>Ju lutem me konfirmoni qe cdo punim eshte nderprere dhe mbi zbatimin e vendimit te prishjes se objektit te paligjshem.<br><br>Shume faleminderit,<br><br>---Duke qenë që si bashkëpronar jemi shumë të shqetësuar për këtë veprim pa lejen tonë, kërkojmë nga ju mirëkuptimin për të na vendosur në dispozicion apo informuar në lidhje me sa më poshtë:<br><br>1. A është bërë dhe a do të bëhët kallëzim penal, sic parashikuar nga legjislacioni në fuqi, në lidhje më veprimtarinë e paligshme? Ju lutem na mbani të informuar.<br><br>2. Konstatohet nga fotografitë, ndryshe nga cfarë thuhet në Shkresën “Kthim Përgjigje”, që punimet në objektin ku ne jemi | | Faleminderit per bashkepunimin.<br>---Ju bej me dije se kjo problematike po ndiqet nga Drejtoria Rajonale Elbasan per zbatimin e vendimeve.<br><br>Dite te mbare .<br>---Pershendetje!<br><br>Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion po ju dërgojmë shkresën "Informacion", Nr.392, datë 07.06.2023 të Bashkisë Elbasan, ardhur në Drejtorine Rajonale IKMT Elbasan 09.06.2023.<br><br>Dite te mbare!<br><br>Përshëndetje,<br>---Pershendetje!<br><br>Ne vijim per informacionin e kerkuar, drejtojuni IMT-se Bashkia Elbasan si organi kompetetnt per territorin e Elbasanit si dhe per pytjet qe ju kerkoni informacion. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | bashkëpronar, ndonëse në një fazë të avancuar, janë ende të papërfunduara. A janë marrë masat për mos lejimin e vazhdimit të asnjë punimi të mëtejshëm në objekt? Kërkojmë që të mos ketë më asnjë punim në objekt, sepse jo vetëm punimet janë të paligjshme por edhe pa lejen tonë si bashkëpronrar dhe në kundërshtim me dispozitat e kodit civil dhe legjislacionit në fuqi për bashkëpronësinë.<br><br>3. A ka filluar zbatimi i vendimit për prishjen e objekti të kundraligjshëm? Kur pritet të filloj? Na informoni mbi masat e marra në zbatim të këtij vendimi.<br><br>4. Nëse kundravajtësi Alket Kasa ngre pretendime në gjykatë në lidhje me vendimet e marra, ne kërkojmë të informohemi nga ana institucionit tuaj në lidhje me këtë fakt dhe të njoftohemi si palë për pjesëmarrje në cdo proces gjyqësor.<br><br>5. Duke qenë që punimet kanë qenë më qendër të fshatit (rreth 50 metra nga zyrat e Njësisë Administrative Tregan) dhe dhe | | Dite te mbare.<br><br>---Përshëndetje'<br><br>Bashkëngjitur po ju dërgojmë shkresën "Kthim Përgjigje", Nr.348/1, datë 01.06.2023, të Bashkisë Elbasan dhe Kallzimin Penal ndaj shtetasit z.Alket Kasa.<br><br>Punë të mbarë<br>Ne vijim te korrespondences ne lidhje me trajtimin e ankeses tuaj, ju bejme me dije se IMT Bashkia Elbasan, ne pergjigje te shkreses tone te fundit me Nr.361/1.prot, date 06.07.2023, na është kthyer përgjigje me shkresën nr.524/1 Prot. dt.10.07.2023 "Kthim pergjigje", ku na informon lidhur me te gjithe proçeduren përkatëse te ndjekur për problemin e z.Azmi Stringa dhe ku ka shtjelluar pergjigjen per pyetjet qe ka bere ankuesi ne emailet e tij te meparshme. IMT Bashkia Elbasan shpjegon ne shkresen e saj se pasi e ka konstatuar ndertimin pa leje te | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | për një objekt të madhësisë së konsiderueshme ku qenkërkan ngritur skela dhe hedhur beton, kërkojmë një kopje të njoftimit të fillimit të punimeve që z. Alket Kasa duhet të bënte në Bashkinë Elbasan/IMT Elbasan në momentin e fillim të tyre.<br><br>Bazuar në sa më lart kërkojmë të informohemi urgjentish në lidhje me sa më poshtë vijon:<br><br>1. Të informohemi si e llogariti IMT- Bashkia Elbasan gjobën në vlerë 500,000 lekë? Edhe sikur të aplikohej gjoba minimale i bie të kishte vetëm 14.2 m2 ose 4 m me 3.5 m punime pa leje (500,000 leke/35,000 lekë për metër katror) kjo gje provohet mashtrim nga vete fotografitë sikur vetëm shkrimin me beton të llogarisime, e jo më fasadën etj.<br><br>2. Të na vihet në dispozicion nga IMT-Elbasan projekti teknik i punimeve, nëse për punimet në kushtet e flagrancës (provuar nga fotot) ka patur projekt teknik të hartuar nga profesionisht të | | z.Kasa, i ka kerkuar dokumentacionin e nevojshem tekniko-ligjor i cili mungonte, ka ndermarre te gjitha procedurat ligjore ne mbrojtje te planifikimit dhe zhvillimit te territorit, duke vendosur masen e gjobes 500.000 leke, pezulloi punimet dhe mori vendimin per prishjen e objektit te kundraligjshem dhe kthimin e objektit ne gjendjen fillestare. Bashkelidhur po ju dergojme shkresën nr.524/1 Prot. dt.10.07.2023 "Kthim pergjigje" e IMT Bashkia Elbasan, se bashku me aktet qe na ka derguar bashkelidhur shkreses.<br><br>Persa i perket ankseses se sotme, ardhur nga emaili zyrtar, i kemi derguar IMT Bashkia Elbasan, shkrese per trajtimin e problematikave te ngritura nga z.Azmi Striinga. Jemi ne pritje te pergjigjes se rradhes dhe do tju bejme menjehere me dije.<br><br>Ditë të mbarë<br>---Përshendetje! | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | fushësh, sic kërkuar nga legjislacioni në fuqi.<br><br>3. Të na vihet në dispozicion nga IMT-Elbasan llogaritja e kryer për përcaktimin e vlerës së punimeve të kryera pa leje (sipërfaqe dhe kosto mesatare ndërtimi) sic kërkuar nga neni 52, pika 2 e ligjit 107/2014 i ndryshuar, si elementi thelbësor për llogaritjen e gjobës e cila duhet të jetë ose vlera e punimeve të kryera pa leje ose 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror, kushdo qoftë me e larta, sic përcaktuar nga neni 52, pika 1, shkronja “e”.<br><br>4. Të na vihet në dispozicion nga IMT- Bashkia Elbasan i gjithë dokumentacioni me të cilën Z. Alket Kasa ka mundësuar fillimin e punimeve, sic depozituar në Njësinë Administra Administrative Tregan, IMT-Bashkia Elbasan, dhe Bashkia Elbasan.<br><br>5. Të na vihet në dispozicion njoftimi i kryer nga Z. Alket Kasa për fillimin e punimeve, sic | | Në vijim kërkesës tuaj ju informojmë se i është ridërguar shkresa " Kërkese për informacion " me nr.398/3 prot date 01.08.2023, drejtuar Bashkisë Elbasan (Drejtorisë Planifikimit) e IMT e Bashkise Elbasan, pasi kërkesa e parë është keqinterpretuar, dhe është dërguar informacion për z.Azmi Stringa dhe jo për shtetasin z.Alket Kasa.<br><br>Sapo të na njoftohet aktet do ja u bëjmë me dije.<br><br>Bashkengjitur:<br><br>• Shkresa "Kërkesë për informacion", nr.398/3 prot datë 01.08.2023, drejtuar Bashkisë Elbasan (Drejtorisë Planifikimit) e IMT e Bashkise Elbasan.<br><br>Punë të mbarë<br><br>Pershendetje!<br><br>Në vijimesi të kerkave tuaja te vazhdueshme , ju informoj se | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | përcaktuar nga legjislacioni në fuqi<br><br><br><br>--Pershendetje Besjona!<br><br>Shume faleminderit per pergjigjen.<br><br>KJO ESHTE NJE KERKESE E RE:<br><br>Kerkojme nje kopje te kallzimit penal te bere ne daten 29.05.2023 nga Bashkia Elbasan. Me te gjithe dokumentat qe kane derguar bashkengjitur.<br><br>Theksoj se Kodi Penal percakton si me poshte vijon:<br><br>“Ndërtimi i kryer pa leje, në shkelje të rëndë të lejes ose në kushtet e një lejeje të shfuqizuar në tokën në pronësi të vet, dënohet me burgim deri në një vit.<br>Po kjo vepër, e kryer në tokën publike ose shtetërore apo në tokën e tjetrit, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.<br>Po kjo vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda apo e kryer për qëllime | | nga IKMT-Dr.Elbasan, është dërguar shkresa "Kërkesë për informacion" nr.543/1 Prot date 27.09.2023, drejtuar IMT Bashkia Elbasan ku eshte kërkuar:<br><br>1. Dokumentat e inspektimit në Nëntor 2022<br>2. Veprim pas mos reagimit të IMT-së, pas shkresave të Kryeinspektorit që i kërkon marrje mase.<br>3. Prishje të objektit të paligjshëm, duke qenë se IMT, thotë skam kapacitet.<br><br>Jemi në pritje të një pergjigje nga IMT-Bashkia Elbasan.<br><br>Bashkangjitur:<br>Shkresa Nr.543/1 Prot. dat 27.09.2023, drejtuar IMT-Bashkia Elbasan.<br><br><br>Dite te mbare | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | fitimi, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.“<br><br>Ky eshte nje ndertim pa leje ne token tone si bashkepronar qe e kemi kundershtuar.<br><br>Per me teper Hoteli eshte per qellime fitimi.<br><br>Dispozita penale parashikon nga 3-8 vjet burg.<br><br>Faleminderit.<br>Pershendetje,<br><br>Kind reminder.<br><br>Kam cuar dy kerkesa qe nuk jane ezauruar nga shkresa drejtuar jush:<br><br>1. Dokumentat e inspektimit ne nentor 2022.<br>2. Veprim pas mos reagimit te IMT-se pas shkreses se Kryeinspektorit qe i kerkonte marrje mase.<br>3. Prishje objekti te paligjshem, duke qene qe IMT thote skam kapacitete.<br><br>Me respekt | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| 30 | 11.05.2023 | **Sokol Hasani**<br><br>Si e dini dhe Ju (marrim te mireqene njohurite fillestare ne Jurisprudence) HAPESIRAT Publike per asnje motiv, me asnje ligj apo akt tjeter normativ nuk mund t'i kalojne privatit!! Kur i kalon, atehere s'quhet me hapesire publike, pasi cenohet parimi kryesor i prones= E DREJTA E DISPONIBILITETIT. Jane shkelur te pakten 2 dispozita te K.Penal- Pushtim toke (neni 200) dhe Ndertim i Paligjshem.(neni 199/a-2). Nuk e di si e paskeni klasifikuar dhe "truall" reren..apo zone afer..., di vetem qe pres te veproni! Kam fatura ku "me hierarki me te vogel ne sistemin e ..korruptuar tonin" jane "ata te INUK.... Fatura ka lidhje me sherbime si psh -dhoma ne Drymades- anash shkruar- | 11.05.2023 | -- Përshëndetje!<br><br>U njohëm me ankesën tuaj, por materiali i dërguar nuk hapet. Kërkojmë nga ju të ridërgohet dhe një herë materiali,por jo me aplikacionin wetransfer.<br><br>Faleminderit për bashkëpunimin. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | PAGUAN LENCI..., apo per persona me te rendesishem-Paguan XHENI.... T'U VIJE TURP ATYRE BARBONAVE QE SHESIN INTERESAT E SHTETIT PER "NJE DYSHEK, DHE ME NGARKESE PO TE ISHTE"...!!!<br><br>**Sipas nenit 23 te Kushtetutes dhe ligjit mbi te drejten e informimit, pres te vihem ne dijeni te procedurave qe do ndiqni!** Kjo eshte veper per SPAK po te bashkangjis dhe faturat.<br><br>Per vepra te tjera, nga koto Kompani familjare, qe me kujtojne Skemat Ponzi- ku "njera dore merr leke nga ..psh tenderat e blen prona private...., apo i kalon ( dores tjeter) nje pjese te likuiditetit per te paguar pjeserisht punonjesit..., per deklarime jo te sakta ne tatime..., per mbajtje rroge...etj..etj..i jam drejtuar atyre organeve qe kane juridiksionin .., qofte dhe ate territorial, pasi Coast to Coast Qendren fiktive e ka ne | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Dhermi, por ate reale ne Tirane-Liqeni Artificial- Lion Residence..<br><br>Mbase do anashkaloja faktet ne fjale, se jam lodhur pak duke denoncuar qe nga 2011 kur isha Zv/Drejtor i Pergjithshem I ALUIZNI-t deri ne ditet tona, po kur shikoj qe "keta" s'dine as te "seleksionojne", por i MBAJNE RROGEN NE MENYRE TE PACIPE DHE NJERIUT TIM...., BILES I THONE QE KETO JANE KUSHTET E KOMPANISE, PO DESHE LARGOHU..,PAS 2 MUAJSH MUNGESE PAGESE...KARIKOHEM DHE JAM GATI DHE PER 12 VITE TE TJERA "LUFTE"...E KEMI NE ADN NE VLONJATET E VERTETE!!<br><br>Bashkangjitur keni linkun - https://we.tl/t-PmXYn4Q49Z , https://we.tl/t-L9aVSy6f8e | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 31 | 15.05.2023 | **Arman Kullau**<br><br>Prej gati 8 muajsh banorët e fshatit Bërxullë protestojnë për projektin e Thumanë-Kashar, i cili kalon në tokat e tyre.<br><br>Duke marrë shkas nga raportimet e banorëve, nga kontrollet e “Fax News” në terren, por edhe nga raporti i monitorimit të Komitetit Shqiptar të Helsinkit na rezulton se nuk ka një tabelë për afatet e ndërtimit nga kompania “Gener 2” shpk, tabelë e cila është e detyrueshme me ligj.<br><br>Në kuadër të transparencës publike, duke u bazuar tek ligji për të Drejtën e Informimit nr.119/2014, redaksia “Fax News” kërkon si informacion:<br><br>1. A ka kryer kontrolle në terren për këtë rast Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit? Duke marrë shkas nga raporti i KShH-së dhe raportimet në media për rastin në fjalë.<br><br>2. Cfarë masash merr Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit | | Deleguar IKMT TIRANË (15.05.2023)<br><br>Referuar ankesës së Z. Arman Kullua, i cili ka paraqitur kërkesën për informacion si më poshtë:<br><br>• Duke marrë shkasë nga raportimet e banorëve të fshatit Bërxullë , nga kontrollet e "Fax News" por edhe nga raporti i KSHH (Komitetit Shqiptar të Helsinkit) rezulton që nuk ka një tabelë për afatet e ndërtimit nga kompania "GENER 2”.<br><br>Pas inspektimit të kryer nga Inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tiranë, në kantierin e ndërtimit "Gener 2", në ndërtimin e Rrugës Thuman-Kashar, në fshatin Derven, rezultoi se:<br><br>Tabela ishte e vendosur në kantier dhe nga kontrolli i tabelës, rezultoi të jenë vendosur të dhënat teknike si: | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | për rastin në fjalë kur nuk ka tabelë?<br><br>Duke ju falenderuar, Armand Kullau! | | Objekti, vendimi, zhvilluesi, afati i punimeve, autoriteti kontraktor dhe kontrata e koncesionarit. Tabela ishte e vendosur në kantier sipas rregullave.<br><br>Bashkëlidhur foto të tabelës. | | |
| 32 | 17.05.2023 | **Desara Desara**<br><br>Pershendetje . Jam nje banuese ne rrugen Myslym Shyri dhe kam nje shqetesim shum te madh, duke qënë qe i dergoj femijet ne shkollen qe kam afer Dora d'Istria.Femijet e mi dhe jo vetem ndihen te rrezikuar nga palestra e shkolles sepse aty afer shkolles eshte duke u bere nje pallat dhe i ka hapur shume themelet dhe ka krijuar plasaritje te muri i palestres se shkolles tregohet si ne fotot qe ju kam derguar me poshte, gjithashtu dhe tek pallatet ekzistuese qe jane afer te themeleve qe po behet, kane shfaqur probleme tek kanalizimet sepse i kan demtuar ato .Ju lutem merni masat sa me pare qe te | 24.05.2023 | Deleguar Tiranës 17.05.2023<br><br>Përshëndetje!<br><br>Në vijim të ankesës tuaj, ju bëjë me dije se kjo problematikë është trajtuar nga Drejtoria Rajonale Tiranë, e cila na informon për konkluzionet lidhur me trajtimin,të cilat janë si më poshtë:<br><br>• U ngrit grupi i punës<br>• U kontaktua me drejtoreshën e shkollës «Dora D' Istria « znj. Etleva Hysenaj, në zyrën e saj, ku i prezantuam ankesën e bërë nga shtetasja në mënyrë elektronike.<br>• Gjatë komunikimit, na u shpreh se këto | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | verifikoni punimet tek pallati per keto punime pa kriter, gjithashtu dhe per shkollen sepse behet fjale per jeten e te gjithe femijeve<br>Ju faleminderit dhe shpresoj per nje marrje mase sa me te shpejt nga ana juaj | | plasaritje ishin shkaktuar nga tërmeti Nëntor 2019, dhe jo vetëm tek palestra por edhe në pjesë të tjera të godinës së shkollës.<br>• Lidhur me pretendimet për probleme me kanalizimet, gjatë verifikimeve nuk rezultoi të kishte probleme të të tilla.<br>• Verifikimi i punimeve të kryera nga Shoqëria ‘‘SAG’’ shpk, për të cilin u ndërmorë kontakt me Ing. Zbatues të shoqërisë «SAG» shpk z. Elin Balla, për të cilat na vendosi në dispozicion dokumentacionin Tekniko-Ligjor, si më poshtë:<br>• Objekt me Leje ndërtimi nr. Prot., A-1032/8 datë 05.07.2022, për objektin «Godinë banimi dhe Shërbimi 4,5, 6 dhe 12 kat me 23 kat parkim nëntokë».<br>• Objekti që po zhvillohet është i rrethuar sipas | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | kushteve të Sigurimit Teknik,<br>• Aktualisht, në kantier nuk po punohej.<br>• Për sa i përket, bllokimit të kanalizimeve, gjatë inspektimit nuk u vërejt prani uji brenda objektit që po ndërtohet.<br>• Referuar pretendimeve për dëmtim të pallateve ekzistuese, të cilat janë ndërtuar në vitet ’70, si dhe referuar teknologjisë së ndërtimit të kohës dhe materialeve të ndërtimit, konstatojmë se janë të amortizuara.<br>• Referuar pretendimeve për dëmtim të palestrës, rezulton se palestra është e ndërtuar pa kollona monolit dhe pa fug antisizmike( Në shikim pamor palestra.)Palestra me ndërtesën ekzistuese të Shkollës, të jep imazhin e ndërtuar në kohë të ndryshme. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | <ul><li>Largësia nga pika e fundit e palestrës me objektin përafërsisht 15 m.</li><li>Në momentin e Inspektimit ndodhej dhe Instituti i Ndërtimit.</li></ul>Sa më sipër, institucioni jonë do t'a ndjeki në vijim ankesën tuaj duke komunikuar me IMT Bashkia Tiranë. | | |
| 33 | 17.05.2023 | **Manuela Meniku**<br><br>Pershendetje jam nje banore e tiranes njesia administrative nr 9 . Ku ne rr h.h.dalliu po ndertohet nje pallat nga firma .A.A.Konstruksion me administrator sabri shera . prej 8 vitesh ky pallat nuk ka mbaruar ndertimin duke i mbaruar disa here dhe lejet e ndertimit te ketij pallati...nga brenda ketij pallati po behen ndertime nga njerez te pa outorizuar dhe te panjohur ku thuet jan kontraktore dyert e ketij pallati mbahen te ku mbyllur ju lutem fuet nderhyrja juaj per pexullimin e ketyrr punimeve mbasi nuk mban pergjegjsi njeri | 17.05.2023<br><br>18.05.2023 | Përshëndetje!<br><br>Informacioni/ankesa që ju sapo dërguat nuk ka ardhur i plotë pranë nesh, për shkak se tekstin e keni shkruar në pjesën e subjektit.<br><br>Ju lutem ridërgojeni përsëri.<br><br>Faleminderit<br>për bashkëpunimin.<br><br>--- Përshëndetje Zj.Meniku.<br><br>Në vijim të ankesës së përcjellur nga ju, ju informoj se ankesa juaj po trajtohet. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | pet cfar po nfodh ne kete pallat pres mirkuptimin  dhe nderhyjen tuaj ne pezullimet dhe verifikimet e ketyre punimeve .duke parandaluar dhe ndonje fatkeqsi cfar mund te ndodhi aty ju faleminderit | | Në vijim do të njoftoheni për ecurinë e trajtimit të ankesës.<br><br>Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.<br><br><br>---Përshëndetje!<br><br>Në vijim të ankesës tuaj, sic jeni vënë në dijeni;<br>Ankesa juaj e trajtuar nga Drejtoria Rajonale IKMT Tiranë, e cila na informon si më poshtë (e-maili forward) ku bashkangjitur janë dhe foto në objekt.<br><br>Ditë të mbarë!<br><br><br>---Përshëndetje,<br><br>Në vijim të ankesës së Znj.Manuela Meniku, banore në Njësinë Administrative nr.9, Rruga Haxhi Hysen Dalliu, ku parashtron shqetësimin e saj :<br><br>• Po ndërtohet një pallat nga firma “A.A.Konstruksion” me | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | administrator Sabri Shera.<br>• Prej 8 vitesh ky pallat nuk ka mbaruar ndërtimin,duke i përfunduar disa herë dhe lejet e ndërtimit.<br><br>• Nga brenda këtij pallati po bëhen ndërtime nga persona të paautorizuar dhe te panjohur, ku thuhet se janë kontraktorë.Dyert e këtij pallati mbahen të mbyllura<br><br>Inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tiranë, kanë kryer inspektime të vazhdueshme në zonën përkatëse dhe pas inspektimit të fundit, datë 08.06.2023, në katin e parë të këtij pallati u konstatuan:<br><br>• Punime si vendosja e pllakave,e cila nuk kërkon pajisje me leje ndërtimi, sic duket edhe në foto (bashkangjitur).<br>• Pas kontrollit të bërë në ambientet e brendshme të objektit, nuk | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | konstatuan punime ndërtimore në proces, përvec vendosjen e disa mobilieve në njërën nga hyrjet e pallatit.<br><br>Bashkëlidhur gjeni relacion dhe foto përkatëse.<br><br>Faleminderit. | | |
| 34 | 18.05.2023 | **Bledar Penelli**<br><br>pershendetje do doja te shihni nje ndertim pa leje qe po zhvillohet ne<br>himare ne nje prone qe eshte ne rrugen maria dhimojani kete prone e ka<br>familja e gruas time me 7501 nr1974 date 30/01/1995 317/29 dhe po<br>ndertojne te tjere une ngaqe jetoj jashte nuk di ligjet se si jane prandaj interesohuni dhe me lajmeroni | 23.05.2023 | Deleguar IKMT Vlorë (18.05.203)<br><br>Përshëndetje Z.Penelli.<br><br>Në vijim të ankesës tuaj adresuar pranë IKMT-se, ju bëjë me dije se ankesa juaj është trajtuar nga Drejtoria Rajonale IKMT Vlorë, e cila na informon si më poshtë:<br><br>Që është kryer inspektim në terren ,dhe u konstatua se :<br><br>**Ndërtimi kryhej me leje ndërtimi të rregullt duke respektuar dhe kondicionet e nevojshme**.<br><br>Dokumentacioni që na u vendos në dispozicion vijon si më poshtë: | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | *Leje zhvillimi me NR.68 nr.prot 2632, datë 14/09/2018<br>*Vendim për miratimin e shtyrjes së afatit të lejes së ndërtimit Nr.82.Prot.3063/1,datë 26/08/2021.<br>*Foto të plan vendosjes.<br><br>Bashkëlidhur dokumentacioni dhe fotot. | | |
| 35 | 19.05.2023<br><br>11.08.2023 | **Adrian Puja**<br><br>Quhem Adrian Puja nga Kavaja dhe ankesa ime bën fjalë për një sipërfaqe toke 1050 m2 arë me adrëse domen e pajisur me çertifikatë pronësie me nr.pasurie 96/124, vol.5, faqe 131, zona kadastrale 1512 kavajë dhe mbi këtë sipërfaqe pa dijeninë time janë kryer dy ndërtime pa leje nga personi Leonard Peposhi, i cili ka ndërtuar 2 kioska mbi këtë pronë dhe e ka zaptuar padrejtësisht dhe pa asnjë dijeni timen.Ju lutem ta merrni në konsideratë rastin e mësipërm që prona të rikthehet në gjendjen fillestare dhe këto ndërtime të prishen e të merret masa e duhur administrative ndaj uzurpuesit të pronës.Numër | 01.06.2023<br><br>14.08.2023 | Deleguar IKMT Tiranë (22.05.2023)<br><br>Përshëndetje Z.Puja<br><br>Në vijim të ankesës tuaj, ju informoj se ankesa juaj po trajtohet dhe nga Drejtoria Rajonale IKMT Tiranë, në zbatim të Ligjit Nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme” i ndryshuar, I është drejtuar IMT Bashkisë Rrogozhinë , me shkresën bashkëlidhur nr.361/2.<br><br>Duke ju falenderuar për bashkëpunimin ,<br>Ditë të mbarë!<br><br>• Jemi në pritje të përgjigjes nga IMT | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kontakti : 0676818771.Me respekt Adrian Puja, Kavajë.<br><br>Përshëndetje ! Ju kërkoj ndjesë që po ju shkruaj këtë kërkesë në mënyrë të përsëritur, por kërkesa që ju dërgova me datë 19.05.2023 në e-mailin tuaj me adresë : besjona.cenaj@ikmt.gov.al, ju bëj me dije se ankesa ime që po trajtohet dhe nga Drejtoria Rajonale IKMT Tirane, ne zbatim te Ligjit Nr. 9780 datë 16.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme" i ndryshuar, i eshte drejtuar IMT Bashkise Rrogozhine , me shkresen bashkelidhur nr.361/2Prot date, por aktualisht ankesa ime nuk ka gjetur zgjidhur për shkak se Bashkia Rrogozhinë ose më saktë IMT Rrogozhinë po bën rolin inekzistent për shkaqe që nuk arrij ti kuptoj dhe nuk po i japin zgjidhje akoma sot e kësaj dite ankesës time dhe nuk kanë marrë masa me grupin e tyre të punës që të shembin këtë ndërtim të kundraligjshëm mbi tokën time. Kam mbetur i kënaqur me punën | | Bashkia Rrogozhinë, e më pas do njoftoheni dhe ju në vijim.<br><br>Pershendetje!<br><br>Ne vjim te ankeses tuaj, pas komunikimit me IKMT Drejtoria Rajonale Tirane te cilet na informojne se pas shkreses nr.361/2 Prot date 29.05.2023(per te cilen jeni ne dijeni) eshte perseritur kerkesa per IMT Bashkia Rrogozhine me shkresen nr.361/5 Prot date 07.08.2023 per te cilen jane ne pritje te pergjigjes.<br><br>Bashkangjitur po ju dergoje shkresen cituar me lart.<br><br>Ne momentin e marjes se nje pergjigje do ju njoftojme ne vijim.<br>Dite te mbare. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | tuaj dhe përgjigjet në kohë rekord dhe shqyrtimin e rastit tim me imtësi, por do ju lutem që ta ndiqni dhe njëherë më të detajuar këtë rast, sepse personi zaptues i tokës kur i shkon IMT e Rrogozhinës, ai shprehet se jam në proçes gjyqësor, ndërkohë që ai nuk ka asnjë lloj dokumenti që vërteton pronësinë mbi tokën time. Quhem Adrian Puja nga Kavaja dhe ankesa ime bën fjalë për një sipërfaqe toke 1050 m2 arë me adrëse Domen e pajisur me çertifikatë pronësie me nr.pasurie 96/124, vol.5, faqe 131, zona kadastrale 1512 kavajë dhe mbi këtë sipërfaqe pa dijeninë time janë kryer dy ndërtime pa leje nga personi Leonard Peposhi, i cili ka ndërtuar 2 kioska mbi këtë pronë dhe e ka zaptuar padrejtësisht dhe pa asnjë dijeni timen.Ju lutem ta merrni në konsideratë rastin e mësipërm që prona të rikthehet në gjendjen fillestare dhe këto ndërtime të prishen e të merret masa e duhur administrative ndaj uzurpuesit të pronës. Bashkëngjitur po ju sjell dhe planin e rilevimit. Numër kontakti | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | : 0676818771. Me respekt Adrian Puja, Kavajë. | | | | |
| 36 | 20.05.2023 | **IVMTBELSH**<br><br>Pershedetje!<br>Dua te denoncoj nje raste te nje ndertimi pa leje ku shtetasi Qerim Idrizi ka ndertuar nje objekt 2 kat pa leje ne fshatin idriz , Njesia Administrative Kajan, Bashkia Belsh | 24.05.2023 | Deleguar IKMT Elbasan (22.05.2023)<br><br>Përshëndetje!<br><br>Në vijim të ankesës tuaj, ju bëjë me dije fillimisht se kërkesa ishte një kërkesë anonime, e cila nuk duhej të rezultonte kështu, por institucioni ynë e trajtoi dhe e delegoi pranë Drejtorisë Rajonale Elbasan e cila na informon se:<br><br>Në objekt nuk kishte të pranishëm dhe nuk na u vu në dispozicion dokumentacioni për ndërtimin e objektit.<br><br>Me shkresën Nr.276/3, Prot datë 23/05/2023, iu dërgua IMT Bashkia Belsh për Kompetencë dhe veprime të mëtejshme.<br><br>IKMT Drejtoria Rajonale Elbasan do jetë në ndjekje të problematikës dhe sapo të informohemi nga IMT Belsh, do t’ju njoftojmë në vijim. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Faleminderit. | | |
| 37 | 24.05.2023 | **Andi Bega**<br>Pershendetje<br>Sic e shikoni ne fotot ne attach, jemi nje grup banoresh te OASIS RESIDENCE, qe nuk kemi garazhdet ne dipozicjon PER SHKAK TE MOS SHTRIMIT TE RRUGES JASHT ME ASFALT NGA BASHKIA, per kete arsye firma ndertuese nuk na i hap garazhdet<br><br>Eshte vetem 100 metra rruge per tu shtruar, zihemi me banoret cdo dite per vende parkimi neper rruge e neper cepa te zones<br><br>ADRESA: Rruga Feizi Himzo, prane xhamise , te kryqezimi i ri ne ASTIR,<br>Jemi 275 familje qe debatojme me njeri tjetrin per shkakun e rruges te pa asfaltuar<br><br>mbetemi ne pritje te pergjigjes tuaj<br>Faleminderit | 24.05.2023 | Përshëndetje<br><br>Në vijim të ankesës tuaj, ku parashtroni shqetësimin si më poshtë:<br><br>• Janë një grup banorësh nga kompleksi OASIS RESIDENCE<br>• Të cilët nuk kanë akses në garazhdet e tyre<br>• Për shkak të mosshtrimit të rrugës me asfalt nga Bashkia<br>• Arsye për të cilën firma ndërtuese nuk i hap garazhdet<br>• Problematikë e cila është bërë burim konfliti mes 275 familjeve banuese në kompleks<br>• Adresa: rruga "Feizi Himzo", pranë Xhamisë, kryqëzimi i ri në Astir<br><br>Ju bëjë me dije se ankesa juaj është deleguar pranë institucionit Bashkia Tiranë për verifikim dhe trajtim si organi | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | kompetent për territorin e Tiranës lidhur me problematikën që ju dërgoni.<br>Adresa e emailit me të cilën mund të kërkoni informacion lidhur me trajtimin e ankesës tuaj është **info@tirana.al**<br><br>Faleminderit për bashkëpunimin. | | |
| 38 | 25.05.2023 | **Elvis Hila**<br><br>Bazuar ne ligjin nr.119/2014 "Per te drejten e informimit" kerkoj informacion si me poshte:<br><br>1.Sa eshte numri i subjekteve te liçensuara per marrje inertesh ne Lumin Mat?<br><br>2.A ka patur ndonje aksion gjate diteve te fundit dhe cilat jane masat ndeshkimore qe jane marre?<br><br>3.A keni gjetur mbeshtetjen e institucioneve te tjera partnere per te vepruar?<br><br>Faleminderit | | Deleguar Mjedisit 25.05.2023<br>Përshëndetje Z.Hila<br><br>Në vijim të informacionit të kërkuar nga ana juaj ju informoj se kërkesa juaj është trajtuar nga Drejtoria e Inspektimit te Mjedisit dhe Ujerave dhe vijon si më poshtë:<br><br>• Sa është numri i subjekteve te licensuara për marrje inertesh në Lumin Mat?<br>Në lidhje me këtë informacion mund t’i drejtoheni AMBU, pasi kjo është kompetencë e këtij institucioni që pajis me leje subjektet.Ky institucion ka | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Elvis Hila Gazetar i Report Tv | | database të lejeve për shfrytëzimin e lumenjve.<br>• A ka patur ndonjë aksion gjatë ditëve të fundit dhe cilat janë masat ndëshkuese që janë marrë?<br>Po, në lumin Mat ka pasur kontrolle nga inspektorët e IKMT, ku nga inspektimet e kryera janë konstatuar 4 (katër) subjekte që shfrytëzonin shtratin e lumit Mat pa leje, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore. Për këto subjekte janë marrë masat përkatëse ligjore si: Dënim Administrativ kryesor me Gjobë dhe Dënim Administrativ Plotësues Sekuestrim i Mjeteve që shfrytëzonin në mënyrë të paligjshme.<br>• A keni gjetur mbështetjen e institucioneve të tjera partnere për të vepruar?<br>IKMT ka vepruar në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe me Krimin Ekonomik për këdo subjekt që shfrytëzonte inertet lumore | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | duke mbajtur procedurat përkatëse ligjore për shkelësit e ligjit.<br><br>Faleminderit. | | |
| 39 | 28.05.2023 | Bobillazi444<br>Pershendetje Doha te denoncoja njw rast ndertimi pa Leje ne territor te made buze autostrades me lushnje. Objects pa Leje po ndertohet tek karburant isai ne saver lushnje. Nuk vepron asnjjeri per kete gje ju lutem vepronі | 02.06.2023 | Deleguar IKMT Fier<br><br>Në vijim të komunikimeve në lidhje me ankesën për ndërtim të paligjshëm në anë të autostradës Lushnje-Fier, në Savër pranë Karburant Isai, ankesë e ardhur në adresën elektronike të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ju bëjmë me dije se Inspektorët e Territorit Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, Drejtoria Rajonale Fier, kryen verifikimet në vendin e pretenduar ku u konstatua se Subjekti Bashkimi/L , është i pajisur me lejen e ndërtimit Nr.268, datë 15.11.2022, leje e miratuar nga Bashkia Lushnje. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | U konstatua se në vendin e pretenduar jemi në fillimin e punimeve të miratuara nga Bashkia Lushnje dhe ndodhemi para faktit që jemi në fazën e përgatitjes së terrenit për kryerjen e ndërtimit.<br>Subjekti na vuri në dispozicion një kopje të dosjes me dokumentacionin tekniko-ligjor.<br>Ndodhemi para faktit që ndërtimi i këtij objekti ndodhet pranë autostradës Lushnje-Fier. Objektin do t'a verifikojmë në faza të ndryshme për respektimin e lejes së ndërtimit Nr.268, datë 15.11.2022, leje e miratuar nga Bashkia Lushnje.<br><br>Faleminderit për bashkëpunimin. | | |
| 40 | 30.05.2023<br>10.09.2023 | Pershendetje,<br><br>Me kete imail doja te beja nje denoncim lidhur me faktin qe pronari i Hotelit tropikal Andon | 06.06.2023 | Përshëndetje!<br><br>Në vijim të ankesës tuaj ju informoj se është deleguar për | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | alushi ne zonen bregtetare Bunec po kryen ndertime pa leje.<br><br>Une jam munduar ta bej denoncimin tim ne e albania ose shqiperi qe duam por eshte e pa mundur sepse nuk jetoj ne Shqiperi edhe nuk kam aplikimin e e albania.<br><br>Une kam qen para 2 muajve ne Shqiperi edhe kam keto informacjone te ndertimit pa leje. Po bashkangjit fotot ku duket qarte dhoma prej druri e vedosur mbi lume po edhe<br>xhamari e ndertuar pa leje .<br><br>I njejti pronar po pergatit te hapi kampe pushimi per pushues ne nje territor qe nuk eshte i tija ne krah te lokalit.<br>Po ju dergoj edhe numrin e lishençes te lokalit te ju ndihmoj sado pak<br>L84406804L<br>Pronari ketij lokali nuk poguan tatimet e duhura ne shtet.<br>Mund te me kontaktoni per me shume informacjone<br>Faleminderit<br>--- Pershendetje | | trajtim nga Drejtoria Rajonale IKMT Vlorë.<br><br>Në momentin e marrjes së një përgjigjeje, do të njoftoheni në vijim.<br><br>Faleminderit për bashkëpunimin.<br>--Riderguar Vlores. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Ne vijim te denoncimit tim jam informuar se 2 ispektoret e Himares kane vajtur te lokali i Andon Alushit sot.<br>Ata kane vajtur per dreke kan ngren edhe pire ne lokal.<br>Nderkohe punimet qe jane bene pa leje qendrojne akoma<br>Asnje mase nuk eshte mare<br>Por edhe me shume akoma Andon Alushi ka zene shume vend ne anen tjeter te lumit duke vendosur atje çadra pa leje per turistet pa prere asnje fature tatimore. (Zoti Andon Alushi vetem 1 krevat e jep me qira ne nate 80€)<br>Me vjen shume keq qe kam harxhuar kohen duke ben kete denoncim edhe per fat te keq te dhenat e mia nuk jane ruajtur nga ispektoret e pare qe kane vajtur ne vend.<br>Shpresoj qe te dhenat e mia te ngelen konfidanciel ju lutem<br>Une e kam bene ket denoncim ne mirebesim<br>Faleminderit | | | | |
| 41 | 30.05.2023 | Pershendetje Zoterinj<br>Ju shqeteson Profesor Doctor Naqo Sinani per sa me poshte | 01.06.2023 | Përshëndetje Z.Sinani<br><br>Në vijim të kërkesës tuaj për të ju mundësuar një takim me | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | I lutem Zonjes Besjona Canal te Komunikoje me Sekretaren e Kryeinspektorit IKMT Zotit Agim Ismali dhe te me caktoje nje takim te shkurter personalisht me Zotin Agim.Ne diten dhe oren qe Ay do te kete mundesi.Me qene se jam shume i moshur Ju lutemi me njoftoni nje dite perpara.<br><br>Personalisht K/Inpekorit Zotit Agim Ismali me date 9 Maj me poste i kam derguar nje dosje te plote te komplentuar per NJE KALLEZIM PER NJE KRIM TE KRYER PER NJE NDERTIM PA LEJE.<br>Ne kete takim te shkurter personalisht me Zotin Agim do ti jap dhe disa sqarime suplementare qe ka te beje me kete kallezim.<br><br>Jam ne pritje te pergjigjes Tuaj per diten dhe oren e takimit.<br><br>Komunikimi E/mail naqosinani@ dhe cel 068474<br><br>Me respekt Prof.Doctor Naqo sinani | | Kryeinspektorin e IKMT-së, ju bëjë me dije se mund të paraqiteni pranë zyrave të IKMT-së, rruga "Muhamet Gjollesha",ngjitur me Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit,Tiranë. (orari më i përshtatshëm do të ishte gjatë paradites)<br><br>Ditë të mbarë! | | |
| 42 | 02.06.2023 | Irida Bushati<br>Pershendetje | | Deleguar Tiranës(05.06.2023) | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 06.06.2023 | Ju paraqesim kete ankese, nga ana e bar Pastel, prane kopshtit botanik, eshte zene e gjithe hapesira publike midis 2 pallateve ... Tashme vazhdojne punimet, cdo dite nga ora 16-23.00 ne ambjentin bar "Pastel" punohet me mjete te renda betoniere, matrapik, thyejne muret, hedhin beton. Ambjentet e garazhit te pallatit jane kthyer ne lavazh nga i njejti pronar i bar " pastel"<br>Ju lutemi te ndiqet ky rast<br>Duke shpresuar qe kjo ankese te merret ne konsiderate,<br>Me respect<br>Pershendetje<br><br>Jam nje qytetare banore ne Tirane, njesia 13, Rr.Alla, prane Kopshtit Botanik.<br>Parashtroj kete ankese prane institucionit tuaj ne lidhje me nje ndertim te paligjshem i cili ka zene te gjithe hapsiren publike midis 2 pallateve nga bar "Pastel". Ka kohe qe punohet cdo mbasdite nga ora 17.00-23.00 me mjete te renda, matrapik, thyejne mure, kollona, prodhojne beton dhe shtrojne ne ambjentet e brendshme. | | Përshëndetje!<br><br>Në vijim të ankesës tuaj ju bëjë me dije se ankesa juaj është deleguar për trajtim Drejtorisë Rajonale IKMT Tiranë, që në momentin që e keni dërguar për herë të parë.<br><br>Ju informoj që edhe këto informacione do t'i dërgohen gjithashtu .<br><br>Faleminderit për bashkëpunimin.<br><br>Deleguar Dr.Tiranës<br>Pershendetje!<br><br>Ne vijim te ankeses tuaj, ashtu sic ju kemi informuar ankesa juaj eshte trajtuar dhe kemi mare pergjigje nga Bashkia Tirane dhe nga Komisariati i Policise nr.1<br>Bashkangjitrur shkresat :<br>• Nr. 4283/1 Prot date 27.06.2023<br>• Nr.5446/1 date 30.06.2023 | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Ju lutemi te merret parasysh kjo ankese dhe te shqyrtohet rasti. Bashkelidhur do te gjeni foto dhe video te punimeve | | Duke ju falenderuar per bashkepunimin. | | |
| 43 | 02.06.2023 | pershendetje jam hamza kllogjri banues ne prrenjas po ju njoftoj per 1 ndertim pa leje qe po behet ne qytetin e prrenjasit adresa bar restorant alla rruga nacionale prrenjas. ndertim pa leje si para objektit dhe mbrapa me tend dhe zaptim i prones publike. lutemi sa me shpejt te vijn inspektoret per vezhgim pasi drejtori i urbanistikes prrenjas po e mbeshtet z,ani allko pasi leshon procesverbal pa nr protokolli . faleminderit | 06.06.2023<br>03.07.2023 | Përshëndetje Z.Kllogjeri<br><br>Në vijim të ankesës tuaj, ju informoj se ankesa juaj është deleguar pranë IKMT Drejtoria Rajonale Elbasan për verifikim dhe trajtim.<br><br>Në përfundim, do të njoftoheni për përgjigjen e ardhur.<br><br>Faleminderit për bashkëpunimin.<br><br>---Përshëndetje!<br><br>Në vijim të ankesës tuaj, ashtu sic jeni vënë në dijeni se ankesa juaj po trajtohet, po ju informoj për zhvillimet dhe përgjigjet e fundit të ardhura nga Drejtoria Rajonale. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | IMT-Bashkia Prrenjas na ka informuar se ka konstatuar se shtetasi z.Aleko Alla ka kryer shtrimin me pllaka (kocke) në pronën publike me pronar shtet dhe është mbajtur proces-verbali "Për Konstatimin e Kundravajtjes" nr.174, dt.30.05.2023, por nuk na ka vendosur në dispozicion procedurën administrative, vendim për dënimin me gjobë, vendim për prishjen e objektit të kundraligjshëm, ekzekutimin e vendimit të prishjes dhe kallëzimin penal.<br><br>Me shkresën tonë "Kërkohet informacion", nr.290/6, dt.14.06.2023, i kemi kërkuar informacion për procedurën administrative, kallëzimin penal, ekzekutimin dhe të na vihet në dispozicion plan vendosja e strukturës së miratuar për vendimin nr.64, dt.24.04.2023 "Për miratimin e deklaratës paraprake për kryerje punimesh", të dhënë nga Bashkia Prrenjas.<br><br>Gjithashtu i kemi kërkuar procedurën administrative në | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | lidhje me derën që eshtë hapur dhe mbyllur vullnetarisht dhe vendosjen e tendës nga mbrapa objektit.<br><br>Jemi në pritje të përgjigjes nga IMT Bashkia Prrenjas.Në vijim do të informoheni.<br>Ditë të mbarë!<br><br>--- Përshëndetje!<br><br>Në vijim të ankesës tuaj, ju informoj si më poshtë:<br><br>Me shkresën "Kërkohet informacion", nr.290/6, dt.14.06.2023, të IKMT-Drejtoria Rajonale Elbasan i jemi drejtuar IMT-Bashkia Prrenjas dhe na është kthyer përgjigje me shkresën nr.1627/1 Prot. dt.26.06.2023, ku na informon se janë ndjekur të gjitha procedurat përkatëse për shtetasin z.Aleko Alla. Përsa i përket derës së pasme,na bën me dije se ka qenë ndërtuar vite më parë dhe duke qenë objekt konflikti | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | midis palëve u bë mbyllja vullnetare e saj. Gjithashtu tenda mbrapa lokalit ka qenë ekzistuese. Në momentin e kontrollit është konstatuar pa lejen përkatëse vetëm shtrimi i pllakave.<br>Bashkëngjitur:<br>• Plan vendosja e strukturës.<br>• Vendim nr.33, datë 30.05.2023, "Për Pezullimin e Punimeve<br>• Vendim nr.17, datë 30.05.2023, "Për Denimin me Gjobë"<br>• Vendim nr.5, datë 30.05.2023, "Për Prishjen e Objektit të Kundraligjshëm"<br><br>Me shkresën "Kërkesë për informacion" nr.  290/8 Prot, dt.29.06.2023, i jemi drejtuar IMT-Bashkia Prrenjas, për të na vënë në dispozicion kallëzimin penal dhe procedurën administrative në lidhje me mbylljen e derës.<br><br>Punë të mbarë! | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| 44 | 03.06.2023<br><br>14.06.2023 | **Gezim Boçari**<br><br>E nderuar znj.Besjona Cenaj.<br>ju dergoj kerkesen per IMT Vlore.<br>Bashkelidhur karta e identitetit , çertifikata e pronesise dhe lejen nga Bashkia per riparimin e objektit.<br>Ju lutem me njoftoni per regjistrimin e kerkeses.<br>me respskt<br><br>Prof. Dr. Gezim Boçari<br><br>E nderuar znj Koordinatore e IKMT për të drejtën e informimit<br>Ju lutem me informoni per veprimet e IMT dega Vlorë për rrethimin e paligjëshëm të bërë nga persona tè tretè nè pronèn e familjes Boçari në pronèn tonè tek ish sektori i zyrave të aksionit të rinisë Vlorè nè ZK 8602 . Kmi marrë nga Bashkia Vlorè , leje pèr resturimin e kesaj prone por rrethimi nuk na lejon<br>Bashkèlidhur çertifikata e pronèsisè dhe leja qe kemi marrë nga Bashkia pèr resturimin e kesaj prone | 13.06.2023<br><br>26.07.2023 | Deleguar Dr.Vlorës( 05.06.2023)<br><br>Përshëndetje!<br><br>Në vijim të ankesës tuaj,ku bëhej fjalë për rrethim të paligjshëm nga persona të tretë në pronën tuaj, u krye inspektimi në terren.<br><br>Gjatë kontrrollit të ushtruar nuk u konstatua se po kryheshin punime të reja.<br><br>Objekti ishte i mbyllur,ndaj nuk arritëm të komunikonim me pronarët.<br><br>Bashkëlidhur po ju nisim fotot gjatë inspektimit të kryer.<br><br>Ditë të mbarë!<br><br>Po iu bashkelidhim kerkesen per informacion drejtuar IMT Bashkia Vlore me date 15/06/2023 me Nr 342/0-1 dhe kerkesene e perseritur per informacion ndaj IMT Bashkia | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ----E nderur znj. Besiona Cenaj,<br>Fotot që më keni dërguar për objektin që keni inspektuar nuk janë objekti dhe rrethimi për të cilin jam ankuar. Sa shkruani ,se inspektorët tuaj nuk kanë takuar pronarin është normale pasi unë, që jam pronari në bashkëpronësi me trashegimtarë të tjerë, jam në Tirane dhe aty nuk po kryhen punimet për të cilat është marrë leja në Bashki<br><br>Unë kam kërkuar nga IMT, ndihmë për heqjen e rrethimit me tela dhe shtylla betoni, që kanë vendosur persona te tretë tek shtëpia që kemi pranë hotelit Aross që ka ngritur J. Sota, si ne foton bashkelidhur. Ky rrethim me tela dhe shtylla te shkurtera betoni pengon te bëjme riparimet dhe të heqim plehrat që kanë hedhur qëllimisht brenda objektit dhe pronës tonë, për të na penguar.<br><br>Ju lutem të veproni sa në shpejt për heqjen e këtij gardhi dhe na | | Vlore e date 05/07/2023 me Nr. 342/2-3<br><br>Pune te mbare!<br> | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | njoftoni, pasi ky rrethim me tela dhe mbushja e objektit me plehra shqetësojnë mjedisin, mbrojnë transferimin e paligjshëm të trojeve turistike dhe vazhdojnë të pengojnë ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ Gjonbocari/2007 neni 101. | | | | |
| 45 | | **Hamza Kllogjri**<br>pershendetje jam **Hamza Kllogjri** banues ne prrenjas po ju njoftoj per 1 ndertim pa leje qe po behet ne qytetin e prrenjasit adresa bar restorant alla rruga nacionale prrenjas. ndertim pa leje si para objektit dhe mbrapa me tend dhe zaptim i prones publike. lutemi sa me shpejt te vijn inspektoret per vezhgim pasi drejtori i urbanistikes prrenjas po e mbeshtet z,ani allko pasi leshon procesverbal pa nr protokolli . faleminderit | 06.06.2023<br>15.06.2023<br>03.07.2023 | Deleguar IKMT Elbasan<br>Përshëndetje Z.Kllogjeri<br>Në vijim të ankesës tuaj, ju informoj se ankesa juaj është deleguar pranë IKMT Drejtoria Rajonale Elbasan për verifikim dhe trajtim.<br>Në përfundim, do të njoftoheni për përgjigjen e ardhur.<br>Faleminderit për bashkëpunimin.<br>---Përshëndetje!<br>Në vijim të ankesës tuaj, ashtu sic jeni vënë ne dijeni se ankesa juaj po trajtohet, po ju informoj për zhvillimet dhe përgjigjet e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | fundit të ardhura nga Drejtoria Rajonale Elbasan.<br><br>IMT-Bashkia Prrenjas na ka informuar se ka konstatuar se shtetasi z.Aleko Alla ka kryer shtrimin me pllaka (kocke) në pronën publike me pronar shtet dhe është mbajtur proces-verbali "Për Konstatimin e Kundravajtjes" nr.174, dt.30.05.2023, por nuk na ka vendosur në dispozicin procedurën administrative, vendim për dënimin me gjobë, vendim për prishjen e objektit të kundraligjshëm, ekzekutimin e vendimit të prishjes dhe kallëzimin penal.<br><br>Me shkresën tonë "Kërkohet informacion", nr.290/6, dt.14.06.2023, i kemi kërkuar informacion për procedurën administrative, kallëzimin penal, ekzekutimin dhe të na vihet në dispozicion plan vendosja e strukturës së miratuar për vendimin nr.64, dt.24.04.2023 "Për miratimin e deklaratës paraprake për kryerje punimesh", të dhënë nga Bashkia Prrenjas. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Gjithashtu i kemi kërkuar procedurën administrative në lidhje me derën që është hapur dhe mbyllur vullnetarisht dhe vendosjen e tendes nga mbrapa objektit.<br><br>Jemi në pritje të përgjigjes nga IMT Bashkia Prrenjas.Në vijim do të informoheni.<br><br>Ditë të mbarë!<br><br>----Përshëndetje!<br><br>Në vijim të ankesës tuaj, ju informoj si më poshtë:<br><br>Me shkresën "Kërkohet informacion", nr.290/6, dt.14.06.2023, të IKMT-Drejtoria Rajonale Elbasan i jemi drejtuar IMT-Bashkia Prrenjas dhe na është kthyer përgjigje me shkresën nr.1627/1 Prot. dt.26.06.2023, ku na informon se janë ndjekur të gjitha procedurat përkatëse për shtetasin z.Aleko Alla. Për sa i përket derës së pasme na | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | bën me dije se ka qenë ndërtuar vite më parë dhe duke qenë objekt konflikti midis palëve u bë mbyllja vullnetare e saj. Gjithashtu tenda mbrapa lokalit ka qenë ekzistuese. Në momentin e kontrollit është konstatuar pa lejen përkatëse vetëm shtrimi i pllakave.<br><br>Bashkëngjitur:<br><br>• Plan vendosja e strukturës.<br>• Vendim nr.33, datë 30.05.2023, "Për Pezullimin e Punimeve<br>• Vendim nr.17, datë 30.05.2023, "Për Denimin me Gjobë"<br>• Vendim nr.5, datë 30.05.2023, "Për Prishjen e Objektit të Kundraligjshëm"<br><br>Me shkresën "Kërkesë për informacion" nr.  290/8 Prot, dt.29.06.2023, i jemi drejtuar IMT-Bashkia Prrenjas, për të na vënë në dispozicion kallëzimin penal dhe | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | procedurën administrative në lidhje me mbylljen e derës.<br><br>Punë të mbarë! | | |
| 46 | 05.06.2023<br>06.06.2023 | **Oneda Mersini**<br><br>jam pronare e nje dyqani me qera, i cili ka nje dritare te vetme qe shikon nga ana e passhme e pallatit, pallati i kantierit, Durres. Kjo dritare eshte e vetjma dritare qe qeraxhiu ka per te ajrosur te gjithe ambjentin, nje piceri e vogel. Nga mbrapa pallatit, dikush ka hapur nje lokal dhe pa leje ka mbyllur dritaren e picerise duke e bere ambjent me tavolina dhe duke mos u preokupuar fare qe dritarja e picerise eshte bllokuar dhe ambjenti nuk mer me ajer. Do ishte e mundur nga ana juaj te me tregoni proceduren qe duhet ndjekur? Une banoj jasht vendit dhe dua fillimisht te verifikoj neqoftese ka mundesi te bej dicka nga ketu. Ndoshta duhet te drejtohem tek ndonje avokat qe mund te ndjeke praktiken apo mjafton denoncimi online?<br><br>Ju faleminderit. | 05.06.2023<br>06.06.2023<br>12.06.2023 | --Përshëndetje!<br><br>Në vijim të ankesës tuaj , kërkojmë nga ana juaj adresën e saktë të pronës dhe gjithashtu një emër të kundravajtësit, subjektit që ka zënë dritaren tuaj,në mënyrë që të bëhet e mundur verifikimi i ankesës, si dhe përshkrimin e situatës(ashtu sic e keni shpjeguar që ju është zënë dritarja).<br><br>Më pas institucioni ynë e delegon pranë Drejtorisë Rajonale IKMT Durrës për verifikim e trajtim.<br><br>Faleminderit për bashkëpunimin.<br>DELEGUAR DURRËSIT (06.06.2023)<br><br>--Përshëndetje Zj.Mersini | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Oneda Mersini**<br>Dyqani është dhënë me qera dhe ka një dritare të vetme që shikon nga ana e passhme e pallatit të mësipërm. Kjo dritare është e vetjma dritare që qeramarrësi ka për të ajrosur të gjithë ambjentin, një piceri e vogel.<br>Nga mbrapa pallatit, dikush ka hapur një lokal dhe pa leje ka mbyllur dritaren e picerisë duke e bere ambjent me tavolina dhe duke mos u preokupuar fare që dritarja e picerisë është bllokuar dhe ambjenti nuk mer më ajër. Bashkangjitur janë edhe fotot e bëra nga brënda, ku shikohet qartë që pamja eshte mbyllur.<br><br>Përshëndetje Besjona,<br><br>Ju falenderoj dhe komplimentoj për shpejtësine në përgjigje dhe në marrjen përsipër të ankesës.<br><br>Përshkrimi i ankesës:<br><br>Jam pronare e një dyqani me qera, i cili ndodhet në katin e parë te një pallati, në këtë adresë: | | Në vijim të trajtimit të ankesës tuaj, ju bëjmë me dije se Inspektorët e Sektorit të Inspektimit të Territorit, IKMT-Drejtoria Rajonale Durrës, u paraqitën në adresën në fjalë për të verifikuar rastin.<br><br>Nga verifikimi i situatës në terren rezulton se:<br>Ndërmjet dritares së ankueses dhe ambjentit me funksion "piceri", është vendosur një barrierë me profile metalike e veshur me lule artificiale, e cila është e lëvizshme, e pafiksuar në mënyrë të pazgjidhshme me sipërfaqen e ambjentit.<br><br>Përsa më sipër, ju bëjmë me dije se ankesa në fjalë nuk është objekt i punës sonë,pasi nuk kemi të bëjmë me një ndërtim.Objekti i punës së IKMT, referuar Ligjit 9780, dt 16.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit", i ndryshuar, është kontrolli dhe disiplinimi i punimeve në ndërtim... | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Eljo's Pizza, Rruga Egnatia, Durrës, Albania<br>https://maps.app.goo.gl/Nb9HcHLPRVC6mTAr6?g_st=iw<br><br>Kundravajtësi, quhet Përparim dhe vajza e cila menaxhon lokalin quhet Ana, aktiviteti quhet “Delicioz Dish”, kërkova NIPT por nuk ka.<br>Për fat të keq nuk kam mbiemër te personave që kanë hapur lokalin, në këto raste nuk është kaq i kollajshëm bashkëpunimi.<br>Nëqoftëse është e mundur mund të paraqiteni direkt tek piceria, qeramarrësi (pala e dëmtuar) quhet Eljo Gjyzeli, mund ta kontaktoni tek ky numër: +355 69 863 3383<br><br>Ju falenderoj edhe një herë per korrektësinë.<br>Mbetem në pritje të zhvillimit.<br><br>----Përshëndetje Besjona,<br><br>Ju falenderoj shumë për verifikimin që keni bërë. Kërkoj ndjesë nëqoftëse kam adresuar gabim kërkesen, por kur u | | Lutemi të drejtohet pranë instancave përkatëse **(Policisë Bashkiake)**.<br><br>Ditë të mbarë! | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | interesova më drejtuan tek istitucioni juaj.<br>Do drejtohem aty ku duhet dhe ju falenderoj për gjithcka. | | | | |
| 47 | 07.06.2023 | Unë i quajturi Hajrulla Basri Zerja, banues në Pallatin 167, rruga “Hamdi Cenoymeri”, Njësia Bashkiake nr.6, Kombinat Tiranë, në emër dhe të banorëve të tjerë të këtij pallati, sic janë Edmon Comani dhe Esat Memishaj, po ju bëj **ankesë,** për qyetarin Ilir ....., banues po në këtë pallat.<br>Qytetari Ilir ...., nga ana e pasme e pallatit 167, ka ndërtuar nje objekt tip banjo, jashtë objektit të pallatit dhe ka bërë rrethim për mbajtën e pulave gjë e cila ka krijuar shqetësim me aromën e rëndë të jashtëqitjes së pulave dhe WC në obor të pallatit, duke krijuar kështu një burim infeksioni dhe shqetësim për pallatin 167, si dhe ndotje akustike të vazhdueshme nga kakarisja e pulave dhe gjelave.<br>me dije se është bërë ankesë në rajonin e Policisë nr.6, në Kombinat dhe nuk është proceduar në lidhje me këtë ankesë, si heqa e objektit tip WC apo rrethimit të mbajtës së pulave. | 15.06.2023 | Përshëndetje!<br><br>Në vijim te ankesës së ardhur pranë IKMT-së, ju bëjmë me dije se ankesa është trajtuar nga Drejtoria Rajonale IKMT Tiranë, e cila na informon si më poshtë:<br><br>Pas inspektimit të kryer nga ana jonë, në terren u konstatua se:<br><br>• Objekti ishte i ndërtuar vite më parë (i vjetër) dhe rrethimi i cili shfytëzohej për mbajtjen e pulave,ishte hequr në bashkëpunim me policinë.<br>• Gjatë momentit të inspektimit nuk u konstatuan punime ndërtimore në proces.<br><br>Duke ju falenderuar për bashkëpunimin. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | egimeve të tyre është thënë që e ka kopetence Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, (IKMT), Tiranë.<br>Ju lutem të meren masa në lidhje me këtë problem pasi është shume shqetësuese për banorët e pallatit 167 dhe shtëpitë e tjera përreth.<br>Mbetemi në pritje të zgjidhjes së problemit nga ana juaj sa më shpejtë të jetë e mundur.<br>Ju faleminderit,<br>Me respekt,<br>**Qytetarët ankues:**<br>Edmond Comani,<br>Esat<br>Memishaj,<br>Hajrulla Zerja. | | | | |
| 48 | 08.06.2023 | Pershendetje!<br>Komshiu ku jetoj **Niko Gjiza** banues ne rrugen 4deshmoret njesia administrative numer 8<br>Per dite ben punime te objektit te tij pa nje leje nje tull sot nje tull neser nje suvatim sot nje suvatim neser hap dritare dhe kalohet pa u veshtruar.<br>Personi ne fjal ka 2 dritare te hapura qe kan pamje ne oborrin e shtepis time. | 12.06.2023<br>10.07.2023 | Deleguar Tiranë (09.06.23)<br>Përshëndetje!<br><br>Në vijim të ankesës tuaj, ju informoj se ankesa juaj është dërguar për trajtim nga Drejtoria Rajonale IKMT Tiranë.<br><br>Në momentin e marrjes së një përgjigjeje, do të njoftoheni në vijim. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Ne fotot me posht po ju nis foto te banese si ka qen dhe si eshte ber aktualish.<br>Ju lutem te nderhyni te mbylli dritaret qe shohin nga oborri im dhe te verifikohet leja per punimet qe ben.<br><br>Pune te mbare! | | Faleminderit për bashkëpunimin.<br><br><br>---Përshëndetje!<br><br>Ashtu sikurse jeni në dijeni, ankesa juaj është trajtuar nga IKMT Drejtoria Rajonale Tiranë, e cila na informon se: Pas korrespondencës shkresore me IMT-Bashkinë Tiranë ku kërkojmë të kryhen inspektimet dhe verifikimet përkatëse lidhur me punimet ndërtimore të cituara dhe të na vihet në dispozicion informacioni dhe dokumentacioni i plotë i administruar nga ana e tyre, IMT Bashkia Tirane na bën me dije se:<br><br><br>Inspektorët kanë kryer verifikimin e ankesës në terren, dhe në objekt nuk kanë konstatuar situatë ndërtimore në process.Për derën dhe dritaren që pretendohet në ankesën tuaj, rezultojnë se janë bërë vite më pare.<br>Bashkëlidhur, po ju dërgojmë foto të objektit gjatë | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | inspektimit, si dhe foto të objektit sic ka qënë vite më parë.<br><br>Ditë të mbarë! | | |
| 49 | 13.06.2023 | **Te nderuar!**<br>Sipas vendimit të këshillit të ministrave nr. 447, datë 16.06.2010 "Per administrimin e rregullores tip të administrimit te bashkepronesise ne ndertesat e banimit" miratuar në zbatim të nenit 214 te Kodit Civil, si dhe Ligjit 10112 date 06.04.2009 "Per administrimin e bashkepronesise ne ndertesat e banimit" si banore i njësisë në këtë Pallat Ju bej me dije se;<br>Ne apartamentin tim vjen erë e rende nga oxhaku i aspirimit të kuzhinave per shkak te nderhyrjeve ne tubat e aspirimit. Per kete kam kontaktuar Administratorin e pallatit por edhe ai nuk eshte ne gjendje te me thote aresyen. Edhe banoret ne njesite lart dhe poshte apartamentit tim kane te njejten problem dhe thone se ne ndezim aspiratorin per ti larguar erërat e këqija. | 18.07.2023 | Deleguar Dr.Tiranës<br>Pershendetje,<br><br>Referuar ankeses tuaj ardhur ne adresen zyrtare te Koordinatorit per te Drejten e Infromimit ku parshtroni shqetesimin si me poshte:<br>• Ne apartamentin e tyre vjen erë e rende nga oxhaku i aspirimit të kuzhinave per **shkak te nderhyrjeve ne tubat e aspirimit**<br>• Edhe banoret ne apartametet me lart dhe poshte apartamentit saj kane te njejten problem, Adresa: Pallati 122. Rruga e Kavajes, Shkalla 2 | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Për këtë po i drejtohem IKMT Tiranë, për kontrollin e standarteve të administrimit sipas Nenit 24 të ligjit nr. 10112. datë 06.04.2009 në bashkëpunim me Kryesinë e Asamblese së Njësisë, dhe Administratorin.<br><br>Faleminderit për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin.<br>Adresa: Pallati 122. Rruga e Kavajes, Shkalla 2.<br>cel 0697788338. | | Nga kontakti i marre ne numrin e telefonit te mesiperm, ankuesi na komunikon se me kete rast po merret administratori i pallatit.<br><br><br>Faleminderit per bashkepinimin. | | |
| 50 | 14.06.2023 | Përshëndetje, Besjona...<br><br>Uroj të jeni mirë.<br><br>Ju lutem, brenda mundësive do doja të informohesha rreth vendeve vakante tek ju, si edhe në cilën adresë email-i më duhet të aplikoj, pasi në faqen zyrtare nuk e shoh një opsion të tillë.<br><br>Duke ju falenderuar!<br><br>Me respekt,<br><br>MSc.ing Sedi. | 15.06.2023 | Përshëndejte!<br><br>Në vijim të e-mailit tuaj , mbi shprehjen e interesit për aplikim pune pranë IKMT-së, ju informojmë se mund të paraqisni kerkesën tuaj pranë zyrës Arkiv-Protokoll, bashkangjitur dosjen tuaj profesionale për vlerësime të mëtejshme.<br><br>Duke ju falenderuar për interesimin. | | |
| 51 | 14.06.2023 | Pershendetje, | 14.07.2023 | Deleguar Dr.Tiranës.<br>Pershendetje | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Ju shkruajme nga kompania: SPEFIN FINANZIARIA SPA , me NIPT **M22317023M**<br>Me seli te Rruga e Kavajes, Prane Globe, PALLATI Baja-BAD , kati 10 & 11 , Tirane.<br><br>Prane zyrave tona ( diku nga katet me posht nesh ose anash ) po behen disa punime duke shkaktuar nje zhurme e cila na e ben te pamundur punen dhe qendrimin ne zyre,<br>Ju kemi kontaktuar ne nr tuaj qe keni vene ne dispozision per ankesa nga qytetaret taksapagues ne sitet ne internet **por asnje pergjigje**, dhe nr dalin te padisponueshem ose te zene.<br>**JU LUTEM TE VINI TE BENI INSPEKTIMET E NEVOJSHME** NESE ku po behen punimet kane leje ose perndryshe ta merni ne konsiderate ankesen tone pasi po behet nje shqetesim shum I madh dhe duhet te marë zgjidhje te menjehershme!!!<br><br>Ne pritje te nje kthimi pergjigjeje.<br>Ju faleminderit! | | Në vijim të ankesës tuaj ku parashtroni shqetesimin si më poshtë;<br>• Po bëhen disa punime duke shkaktuar një zhurmë e cila na e ben të pamundur punën dhe qendrimin në zyrë,<br>• Adresa Pranë Globe, PALLATI Baja-BAD , kati 10 & 11 , Tiranë.<br>• Kërkon nga institucioni jonë të bëhen inspektimet e nevojshme se ku po bëhen punimet, dhe a kane lejen e nevojshme.<br><br>Ankesa eshte trajtuar nga Drejtoria Rajonale IKMT Tiranë e cila na informon se gjatë momentit të inspektimi u mor kontakti me ankuesin ku na vuri në dispozicion emailin, dhe përgjigjen e Policisë Bashkiake.<br><br>• Në objektin e Z.Arbri Gjuzi u konstatuan punime si lyerje të ambienteve të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | brendshme, zëvëndësim i dyerve të brendshme.<br>• Nuk u konstatuan zhurma në momentin e inspektimit.<br>• Theksojmë se u pohua nga përfaqësuesit e kompanisë se 15 ditë e në vazhdim nuk a pasur zhurma.<br>• Nuk u konstatuan punime të paligjshme në proces<br>• Punimet ishin të kryera sipas Nenit 6, Vkm 408, pa patur nevojë për Leje Ndërtimi<br>• Bashkëlidhur foto dhe emaili.<br><br>Faleminderit për bashkëpunimin.<br>Punë të mbarë! | | |
| 52 | 15.06.2023 | Përshëndetje, unë e nënshkruara Stela Kujtim Pagria kam dërguar një denoncim me postë në datë 06.06.2023, Nr protokolli 3015, " denoncim për ndërtim pa leje në një godine 2 katëshe në rrugën Sinan Ballaci, Delvinë. | | Përshëndetje Zj.Pagria!<br><br>Në vijim të kërkesës tuaj për informacion rreth ankesës tuaj, nga kërkimet në arkiv-protokoll, rezulton që është nisur shkresa nr.3015/1 Prot | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | E shkruaj këtë email për tu siguruar se denoncimi im do të vërë në lëvizje institucionin tuaj, dhe do ju lutesha të kisha një informacion me të detajuar të punës konkrete në terren.<br><br>Duke ju uruar gjithë të mirat,<br><br><br>STELA PAGRIA | | datë 05.07.2023, drejtuar IMT-së Bashkia Delvinë.<br><br>Në momentin e ardhjes së një përgjigjeje, do të njoftoheni në vijim.<br>Bashkangjitur shkresa.<br><br>Ditë të mbarë! | | |
| 53 | 17.06.2023 | Fjorela Nuredini<br>Pershendetje!<br><br>Ne rradhe te pare uroj qe ky e-mail t'ju gjej mire!<br><br>Permes ketij e-maili, raportoj nje ndertim pa leje qe po ndertohet ne qytetin e Vlores. Specifikisht objekti me Nr.37/31Nd , ZK8602 , ne pronesi te Sezai Nuredini. Objekti qe po ndertohet me themele te hapura shume ne thellesi, duke u ngritur dhe nje kat nentoke teresisht ne shkelje me projektin e afishuar, ku specifikohej "Rindertim objekti 1 kat, pa ndryshim forme apo strukture",shkaktoj renie totale te nje pjese te konsiderueshme te murit te shtepise sime dhe | | Deleguar Dr.Vlorë (21.06.2023) | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | demtime te shumta ne prone. Rasti eshte raportuar qe ne fillesat e tij disa here ne IKMT te qytetit te Vlores dhe nuk u morre asnje mase. Nderkohe po vazhdohet te ndertohet ne katin nendhe dhe po ngrihen themele te tjera te jashme per vazhdim punimesh.<br><br>Me besim dhe shprese qe zeri im do degjohet dhe do merren masat e duhura administrative ndaj shkelesit te ligjit ne fjale , kete kerkese po e drejtoj tek ju.<br><br>Ne pritje te reagimit tuaj!<br><br>Me respekt! | | | | |
| 54 | 17.06.2023<br><br>21.06.2023 | Pamela Hysenj<br>Përshëndetje,<br>Ju kontaktojë lidhur me situaten e vështirë me të cilën prej një viti po përballet familja ime. Jam  një qytetare e qytetit të Këlcyrës prej një viti prindërve të mi ju është bllokuar rruga e cila mundeson hyrjen në pronen tonë. Ky bllokim vjen si shkak i një ndërtimi pa leje te komshiut tonë edhe zaptimit te rrugës shtetërore ,babi im i ka te gjitha dokumetat e pronës edhe | 21.06.2023 | Përshëndetje!<br><br>Në vijim të ankesës tuaj, kërkoj të më saktësoni adresën e shtëpisë tuaj dhe më pas ankesa juaj do të delegohet për trajtim.<br><br>Faleminderit për bashkëpunimin.<br><br>**Deleguar Dr.Gjirokastrës** | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | hartën që tregon ku është hyrja për në shtëpinë tonë.<br>Prindërit e mi kanë bërë ankesa të shumta në bashki në polici por nuk kemi marrë asnjë zgjidhje situata është shumë e rënduar nena ime është e sëmurë ka humbur shikimin . Nuk di me ku te drejtohemi.<br>Ju lutem me jepni një zgjidhje ju si institucion !<br>Me respekt Pamela Hysenj!<br>-- Përshëndetje,<br>Lidhur me denoncimin e bërë për bashkinë Këlcyrë, adresa e shtëpisë sonë është Rr. Ish Fabrika e Rrushit 24/518 . Rruga Nacionale SH 75. Banesa është në hyrje te qytetit në krahun e majtë të rrugës kryesore.<br>Mbetem në pritje të një përgjigjië nga organet kompetente pasi sitauata për ne është shumë e vështirë.<br>Me reapekt Pamela Hysenj! | | | | |
| 55 | 19.06.2023 | Pershendetje,<br><br>Dua te bej nje denoncim lidhur me nje ndertim pa leje qe po ben znj. BARDHA SHKEMBI, ne rrugen Irfan Tomini, ndertese | 10.07.2023<br><br>20.07.2023 | Deleguar Dr.Tiranës 21.06.2023<br><br>Përshëndetje! | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | private ngjitur me zyrat e kompanise Eurosig. Zonja ne fjale ka rrethuar nje pjese te prones publike (qe mund te sherbente si nje lulishte per banoret e pallatit), ka sjelle materialet dhe ka nisur ndertimin pa leje. Edhe shtepine ne te cilen banon e ka pa leje dhe te pa legalizuar.<br><br>Ne pritje te zgjidhjes se problemit nga ana juaj. | | Në vijim të ankesës tuaj, ju informojmë se është trajtuar nga Drejtoria Rajonale IKMT Tiranë, e cila na informon si më poshtë:<br><br>Pasi u njohëm me ankesën nga ana e Drejtorisë sonë, u ngrit grupi i punës të cilët kanë inspektuar disa herë në adresën e cituar nga ku bëjmë me dije se:<br><br>• Më datë 21.06.2023, dhe më datë 23.06.2023 dhe 27.06.2023 u krye kontrolli ngjitur me zyrën e Eurosig, ku në të treja rastet nuk u konstatuan punime ndërtimore në proces. Nuk u arrit të merrej kontakt. Kishte materiale si: tulla të vjetra, ekzistuese të hedhura si dhe mbeturina të tjera urbane të cilat ishin grumbulluar dhe të papërdorshme.<br>• Vendi ishte i rrethuar me rrjetë teli | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | • Nuk kishte shkelje ndërtimore.<br><br>Për sa më sipër, i jemi drejtuar IMT-Bashkisë Tiranë ku kërkojmë:<br>Të kryhen inspektime dhe verifikime, në adresën e cituar.<br>Të vihet në dispozicion informacioni i plotë për masat e marra dhe dokumentacionin e administruar për këtë rast.<br><br>Bashkëlidhur kopje e shkresës nr.488/1 Prot datë 03.07.2023.<br>Në momentin e marrjes së një përgjigje, do të njoftoheni në vijim.<br>Ditë të mbarë!<br>Pershendetje!<br><br>Ne vijim te ankeses tuaj, ashtu sic jeni ne dijeni ankesa eshte trajtuar dhe nga IKMT Drejtoria Rajonale Tirane kemi  kete informacion si me poshte:<br><br>Pasi u njohëm me ankesën nga ana e Drejtorisë sonë, u ngrit grupi i punës të cilët kanë inspektuar disa herë në adresën | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | e cituar nga ku bëjmë me dije se:<br><br>• Më datë 21.06.2023, dhe më datë 23.06.2023 dhe 27.06.2023 u krye kontrolli ngjitur me zyrën e Eurosig, ku në të treja rastet nuk u konstatuan punime ndërtimore në proces. Nuk u arrit të merrej kontakt. Kishte materiale si: tulla të vjetra, ekzistuese të hedhura si dhe mbeturina të tjera urbane të cilat ishin grumbulluar dhe të papërdorshme.<br>• Vendi ishte i rrethuar me rrjetë teli<br>• Nuk kishte shkelje ndërtimore.<br><br>Pas korrespodencës shkresore me Imt-Bashkia Tiranë, na bën me dije se është kryer verifikimi në terren, në të cilën nuk është konstatuar punime ndërtimore në proces. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Nga inspektimet e vazhdueshme nuk është bërë i mundur kontakti me të zotin e objektit, për të marrë informacion mbi statusin juridik (dokumentacionin tekniko-ligjor) lidhur me objektin në fjalë, pasi dera ka qënë vazhdimisht e mbyllur.<br><br>Gjithashtu na informon se pranë IMT nuk është dorëzuar projekt për rikuaifikimin urban i miratuar nga Bashkia Tiranë, apo kërkesë/shkresë nga Instituti i Ndërtimit ku të jetë shprehur se objekti paraqet rrezikshmëri shembjeje, si pasojë e dëmtimeve nga  tërmeti apo amortizimit nga faktorë të ndryshëm, në mënyrë që Imt të vlerësojë situatën dhe të ndërhyjë sipas kompetencave që i cakton ligji.<br><br>Bashkëlidhur foto të sitatës në terren gjatë momentit të inspektimit.<br><br>Punë të mbarë! | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| 57 | 20.06.2023 | Idajet Luli<br><br>Drejtuar AGIM ISMAILI<br><br>Zoti Drejtor AGIM ISAMILI , kam nje ankese dhe nje shqetesim qe nuk po merr zerin e duhur nga Drejtori i IKMT ELbasan. si nje banor i lagjes Kongresi i Elbasanit , ne Elbasan . Shqetesimi jone si banore dhe ankesa eshte se prane zyrave te IKMT Elbasan sheshi i perbashket eshte kthyer ne nje parking me pagese dhe ndodhet para zyrave te IKMT Elbasan me drejtues Alban Tafa , ku kam me rreth 1 muaj qe duam tia shprehim shqetesimin si banor te lagjes ,asnjehere nuk ndodhet ne Zyre , duke me thene qe eshte semure, jo mbledhje neTIrane ,duke u zvarritur 1 muaj per te takuar drejtuesin Alban Tafa. Duke mos marre zgjiidhje jua drejtuam juve kete ankese me shpresen qe te marri zgjidhje ne te kundert do ta dencojme ne televizion. Ju faleminderit . | 10.07.2023<br><br>20.07.2023 | Deleguar IKMT Elbasan<br><br>Përshëndetje !<br>Në përgjigje të emailit tuaj,në lidhje me ankesën e z.Idajet Luli, ku parashtron shqetësimin për zaptimin e pronës publike (sheshi i përbashkët i pallatit), me shkresën tonë nr.333/1 Prot, dt.21.06.2023 i jemi drejtuar IMT-Bashkia Elbasan në lidhje me rastin.<br><br>Nga verifikimi i kryer ne dokumentacionin e DRIKMT Elbasan, deri më tani nuk është regjistruar asnjë ankesë e qytetarit Idajet Luli, në lidhje me sheshin e sipërpërmendur apo ankesa të tjera. Në mjediset e DRIKMT Elbasan nuk është paraqitur asnjë qytetar me këtë emër dhe nuk ka kërkuar të takohet me drejtuesin DRIKMT Elbasan. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Në momentin e marrjes së një përgjigje nga Bashkia Elbasan, do të njoftoheni përsëri.<br><br>Ditë të mbarë!<br>--Pershendetje!<br>Ne vijim te ankeses tuaj ju informoj , ashtu sic jeni ne dijeni qe ankesa juar eshtetrajtuar nga IKMT Drejtoria Rajonale Elbasan e cila na informon:<br><br>Me shkresën " Për kompetenc", Nr.333/1 Prot, dt.21.06.2023, i jemi drejtuar IMT-Bashkia Elbasan dhe na është kthyer përgjigje me shkresën nr. 456/1 Prot. dt.10.07.2023, ku na informon se: Nga ana IMT-Bashkia Elbasan u verifikua ankesa e z.Idajet Luli dhe rezulton se nuk kishte hapsirë të zënë me trarë ose litarë për parkim. Bashkangjitur shkresa<br><br><br>Duke ju falenderuarper bashkepunimin | | |
| 58 | 20.06.2023 | **Shpetim Hasa** | 03.07.2023 | Përshëndetje | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Dua te denoncoj nje ndertim pa leje , kapanon ne Zonen e Metalurgjise Elbasan , ne emer te Fatos Gjata, duke mos marre asnje leje perkatese ne asnje zyre .<br>Besoj se ligji eshte i barabarte per te gjithe, faleminderit . | 19.07.2023 | Në vijim të ankesës së z.Fatos Gjata,ju informoj se ankesa juaj po trajtohet nga Drejtoria Rajonale IKMT Elbasan, e cila na informon se grupi I inspektimit ka ushtruar kontroll dhe ka konstatuar vendosjen e konstruksion metalik të pajisur me vendim nr.3208/1 Prot, dt.11.05.2023"Për Miratimin e Deklaratës Paraprake për Kryerje Punimesh" për objektin me strukturë metalike të cmontueshëm dhe vendosje panelesh fotovotoike në pasurinë nr.1038, zk.3965 dhe u konstatua konstruksioni metalik me pëmasa: gjatë 90 m x 21 m gjerëi me lartësi minimale 8.6 m e lartësi maksimale 10.4 m me mbulesë llamarinë.<br><br>Në projektin është e miratuar me strukturë të cmontueshme me lartësi 7m e lartësi maksimale 10.6 m dhe mbulesën me sanduic.<br>U kostatua ndërtimi i strukturës metalike me përmasa 90 m x 10.8 m. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | U kostatua konstruksioni metalik nr.3 me përmasa: 90 m x 10.8 m, me lartësi maksimale 7.2 m e lartësi minimale 6.3 m e mbuluar me llamarinë, për të cilin nuk është vënë në dispozicion dokumentacioni përkatës.<br><br>Me shkresën tonë "Për Kompetencë" Nr.332/2, dt.26.06.2023, i jemi drejtuar IMT-Bashkia Elbasan.<br><br>Sapo të na njoftohen aktet,do të ju bëjmë me dije.<br><br><br>Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.<br><br>Pershendetje!<br><br>Ne vijim te ankeses tuaj adresuar prane IKMT-se , ashtu sic jeni informuar ankesa juaj eshte trajtuar nga Drejtoria Rajonale IKMT Elbasan e cila na informon si me poshte:<br><br>Me shkresën "Për kompetenc", Nr.332/2, dt.26.06.2023, i jemi drejtuar | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | IMT-Bashkia Elbasan dhe na është kthyer përgjigje me shkresën nr.485/1 Prot. dt.10.07.2023, ku na informon se janë ndjekur të gjitha proçedurat administrative për shtetasin z.Fatos Gjata.<br><br>Bashkëngjitur:<br>• Shkresa nr.485/1 Prot. dt.10.07.2023, të IMT-Bashkia Elbasan<br>• Proces-Verbal Konstatimi.<br>• Vendim prishje të objektit.<br>• Vendim për dënimin gjobë + foto<br><br>Duke ju falenderuar per bashkepunimin. | | |
| 59 | 21.03.2023 | **Ola Mitre**<br><br>Pershendetje,<br><br>jam Ola Mitre, gazetare e TV SCAN. Aktualisht jam duke punuar per nje material mbi | | Deleguar Dr.Mjedisit 22.06.2023 | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ushtrimin e aktivitetit te guroreve brenda zonave te mbrojtura.<br><br>Ne kete kuader, kam disa pyetje drejtuar institucionit tuaj, per te cilet mund te keni nje koment.<br><br>1- Perse IKMT lejon ushtrimin e aktivitetit te guroreve, qe nuk jane pajisur me leje minerare dhe leje mjedisi?<br><br>2 - Perse ky aktivitet i jashteligjshem lejohet te kryhet edhe brenda zonave te mbrojtura, sikurse eshte Karste - Verjon apo Mali i Tomorrit?<br>3 - A planifikoni të kryeni kontrolle ne keto zona ne te ardhmen?<br>Duke ju falenderuar,<br>Ola Mitre | | | | |
| 60 | 23.06.2023 | **Av.Sokol HASANI**<br><br>Bashkangjitur gjeni denoncimin per Institucionet shteterore, qe nuk kryejne normalisht detyren, e faktuar, pasi prova "formohet ne gjykata"! Pas kesaj keni padi civile per dem jo-pasuror, se me keni bere te humbas besimin ne | 25.07.2023 | Deleguar IKMT Vlorë (03.07.2023)<br>Pershendetje!<br><br>Ne vijim te ankeses tuaj ju informoj se ankesa juaj eshte deleguar per vlersim dhe trajtim prane IKMT Drejtoria Rajonale Vlore e cila na | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Institucione, veprim i cili me sjell dem psikik..., persa nuk jam "tipi" qe te them: "S'ke c'ben se kane pushtetin..." e brockulla te tjera! ..Dhe nqs gjeni "mik" ne SPAK, e vetmja gje qe do beje eshte kalimi ne "juridiksionin normal", pra ne P.e Rrethit...per shperdorim detyre. Do vazhdojme me vite me KVP ne Gjykata e Ankim per juridiksion ne Gj.L...e deri ne ECHR...., si me penale e civile. Pra kush ka marre favore, do detyrohet te jape dhe me shume neper shkallet e gjyqesorit per t'u kthyer ne "fazen fillestare"!!! Kjo quhet PREAMBOL !<br><br>Per Policine e Shtetit, vecanerisht per strukturen e Krimit Ekonomik kam vetem nje fjali kryesore: T'JU VIJE TURP QE NUK VIHENI NE LEVIZJE NGA LIGJI, POR NGA NJE PORTAL ON-LINE SI JOQ (https://joq-albania.com/artikull/1139585.html )!!! Denoncimi ishte bere on-line ne adresen elektronike te drejtuesit te kesaj strukture ne Tirane, po ashtu dhe ne D.P.P, me nr protokolli...e vetem kur doli te JOQ filluan procedurat formale. Them formale se iniciohet | | informon se eshte derguar shkresa prane IMT Bashkia Himare më date 20/07/2023 me Nr.423/0-1 Prot.<br>Jemi ne pritje te pegjigjes e ne vijim iformimin tuaj.<br>Dite te mbare! | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | procedim penal per kundravajtje te parashikuar nga neni 274 K.P, biles del dhe si lajm ne MEDIA, por jo per VJEDHJE ME ANE TE MASHTRIMIT (143 K.P). Per kete do ve me leter ne dijeni dhe Ministrin CUCI dhe Drejtorin e Pergjithshem te Policise M.Rrumbullaku. Nqs nuk jeni "mire ne jurisprudence" , te pakten te jeni ne "psikologji" e te kuptoni se kur nje person eshte i vendosur te shkoje deri ne fund, biles ka dhe experience te tille ne te "shkuaren e larget ..e te afert", mos u mundoni ta kaloni ne heshtje.... ose me pergjigje "kortezie" ....<br><br>Av.Sokol HASANI | | | | |
| 61 | 27.06.2023 | Jemi disa banore te Selenices - vlore dhe dua te shpreh ankesen time dhe te disa banoerve te tjere. Prej disa kohesh firmat qe punojne ktej hedhin dherat ne lume si dhe kane zaptuar tokat tona duke ndertuar makinerite e perpunimit buze lumit. Firma B& A. D keto dite ka ndertuar platforma betoni pa leje mjedisore dhe makineri te medha pa leje prane lumit vjose e cila eshte dhe | | Deleguar IKMT Vlorë 03.07.2023 | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | park kombetar. Firmat e tjera selenica bitumen dhe alb industri hedhin kamiona me dhera shume prane lumit dhe ne lume, nuk mjafton me kaq por dhe ne cdo vend tjeter te mundshem. nje zgjidhje per kete problem qe po na ndodh me tokat tona dhe lumin Vjose. Ka patur kontrolle nga ministria e mjedisit te cilet jane paraqitur dhe jane larguar pa asnje zgjidhje pasi kane bere pazare per shkak te detyres. Ju faleminderit. | | | | |
| 62 | 27.06.2023 | Pershendetje,<br>Ne radhim Po ndertohet beach bar pa Leje .<br>Po Ju nis dhe foton.<br><br>Objekti Po ndertohet ngjitur me subjektin Tropikal afer resortit Bojo.<br>Ka levizje te personave me precedent penal dhe te armatosur.<br><br>Polizia e Zones eshte ne dijeni por nuk Po vepron.<br>Me Shpresa qe shteti te nderhy qendroj ne disposizion per informazione te metejshme. | 03.07.2023 | Përshëndetje!<br><br>Në vijim të ankeses suaj, ju bëjmë me dije se nga verifikimi i kryer dhe komunikimi me inspektorët e Drejtorisë Qendrore, subjekti Irena Zelo është i pajisur nga K.K.T me leje stacionim plazhi.<br><br>Bashkëlidhur po ju dërgojmë lejen së bashku me projektin.<br><br>Ditë të mbarë! | | |
| 63 | 27.06.2023 | ORIOL CANAJ<br>Prsh. | 03.07.2023 | Përshëndetje!<br><br>U njohëm me ankesën tuaj. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Po ju shkruaj pasi nuk di si te veproj ndryshe dhe me duhej mdihme ose keshille nga ana juaj. Kam toke ne Fier dhe ndahem me fqinjin por cdo vit me merr toke. E kam denoncuar por vijn gjithmon inspektore te cilet bllokohen te veprojn ne baze te ligjit pasi vellai i atij qe zapton token punon ne shtet ne fier. Do veproj edhe permes mediave por fillimisht doja te mbrohesha nga zurat ne tirane pasi kur bej denoncime ne fier, nuk gjej dot te drejten. I bie vec te marrim armet dhe ta gjejm zgjidhjen vec keshtu. Si te veproj? Edhe fizikisht mund te vij te takohem me ju.<br>Cme sygjeroni te bej?<br>Flm | | Ju lutem, dërgoni adresën e saktë të pronës, si dhe përshkruani ose dërgoni foto të zaptimit të hapësirës tuaj.<br>Më pas ankesa juaj,do të delegohet për trajtim.<br><br>Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.<br><br>Ditë të mbarë! | | |
| 64 | 29.06.2023 | E nderuar znj. Cenaj,<br>Gjeni bashkelidhur kerkesen drejtuar IKMT se Tirane shoqeruar me foto.<br><br>Faleminderit,<br>Rukije Becaj | | Deleguar IKMT Tiranë<br>03.07.2023<br>Përshëndetje!<br><br>Në vijim të ankesës tuaj, ju informoj se ankesa juaj është trajtuar nga Drejtoria Rajonale IKMT Tiranë, e cila na informon si më poshtë; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | <br>**Drejtuar:** Inspektoriati Kombetar i Mbrojtjes se Territorit<br>TIRANE<br>**KERKESE**<br>**Te nderuar,**<br>Une jam qytetarja **Rukije BECAJ** lindur dhe banuese ne Tirane, banuese ne Rrugen "Xhanfize Keko" Nr 42, me arsim te larte , gjendje civile beqare me dokument identifikimi G45412217G.<br>Arsyeja qe po Ju shqetesoj si me poshte:<br>Jetoj ne nje banese njekateshe ne adresen e mesiperme me hipoteke ne pronesi timen dhe te motres time Valbona Bushati Becaj, e cila nuk jeton ne Shqiperi.<br>Komshiu ngjitur Artur Plasa po suvaton faqen e murit te jashteme e cila eshte ngjitur me banesen time. Shtepia e qytetarit Artur Plasa eshte 4(kater ) kateshe.<br>Qytetari Artur Plasa ka mbeshtetur skelen metalike ( tre kate skele) mbi tjegullat e catise time duke me dhunuar pronen private.<br>Skelen e ka vendosur diten e djele me date 25/06/2023 me dhune dhe pa marre dakortesine time duke shkelur ne menyre flagrante te drejten mbi pronen private, dhunim te prones private.<br>Me date 27/06/2023 kam bere kallzim ne Komisariatin Nr 4 Tirane prane Oficerit te Policise Gjyqesore Z. Bujar Musaj.<br>**Te nderuar,**<br>Lutem qe te dergoni nje grup inspektoresh ne objekt me qellim zbatimin e ligjit, lenien e lire te prones time private , heqjen e skeles mbi tjegullat e catise se baneses time.Materiali shoqerohet edhe me foto.<br>Duke Ju kerkuar ndjese dhe nje here per shqetesimin dhe me besimin se ndihma Juaj do te jete ne zbatim te ligjit,<br>Mbetem ne pritje.<br>Ju falenderoj.<br>**Rukije BECAJ**<br>Adresa: Rruga Xhanfize Keko, Nr 42.<br>Nr telefoni: 069 22 02 823<br>Adrese email: r.becaj@yahoo.com<br>***Tirane, 29 qershor 2023.*** | | Në zbatim të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme", i ndryshuar, nga Drejtoria Rajonale e IKMT Tiranë, u ngrit grupi i punës, të cilët kryen inspektimin dhe verifikimin në terren, në adresën: Rruga "Xhanfize Keko", nr. 42. Në momentin e kontrollit konstatuam se:<br>• Nga inspektimi i kryer në objekt, inspektorët nuk konstatuan punime ndërtimore në proces, nuk u konstatua vendosje skele në banesën e subjektit Rukije Beçaj dhe Artur Plasa.<br>• Nga kontakti që morëm me ankuesen (me telefon), na informoi se shtetasi A. Plasa i ka hequr vetë skelat.<br>Kjo përgjigje i është dërguar me shkresën nr.527/1 prot., | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | datë 06.07.2023, ankueses Rukije Becaj.<br><br>Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.<br><br>Punë të mbarë! | | |
| 65 | 29.06.2023 | Natasha Qirko<br><br>Pershendetje,<br><br>bashkelidhur lutem gjeni kerkesen per informim, ne lidhje me ndertimin qe eshte duke u zhvilluar prane prones sime ne Dhermi, nga subjekti Queen Vasilika shpk, e cila njekohesisht ka ndermarre veprime mbi rrugen publike.<br><br>Lutem me konfirmoni marrjen e ketij emaili.<br><br>Mbetem ne pritje,<br><br>Faleminderit<br><br>• Nëse institucioni IKMT ka të evidentuar ndërtimin Hotel që po realizohet në Dhërmi, pranë Vilës | 27.07.2023 | Dërguar shkresa pranë IMT<br><br>Bashkia Himarë<br><br>Pershendetje!<br><br>Ne vijim te kerkeses tuaj, Ju bejme me dije se:<br><br>Subjekti Queen Vasilika eshte pajisur me leje zhvillimi nr.28 date 14.10.2020 prane Keshillit Kombetar te Territorit dhe me pas me marreveshje delegim nepermjet Kryeministrit dhe kryetarit te bashkise, eshte pajisur me leje ndertimi prane Bashkise Himare nr.86, Prot 1429/1 date 10.06.2022 me zhvillues "Queen Vasilika", Dhermi | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Qeveritare, prej subjektit Queen Vasilika shpk<br>• Të më vihet në dispozicion për konsultim në ambjentet e institucionit si dhe kopje të akteve të caktuara që vërtetojnë pajisjen me Lejen e Ndërtimit të këtij subjekti, nëse ka, me datën përkatëse dhe institucionin miratues.<br>• Kopje të hartës treguese të njollës së ndërtimit të planifikuar dhe miratuar në Lejen e Ndërtimit dhe në Lejen e Zhvillimit<br>• Kopje e hartës treguese të pronës mbi të cilën është dhënë leja e ndertimit përkatëse, si dhe aktin që vërteton pronësinë e subjektit mbi pronën, pjesë e dokumentacionit ligjor të dosjes së lejes së Ndërtimit.<br>• Kopje të procesverbalit/procesverbaleve të inspektimit fillestar periodik prej institucionit tuaj pranë këtij subjekti, nëse ka. | | Bashkelidhur:<br>• Kthim pergjigje nga IMT Himare me Nr.2942/4 Prot. date 12/07/2023<br>• Vendimin e lejes se zhvillimit me te dhenat perkatese i miratuar<br>• Plani i vendosjes se struktures per leje zhvillimi i miratuar<br>• Vendimin e eljejes se ndertimit me te dhenat perkatese i miratuar<br>• Planin e vendosjes se struktures per leje ndertimi i miratuar<br>• Dokumentacionet e pronesore se bashku me hartat zyrtare treguese te prones dhe materiale te tjera.<br><br>Pune te mbare! | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Natasha Qirko<br>067 5337 464 | | | | |
| 66 | 29.06.2023 | Adresa: Milot<br>Po ndertohet nje impjant inertesh pa leje ndertimi ne mes te dy urave ( ures me harqe dhe ures se trenit ) i cili eshte i ngjitur me nje impjant te vjeter.<br>Ju lutem nderhyni ju! | | Deleguar IKMT Lezhë<br>03.07.2023 | | |
| | | - Nuk u mjaftuan me kaq dako me brahon, blushin, dashin, por që të shfrytëzonin ardhjen e turistëve në bizneset e tyre realizoi planin rregullues të zonës përqark duke e bërë shëtitore jashtë pallatit që gjendet pranë hotelit të tyre Perandor (nga i cili janë sekuestruar tre katet e fundit si shtesa jashtë lejes së ndërtimit). Zvogëluan korsitë nga katër u bënë dy. Ky ndryshim solli rritje të trafikut, në vend që të zgjeroheshin korsitë nga 4 në 6 ose në 8 që të përballohej trafiku në periudhën e kulmit të turizmit.<br>- Çuditërisht, pikërisht si me magji në zonën ku janë këto dy prona pallate/hotele në plazhin e Durrësit afër hotel Dyrrahut, ose te hotel Florida, ish kampi i punëtorëve, (që është pronë e brahos dhe likes, aty ndodhet dhe vila e likes) bëhen rregullime të vazhdueshme urbanistike për të goditur konkurencën dhe të thithin të gjithë potencialin e turistëve të ardhur. Dy vitet e fundit ajo zonë është kthyer në pedonale në kurriz të qytetarit dhe taksapaguesit shqiptar për ti rritur vlerën pronave të tyre për ti shfrytëzuar | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | sipas oreksit dhe përfitimeve sezonale.<br>- Dako në bashkpunim me brahon pasi nuk u ngopën nga xhvatja e pronave publike dhe shkatërrimi i tyre ndryshuan edhe transportin publik të Durrësit dhe plazhit. Futën linjë private të urbanit që e zotëron braho me kopilat e leshelisë dhe like legenin.<br>- Nuk u mjaftuan me kaq, gjoja për të zgjidhur trafikun që vetkrijuan ndaluan të gjitha automjetet të kalojnë nga plazhi (meqë u bë me dy korsi) filluan të shfrytëzonin linjat e tyre të urbanëve private ndërsa ajo e bashkisë është linjë e kufizuar deri në Plepa, më tej vazhdojnë shfrytëzimin linjat private të brahos. Ndajnë thelat tona dhe pa pyetur hanxhinë që jemi, unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato.<br>- Nuk u mjaftuan vetëm me kaq, por kanë zaptuar çdo mlm të rërës në atë zonë me ndërtime mbi rërë, me shezllone, çadra nga dako, braho, blushi, dashi e të tjerë dhe nuk ka mlm rëre të lirë të quajtur plazh publik pa detyrim pagese për publikun dhe banorët e zonës që paguajnë taksa shtetit për pronat e tyre në atë zonë. | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | - Babëzia nuk mjaftohet me kaq nga braho me shokë e ortakë në pd/ps/lesheli, por të gjithë vijën e rrugës së pronës së ish kampit të punëtorëve nga të dyja anët i kanë ndërtuar qoska, dyqane të vogla dhe marrin qera nga ambulantët shitës sezonalë gjatë verës.<br>- Babëzia e xhvatja vazhdon me biznesin e ujit pikërisht në atë zonën ku janë të përfshirë këta horrat kriminelë. Gjatë periudhës korrik-gusht ujësjellësi në atë zonë nuk u pompon ujë banorëve dhe konkurentëve të këtyre që përmendëm të cilët janë nyja e ligësisë në atë thelë të plazhit. Atëherë, ç'bëhet? Detyrohen të blejnë ujin me bote nga ujësjellësi trefish, sepse ujin e paguajnë sipas sahatit te ujësjellësi, paguajnë depot me ujë sipas çmimit që vendos drejtori i ujësjellësit të Durrësit që ishte familjar i dakos dhe dashit. Ndërkoh që, cubat e pallateve merrnin me forcë paratë nga 100-150€ në valutë euro të administrimit të pallateve pa ofruar asnjë shërbim që përfshijnë, pastrim të depos së ujit, mirëmbajtje të ashensorit, vendosjen e dyerve të jashtme të pallateve, pastrimin e tyre | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | (abuzojnë me faktin meqë përdoren vetëm disa ditë/javë në vit) si edhe për gjelbërimin inekzistent jashtë pallateve që nuk u përmbahen planeve fillestare me të cilat kanë marrë lejet e ndërtimit e nuk përmbushin kriteret për t'u pajisur me leje banimi sipas ligjeve që ishin dhe janë në fuqi.<br>- Në fund përmendim edhe tregun e plazhit që është një tjetër njollë e zezë e administrimit të bashkisë së Durrësit me shkelje të shumta dhe gjoba të ndryshme nga instruktorë të institucioneve shtetërore, por edhe cubat/bandat e plazhit që shesin mbrojtje nëpërmjet kërcënimeve nën hijen e Bashkisë. Pikërisht këto kanë qënë arsyet që tregu është lënë në mëshirë dhe është përgjysmuar pjesmarrja e tregtarëve në të.<br>Të gjitha këto në vija të trasha janë krimet 28 vjeçare të politikës qendrore, vendore me bandat e krimit që i denoncojmë prej vitesh, por që jemi bërë qesharakë në të drejtën tonë.<br>Më poshtë denoncimi me mesazh në faqen zyrtare të IKMT-së, por që nuk ka patur asnjë reagim dhe | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | asnjë ndryshim konkret.<br>Konkluzionet tuaja!<br>Pa respekt,<br>Genta Kaloçi<br>0673891592 | | | | |
| 113 | 11.09.2023 | Nje grup kriminal i organizuar ka hyr ne pronen time me dokumente fallce. Token e kam me certificate dhe tapi te vjeter me 7501<br><br>+355 68 365 7014<br>Pershendetje<br>Dje erdh policia manzit i mori. I mbajti deri ne dark edhe i la te lire prap. Edhe na than neser do vjeri ikmt. Shkoj sot ke toka edhe kan punu gjith naten duke vendos gardhin. Dhe me than ke desh me lajmru policin ti.<br>Merrni masa urgjente sepse kjo ceshtje deri ne spak do ta dergoj per mosveprim institucionesh vendore ok. ikmt kemi nji muaj qe e presim po nuk vjen nuk e kuptoj ket mosveprim<br>Ju faleminderit | 18.09.2023 | Pershendetje!<br><br>Ju lutem saktesoni te dhenat tuaj, adresen ku ndodhet prona juaj qe me pas ankesa juaj te vlersohet dhe trajtohet.<br><br>Dite te mbare!<br>Deleguar Durresit | | |
| 114 | 11.09.2023 | Përshëndetje, si mundem te bej nje kërkesë per verifikim ne teren te shtepise. | | Pershendetje !<br><br>Ne vijim te kerkeses tuaj, ju informoj qe ti drejtoheni | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Bashkise perkatese si organi kompetent qe mbulon territorin ku ju ndodheni.<br><br>Dite te mbare! | | |
| 115 | 11.09.2023 | Pershendetje,<br><br>Ju kontakoj ne perfaqesi te kompanise JURREI Shpk me nipt K02021001M, ne vijim te kerkeses per asgjesim te kryer me date 05/09/2023 per te zvilluar procesin me 13/09/2023,<br>Kerkese e cila na eshte kthyer mbrapsht nga posta sot me 11/09/2023, pa asnje shpjegim mbi arsyen e rikthimit<br><br>Duke marre parasysh qe ne kete process marrin pjese dhe 2 institucione te tjera pervec IKMT, ju lutem te na informoni si duhet te veprojme me procosin dhe sit e nenkuptojme kthmin mbrapash te dokumentacionet pasi zarfi ishte I hapur pra institucioni juaj ka marre dijeni.<br><br><br>Ne pritje te pergjigjes suaj<br>Me rrespekt | 11.09.2023 | Pershendetje Zj.Joana,<br>Referuar emailit tuaj ne lidhje me kthimin mbrasht te letres me Lende ‘Per ricaktimin e dates per asgjesim te mallrave ushqimore’ , ju sqarojme se ne rubriken ‘Drejtuar’ keni listuar 3 institucione te pavaruara nga Inspektorati Kombetar i Mbrojtjes se Territorit, dhe jo institucionit tone.<br><br>Faleminderit, | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 116 | 13.09.2023 | **I nderuar Z. Minister,**<br><br>Në kuadër të zhvillimeve të fundit nga qeveria dhe nga besimi i masave të marra në kohën e duhur nga ana juaj dua të shpreh shqetësimin tim lidhur me situatën e krijuar prej vitesh në biznesin e drejtuar prej meje.<br><br>Unë që po ju drejtohem jam Z.**Arben Paja**, Administrator i **Hotel "6 Milje"** i ndodhur në qarkun Vlorë, Bashkia Sarandë, rruga nacionale Ksmail-Butrint, godinë 4 katëshe, me Certifikatë Pasurie Nr. 3/700, Zona Kadastrale Nr. 229, me NIPT L04702803H dhe ushtroj aktivitetin në këtë hotel që nga viti 2011.<br><br>Hoteli është në status aktiv pune, me një numër të lartë pushuesish dhe vizitorë nga Europa e vende të ndryshme të botës, me standard të lartë akomodimi, cilësuar përkatësisht me 4 yje.<br><br>**Shqetësimi im lidhur me ecurinë e zhvillimit të aktivitetit është mbi objektin përballë godinës së Hotel 6 Milje ku ka rreth 15 vite që ngelet as i ndërtuar dhe as i** | | Deleguar Vlores 18.09.2023 | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **zhvilluar, (thjesht një karabina) duke dëmtuar imazhin e Hotelit ku e vizitojnë rreth 7000 turistë në sezon**.<br><br>Objekti në fjalë, (bashkëlidhur dhe fotot) së pari ka devijuar rrugën e projektuar në momentin e marrjes të lejes së ndërtimit, së dyti mbetet objekt i mbledhjeve të plehrave duke dëmtuar imazhin e turizmit.<br><br>Në studimin pjesor urbanistik të bërë në vitin 1999 në seksionin e kufizimeve të hotelit shpjegohet: nga veriu – tokë e lirë dhe shesh ndërtimi, nga jugu – rrugë në studim 3m larg, nga lindja- shesh ndërtimi 7.5 m larg dhe nga perëndimi – tokë e lirë.<br><br>Në kondicionet urbanistike shpjegohet ndër të tjera se objekti do të respektojë një vijë ndërtimore 3m larg nga rruga në ndërtim. Hotel “6 Milje” e ka respektuar plotwsisht kwtw distancw por objekti në fjalë nuk e ka respektuar këtë fakt duke shkelur parashikimet e legjislacionit nw fuqi lidhur me pwrcaktimet e distancave si nga | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | rruga ashtu edhe nga objektet kufitare.<br><br>Referuar VKM nr. 408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", parashikohet si vijon: **Neni 33 "Treguesit e distancave"** ndër të tjera parashikon se**:** "*2. <u>Distancat sipas këtij neni duhet të jenë të tilla që të mos cenojnë lirinë e përdorimit të pronës, të krijojnë hapësira publike dhe/ose funksionale të nevojshme për shërbimet ndaj komunitetit dhe të garantojnë siguri individuale dhe shëndetësore</u>. 3. Distancat e përcaktuara në këtë rregullore janë: <u>a) distancat midis ndërtimeve</u>; b) distancat midis ndërtimit dhe kufirit të parcelës/pronës; c) <u>distancat midis ndërtimit dhe kufirit të trupit të rrugës sipas përkufizimit të Kodit Rrugor</u>. 5. Për përcaktimin e distancave vlerësohen: orientimi dhe diellzimi; **<u>gjendja e ndërtimeve kufitare</u>**; standardet higjieno-sanitare, mjedisore dhe të sigurisë sipas legjislacionit të posaçëm.*". **Neni 34** "**Distancat minimale midis ndërtimeve",** ndër të tjera parashikon se**:** "*7. <u>Distancat për</u>* | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *ndërtimet brenda një zone me përdorim hotelier përcaktohen sipas projektit, në përputhje me këtë rregullore*, për aq sa nuk përcaktohet ndryshe në legjislacionin e posaçëm dhe atë mjedisor. 9. *Në rast se faqet që përballin njëra-tjetrën janë kallkan, pra pa dritare dhe pa çarje fasade të çdo lloji tjetër, dy ndërtimet mund të vendosen bashkëngjitur në këto faqe mbi bazën e projektit për ndërtesa të bashkëngjitura dhe marrëveshjes përkatëse mes palëve të interesuara. Në mungesë të marrëveshjes, respektohen distancat sipas pikave në vijim të këtij neni*.”<br><br>Nga sa vërehet më sipër, në kuadër të legjislacionit në fuqi, nuk janë respektuar as distancat lidhur me gjendjen e ndërtimeve kufitare kur është lehtësisht e kuptueshme që një ndërtim i ri afër një hoteli i cili është ekzistent prej vitesh me një fluks të lartë pushuesish i cili ndikon drejtëpërdrejtë edhe në zhvillimin e turizmit në vend, kur mbetet karabina dhe i pa zhvilluar për një kohë të gjatë ndikon edhe në punën e përditshme të kufitarëve e për më tepër nuk dimë | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | nëse do zbatohen në të ardhmen faqet kallkan të ndërtesës së pazhvilluar duke qenë se hoteli “6 Milje” ka dritare dhe fasadë në atë anë ku është ndërtuar objekti i ri.<br><br>Gjithashtu, mendoj se edhe legalizimi për këtë objekt mund të jetë bërë në shkelje pasi nësë do ishin respektuar parashikimet ligjore duke vënë re të gjitha shkeljet që ka bërë ndërtuesi i objektit, ky objekt nuk do të ishtë pajisur me certifikatë legalizimi.<br><br>Megjithatë, pavarësisht sa më sipër, për të zgjidhur këtë problematikë si nga ana jonë por mbi të gjitha edhe me ndihmën tuaj, nese ju merrni njw vendim lidhur me kwtw ndwrtesw, unë si administrator i Hotelit “6 Milje” vetëofrohem ta rehabilitoj me të ardhurat e mija hapwsirwn e cila më ka ndikuar shumë, ndër vite, në mbarëvajtjen e punës së përditshme dhe ka shkaktuar shumë pakënaqësi tek turistët e huaj të cilët qëllim kryesor vec akomodimit shumë të mirë që në ofrojmë, kanë edhe shfrytëzimin e të gjithë bukurive që ofron Ksamili dhe Saranda. Këtë e bazojmë edhe | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | në fushatat që Kryeministri Rama bën lidhur me zhvillimin e turizmit.<br>Për gjithë sa më sipër, në kuadër të përpjekjeve për krijimin e një klime sa më të lartë bashkëpunimi reciprok, pa cënuar pronën e dikujt tjetër dhe pa prishur imazhin e hotelit, kërkohet ndihma e institucioneve tuaja.<br><br>Ju bëj me dije se kam bërë një ankesë pranë jush në datë 05.07.2021 por nuk kam pasur asnjë përgjigje e për këtë arsye po ju ridrejtohem edhe një herë.<br><br>Mbetemi në pritje të një bashkëpunimi edhe nga ana juaj,<br><br>**Duke ju falenderuar paraprakisht,**<br><br>**Arben Paja** | | | | |
| 117 | 13.07.2023 | Pershendetje,<br><br>Dua tju ve ne dijeni qe ne fshatin Pilur te Himares, kryeplaku i fshatit po ben kat shtese pa leje.Bashkengjitur keni fotot e ndertimit. | | Deleguar Vlores 18.09.2023 | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Ju lutem merrni masa qe te verifikohet.<br>Kjo ankese do te shkoje edhe ne Kryeministri.Faleminderit,<br>Στάλθηκε από το Galaxy μου | | | | |
| 118 | 15.09.2023 | Pershendetje IKMT! Kerkoj tu informoj se ne lagjen Osman Haxhiu ne Rrugën Demokracia ngjitur me Shkollen Fillore 9 Vjeçare Rilindja po ngrihet 1 Ndertim 3 kateshe pa Leje ne kundërshtim me ligjin ne fuqi te Republikes se Shqiperise pa marre asnje Leje te rregullt nga institucionet ne fuqi dhe pa marre asnje pëlqim nga fqinjët përreth dhe asnje firem ligjore te fqinjëve kerkojme prishjen e kateve 2 dhe 3 qe rezultojnë te paligjshme. Ky person e ka emrin Krenar Beqo. Flm per mirëkuptimin! | 18.09.2023 | Pershendetje!<br><br>U njohem me ankesen tuaj, por ju lutem saktesoni dhe qytetin per ku behet fjale ankesa qe ta vlersojme dhe trajtojme me pas.<br><br>Duke ju falenderuar per bashkepunimin, | | |
| 119 | 27.08.2023 | Ju drejtohem me anë të kësaj ankese për të denoncuar një shkelje mbi lejen e ndërtimit Nr. 5898/7 prot., datë 2.9.2015, miratuar me vendimin Nr.2, datë 23.3.2015 të K.K.T-së "Për miratimin e lejes së ndërtimit për projektin " Ndërtimi i Kompleksit Turistik në Fshatin Shetaj, Komuna Ishëm, Qarku Durrës".<br>Unë zotëroj një nga vilat e | 30.08.2023 | Pershendetje<br><br>Ne vijim te ankes tuaj , ju bejme me dije se problematika eshte deleguar per trajtim ne IKMT Drejtoria Rajonale Durres, e cila ma informon se ka percjelle rastin per ndjekje IMT Bashkia Durres me shkresen Nr 454 Prot date 28.08.2023. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ndodhura në këtë Kompleks, dhe prej disa kohësh kam konstatuar një shkelje mbi lejen e ndërtimit, nga pronari i vilës fqinje, i cili, në kundërshtim të plotë me rregullat e zhvillimit si dhe pamjen e jashtme të godinave e trajtimin e fasadave, përcaktuar qartë në faqen 12 të lejes së ndërtimit Nr. 5898/7 prot., datë 2.9.2015, ka realizuar një kryerje punimesh mbi montimin e disa paneleve diellore, ndërkohë që në projekt shprehimisht thuhet se: “Mbulesat e vilave do të realizohen si mbulesa të gjelbëruara me bimësi të ulët”. Ky tejkalim i të drejtave nga pronari fqinj më ka cënuar rëndë të drejtën e pronësisë. Nga komunikimet e vazhdueshme lidhur me këtë shqetësim timin, deri në këtë moment nuk është ndërmarrë asnjë veprim nga ana e pronarit fqinj. Lutem, kërkoj nga ana juaj një verifikim mbi këtë kryerjen e këtyre punimeve, marrjen e masave përkatëse, si dhe zgjidhjen e kësaj problematike nga instancat kompetente. Bashkëngjitur një kopje e Lejes së Ndërtimit si dhe Dokumentit të Rregullores. Një përgjigje sa më e shpejtë nga ana | | Ne perfundim te afatit do ju bejme me dije ne lidhje me masat e marra nga ana e IMT<br><br>Dite te mbare! | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | juaj do të më vinte në ndihmë lidhur me vijimin e këtij procesi.<br>Duke ju falenderuar, | | | | |
| 120 | 22.09.2023 | Pershendetje !<br><br>Me date 26 maj 2023, jam drejtuar me ankese IKMT-se per mosfunksionim te strukturave te Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Lezhë.<br><br>Kete ankese e kam perseritur dhe me date 13 shtator 2023.<br><br>Deri ne kete moment nuk kam asnje pergjigje konkrete, nga IKMT-ja.<br><br>E mbrojtuar prej meje me ka pyetur disa here se perse nuk ju kthejne pergjigje dhe une i jam pergjigjur ; ose presin avokatin me zgrape prej tij ose jane te papergjegjshem per detyren zyrtare qe ju eshte besuar.<br><br>Kete sms do ua dergoj te gjitha instancave shteterore, te ketij shteti te degjeneruar. | | Deleguar Oles | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Av. Aleksander Perlesi. | | | | |
| 121 | 23.09.2023 | Pershendetje,<br>Jam nje qytetar i Tiranes qe banoj ne Rrugen Fuat Toptani Tirane. Shtepia ime ku une banoj eshte ndertuar ne te parat ne kete zone me leje ndertimi ne vitin 2001. Sot perpara shtepise time po nderton Bidin Biba nje objekt dy katesh. Nuk jan kunder ndertimimit qe ai po ben por duhet qe ai te ndertoj SIPAS LEJES SE BASHKISE TIRANE DHE JO PERPARA SHTEPISE TIME. Leja e dhene nga bashkia Tirane eshte 30m e spostuar nga vendi ku po ndeton aktualisht. Medemek Leje nderimi termeti. Te ndertoj shtepin sic e kishte 1 kat dhe ne vendin ku e kishte jo perball shtepise time dhe dy kat sipas mendjes se tij. Ju lutem ju si inspektoriat te merrni masa menjeher qe gjerat most e agravojn me kallzime penale dhe procese gjyqesore. Ne rradhe te pare kjo eshte detyre e juaja funksionale dhe mosveprimi juaj ju ngarkon per pergjegjesi ligjore. Faleminderit. | | Deleguar Tiranes (25.0902023) | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 122 | 26.09.2023 | Pershendetje<br>Ju shkruaj nga fshati Lin ku perpara disa muajsh jane bere shume denoncime ne lidhje me betonizimin e liqenit qe Kurre nuk kan marre zgjidhje<br>Nese do beni krahasime muajt kur Jane denoncuar deri me sot keto problematika Jane zmadhuar akoma me teper<br>Eshte mbushur liqeni beton dhe profile hekuri nuk di ku te drejtohemi tjeter nese ne kete portal nuk jep kush zgjidhje | | Deleguar Korces 27.09.2023 | | |
| 123 | 27.09.2023 | Më datën 26.09.2023 rreth orës 10.30 kam bërë ankesën tme tek Policia Bashkiake, IMT dhe tek Policia e Shtetit, për punime në kudështim me ligjin, ne flagrancë dhe duke me cënuar pronën tek pallati nr. 25, rruga “Frosina Plaku” hyrja 2 apartamenti 20. Dua tju sqaroj se: Ankesa e datës 29.10.2020 i ka të detajura të gjitha shkejet e firmes së ndërtimit “Kalaj” shpk të cilën ju duhet ta keni. Duke u ndodhur në këto kushte ku institucioni kopetent IMT me krye te korruptuarin Maringlen Qato, icli nuk zbatonte ligjin në fuqi por shumë përgjigje | | Deleguar tiranes 28.09.2023 | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | të tija ishin: se unë si institucion kam vendusur gjobat, dhe firma vazhdonte punët në shkelje të plot të ligjit. Firma ndërtuese “Kalaj” shpk nuk ka marrë dhe sot lejen e perdorimit nga Bashkia Tiranë. Këto shkelje vazhduan dhe në datën e më siperme dhe konkretisht: Veranda e apartamentit në katin e pestë në bashkëpunim firma e ndërtimit “Kalaj “shpk dhe blerësja Violeta Gjini në shkeje të projektit të miratuat nga Bashkia kanë bërë daljet hidraulike, elektrike me qëllim për ta mbulluar në të ardhmen dhe për ta kthyer në ambjet kuzhine. LLozha i këtij apartamenit është kthyer në tualet dhe për këto jane foto vidio të denancuara në Bashki dhe IMT por nuk ka pasur reagim. Reagimi i vetëm ishte gjoba. Me pasë firma në bashkëpunim me blerësin kanë ndërhyrë në fasadën e ventiluar të këtij pallati duke hequr pllakën e fasadës, kanë prerë shiritat mbajtëse të pllakës, kanë çarë betonin e soletës që është midis apartametit tim dhe apartamenti që bëri punimet, duke nxjerë hekurat dhe kanë bërë saldime duke vendosur një shirit metalik. Më | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | datën 26.09.2023 tentoi të vendosni një tendë, ku unë e denancova dhe ka ardhur në vendë ngjarje Policia Bashkiake, IMT dhe Policia e Komisariatit Nr. 2, të cilat ndaluan punimet deri sa të shprehej organi kopetent. Kam shkaur në Polici dhe kam bërë kallëzim për cënim të pronës dhe punime pa leje. Sot shkelësi i ligjit vazhdoi punën duke vendosur tendën. Dua të sqaroj me prova, fakte, të aktit ekspetimit si vijon…. Firma “Kalaj” shpk prej 4 vitesh eshte në gjykatë me pronarin e truallit i cili jam unë (Kastriot Çako), ku në këtë pallatë sipas perqindjes dhe kontratës kam marë 8 apartamente dhe një dyqan. Objekti i gjykimit është: 1. Punime në kundështim me projektin, 2. Punime në devjim të projektit, 3. Mos dorzim në afat 4. Cilësi të dobët të punimeve, të shoqëuara gjobë dhe nga IMT. Ekspetia e gjykatës ka konstatuar lagështirë në të gjithe apartamentet e mija dhe gjykata i ka bllokuar si provë, po ashtu po nga ekspertia është shkrehur se Firma nuk ka zbatuar projektin e miratuar nga Bashkia Tiranë, por ka bërë nje fasadë të ventiluar të kompozuar, Firma në | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | shkelje të ligjit nuk ka dorzon projektin për ndryshim të fasadës, ka punuar pa projekt. Këtë fakt e ka konstatuar dhe Bashkia dhe në një nga përgjigjet është shprehuar me vendim të Kryetarit te Bashkisë : Nuk i jepet leja e perdorimit për shum shkelje dhe një nga këto është dhe për fasadën ku thotë : Nuk ka paraqitur të gjithe elementët për ndryshim, mungon projekti artitektonik….Ndërsa ekspertia ka konstatuar se fasada është bërë e cilësisë të dobët nuk ka tipologji dhe kod të fasadës që ajo të bëjë krahasimin. Për këto nga ana ime keni me ankesa vidio, foto, emision invsetigativ të dërguar në Bashkinë Tiranë dhe IMT. Si rezultat lagështira futet nga fasada sepse firma ka bërë fasadën me kavallota 12, ka vendosur lesh te thjeshte pa membrane dhe pllakat janë me fugë të hapur. Kur bie shi nëpërmjet fugave futet shiu i cili lagë leshin dhe e depërton nëpër apartamente. Duke u ndodhur në këto kushte ku kemi:cënim të pronës prezencë e lagështirës e cila shtohet dhe nga vendosja e tendës sepse shiu perplaset siper tendës dhe e futet nëpërmjet fugave te fasadës duke shtuar | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | lagështirën. Në këto kushtë, deri sa të shprehet me vendim gjykata, ku ne kemi kërkuar riparimin e fasadës me projekt sipas kushteve teknike të zbatimit kërkoj nga IMT të verifikoj rastin dhe të zbatoj ligjin duke hequr këtë tendë të vendosur jashtë kushteve teknike të zbatimit, deri në pritje të vendimit të gjykatës. Kërkoj një përgjigje dfhe rëagim sa më të shpejtë nga ana juaj, Për çfar kam deklaruar mbaj përgjegjësi të plotë si kundër dhe organet kopetente, pasi mos veprimi dhe mos zbatimi i ligjit çon në vet gjyqësi.<br><br>Me respekt Kastriot Çako. | | | | |
| 124 | 28.09.2023 | Pershendetje,<br>Uroj që ky email t'iu gjej sa me mire!<br>Une jam e interesuar per një informacion ne lidhje me ndertimin e rruges që do të behet ne Kombinat, rruga At Stath Melani. Një pjese e ndertimit do të preke edhe token e shtepise dhe na eshte kerkuar te bejme një dorezim per verifikim dokumenti te prones. Une doja te dija nese dorezimi per verifikim prone duhet bere tek zyrat tuaja apo Jo. | 28.09.2023 | Pershendetje!<br><br>U njohem me kerkesen tuaj, ju bejm me dije se keto jane projekte te planifikuara nga Bashkia Tirane, per kete arsye duhet ti drejtohet IMT Bashkia Tirane per informacion te detajuar<br>Po ju informoj per dy emailet e Bashkise te cilet jane **edrejtaperinformim@tirana.al** si dhe **info@tirana.al** | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Ju lutem do e vleresoja shume nese do të kisha një pergjigje sa me shpejt,<br>Po ju bashkangjit dhe nr e kontaktit: 0675668967<br><br>Faleminderit,<br>Antonela Liço. | | Dite te mbare! | | |
| 125 | 28.09.2023 | Është kënaqësi t'ju përshëndes. Po ju shkruaj për të kërkuar informacion në lidhje me rregulloret aktuale që rregullojnë licencat për punimet dhe ndërtimet në Tiranë Njesi 8 , ( ligjet, vkm, normative lokale ).<br><br>Në veçanti, jam i interesuar të njoh aspektet e mëposhtme:<br><br>• Kufizimet kohore të zbatueshme për punimet dhe ndërtimet përsa i përket zhurmës, deri ne çfare ore lejohen punimet.<br>• Kërkesat dhe procedurat për marrjen e lejes së ndërtimit në Tiranë.<br>• Çdo rregull apo rregullore tjetër që ju e konsideroni të rëndësishme për | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | zhvillimin e përgjegjshëm të aktiviteteve të ndërtimit në pallat te banueshem.<br><br>Do vlerësoja shumë nëse mund ta jepnit këtë informacion brenda një afati të arsyeshëm kohor.<br>Mbetem në dispozicionin tuaj për çdo pyetje shtesë dhe marr përsipër të përdor me përgjegjësi informacionin e dhënë.<br><br>Me respekt,<br>Arber. | | | | |
| 126 | 28.09.2023 | Pershendetje dua te bej nje denoncim per ndertim pa leje ne ksamil nerrugen ksamil butrint prballe bankes tirana tek kodra e 26 marsit dy dyqane pa leje ju lutem merrni masat tel 0698628934 per sqarim me shume faleminderit. | | | | |
| 127 | 02.10.2023 | Besjona pershendetje,<br><br>Si fillim ju pergezoj per punen e mrekullueshme qe po beni.<br>Do doja te te pyesja per dicka nese mund te me ndihmosh!<br><br>Duke qen se une nuk kam shum informacion, doja tju pyesja, cilat | 02.10.2023 | Pershendetje!<br><br>U njohem me kerkesen tuaj per informacion, duke qene se territori i Tiranes mbulohet nga Bashkia Tirane ju bej me dije se duhet ti drejtoheni IMT Bashkia Tirane per informacion te detajuar. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | jan hapat qe duhet te ndjek per te vendosur nje kontenier te parafabrikuar ne shtepi?!<br><br>Disa me thone qe ka nevoj per leje ndertimi por duke mar parasysh qe eshte kontenier panel sanduic i parafabrikuar, nuk e di cfar leje ndertimi duhet sepse un po ndertoj, thjesht po e vendos brenda teritorit tim (shtepi private jasht qytetit te Tiranes) dhe eshte dicka qe mund ta leviz ne te ardhmen.<br><br>Disa me thone qe nuk ka nevoj per leje sepse esht thjesht kontenier.<br><br>Duke qen se jam teper konfuz rreth kesaj gjeje, a mundesh te me ndihmosh?<br><br>Faleminderit dhe jave te mbare.<br><br>---Faleminderit per Infon Besjona.<br><br>Te uroj gjithe te mirat, | | Po ju informoj keto jane dy emailet ku munde te drejtoheni Bashkise Tirane : **edrejtaperinformim@tirana.al** si dhe **info@tirana.al**<br><br>Dite te mbare! | | |
| 128 | 09.10.2023 | Përshëndetje, | 16.10.2023 | Pershendetje! | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Shpresoj të jeni mirë! Unë jam Sokol Dema, gazetar i kronikës së zezë në Report Tv. Referuar të drejtës për informim dhe interesit publik, jam i interesuar për informacione shtesë të një operacioni që IKMT ka kryer një ditë më parë (09 tetor 2023) në periferi të Tiranës, konkretisht në brendësi të kompleksit “Rolling Hills” në Lundër, për prishjen e disa objekteve të ndërtuara pa leje. Më poshtë keni të listuar pyetjet që unë dhe Report Tv jemi të interesuar:<br><br>- Sa është numri ekzakt i këtyre objekteve që IKMT ka prishur?<br>- Kush janë pronarët e këtyre objekteve?<br>- Sa kohë kishin që ishin ndërtuar?<br>- Janë ndërtime vila nga fillimi, apo shtesa në ndërtime ekzistuese?<br><br>Duke iu falënderuar shumë për mirëkuptimin, shpresoj në një kthim përgjigje të shpejt nga ana juaj.<br><br>Sokoli | | U njohem me kërkesën tuaj per informacion sipas të cilës kerkoni informacione shtesë të një operacioni që IKMT ka kryer date 09 tetor 2023 në periferi të Tiranës, konkretisht në brendësi të kompleksit “Rolling Hills” në Lundër, për prishjen e disa objekteve të ndërtuara pa leje. .”ku kërkoni:<br>- Sa është numri ekzakt i këtyre objekteve që IKMT ka prishur?<br>- Kush janë pronarët e këtyre objekteve?<br>- Sa kohë kishin që ishin ndërtuar?<br>- Janë ndërtime vila nga fillimi, apo shtesa në | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ndërtime<br>ekzistuese?<br><br>Ju informoj si me poshte :<br>*Sa është numri ekzakt i këtyre objekteve që IKMT ka prishur?*<br>Jane dy objekte te ekzekututara nga IKMT.<br>*Kush janë pronarët e këtyre objekteve?*<br>Ashtu sic jeni infomuar edhe nga Policia e Shtetit pronat ju perkasin shtetasve E.T dhe A.V<br>*Sa kohë kishin që ishin ndërtuar?*<br>Objektet ishin ne proces ndertimi.<br>*Janë ndërtime vila nga fillimi, apo shtesa në ndërtime ekzistuese?*<br>Ndertimet jane shtesa ne objekte egzistuese. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Dite te mbare! | | |
| 129 | 10.10.2023 | Pershendetje ,<br>Jam Franceska Miraka banore ne Durres Plazh lagja 13 Rruga Apulia. Bashkengjitur mund te shifni nje njoftim qe kam marre nga inspektoriati i mbrojtjes se territorit.<br>Doja informacion nlidhje me pjesen se ku duhet te drejtohem per vleresimin dhe kompensimin per pjesen e cila do te prishet ke shtepia ime per rikonstruktimin e rruges. | 10.10.2023 | Pershendetje!<br><br>U njohem me kerkesen tuaj per informacione, keto jane projete te miratuara nga Bashkia Durres, te ciles edhe mund ti drejtoheni per informacione te detajuara.<br>Ju informoj se Koordinatori per te Drejten e informimit per Bashkine Durres ka kete adrese emaili vilma.hyseni@durres.gov.al<br><br>Dite te mbare! | | |
| 130 | 15.10.2023 | Pershendetje!<br><br>Uroj te jeni mire, emali juaj eshte vendosur ne webfaqen zyrtare te Ikmt.<br><br><br>Une jam nje qytetar dhe dua te shtroj nje pyetje per ju nese mund te me ndihmoni?<br><br>1.Sa eshte distaca nga kufiri i prones qe nje kufitar ose i then komshi duhet te mbaje per hapjen e nje dritarje ne godinat 1 | 16.10.2023<br><br>17.10.2023 | Pershendetje!<br><br>U njohem me kerkesen tuaj per infromacion, ju informoj qe per te mare pergjigjen e duhur duhet ti drejtoheni Bashkise tuaj e cila eshte pergjegjese per tarritorin qe mbulon.<br>(nese ju nuk gjeni dot adresen e emailit te Korrdinatorit per te Drejten e Informimit te Bashkise ku ju beni pjese, na shkruani qe tiu nis emailin)<br>Dite te mbare! | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kateshe? Dhe sa e madhe duhet te jete dritarja?<br><br>2.Po nese kufitari ose i then komshi llojin e prones e ka repart pune tip lavazh ne zone te banuar sa eshte distanca qe duhet te kete me kufirin e prones time per hapejen e nje dritarje?<br><br>Do e vlersoja tej mase nje pergjigje nga ana juaj.<br><br>Gjithe te mirat dhe jam ne pritje.<br><br>--Pershendetje Besjona,<br><br>Ju falenderoj shume per pergjigjen, nese mundeni ju lutem a mund te me dergoni emailin e personit pergjigjes ke duhet te pyes per kete tematik?<br>Mirnjohes dhe pune te mbare sot.<br>Ne pritje.<br><br>--Ju kerkoj shume ndjes, por mendova qe eshte ne signature por se di pse nuk e ka marre.<br><br>Jam pjese ne Bashkine Durres.<br>Faleminderit per durimin. | | --Ju nuk me keni informuar ne cilen bashki jeni pjese, pa pasur informacionin kryesor ( Bashkine) nuk kam si ju jap adrese emaili<br><br>--Pershendetje!<br><br>Adresa e emailit te Kordinatorit per te Drejten e Informimit per Bashkine Durres eshte :<br>vilma.hyseni@durres.gov.al | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 131 | 19.10.2023 | Pershendetje ,<br>Kam marre nje mase administrative nga institucioni Juaj, doja tJu pyesja ku mund ta bej pagesen ?<br>Faleminderit!<br><br>--A do me duhet ta paraqes diku mandatin e pageses? | 19.10.2023 | Pershendetje!<br><br>Sipas fatures bashkelidhur aktit ju mund ta paguani ne cdo banke qe ju mund te keni.<br>Dite te mbare!<br><br>--Po, mund ta dergoni ne kete adrese emaili me foto. | | |
| 132 | 31.10.2023 | Pershendetje!<br><br>Bashkelidhur po dergojme nje kopje te kerkeses ankinore te shoqerise "Riku Konstruksion" sh.p.k., se bashku me dokumentacionin e nevojshem per shqyrtimin e saj.<br><br>Shpresojme ne nje trajtim te shpejte te kesaj kerkese!<br><br>Ju faleminderit! | 31.10.2023 | Pershendetje!<br><br>Ju lutem ridergoni edhe nje here materjalin pasi nuk hapet (Nuk shfaqet) qe te lexohet dhe shqyrtohet<br><br>Faleminderit. | | |
| 133 | 30.10.2023 | Kërkoj ndërhyrjen e menjëhershme nga ana e instutucionit Tuaj për zgjidhjen e problemit me të cilin jam hasur në mënyrë të papritur më datë 28. 10. 2023.<br>Në vazhdim të punimeve për Unazën e Madhe, gjatë prishjes së shtëpive të Z. Bajram Myftari | 06.11.2023 | Pershendetje!<br><br>Pasi u njohem me ankesen tuaj, ju informoj se kjo problematike eshte deleguar per verifikim prane Drejtorise Ekzekutimit e cila na infomon si me poshte: | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dhe Z. Mentor Malushi, në Rrugë "Dalip Topi", shtëpia e prindërve të mi ka pësuar dëmtime të mëdha, të dukshme në pjesën më të madhe të sipërfaqes së saj.<br>Ne disponojmë dokumentacionin e rregullt ligjor të banesës e cila ndodhet afër planit të rrugës, por nuk preket prej saj.<br>Të gjendur në këtë situatë dhe shumë të shqetësuar kërkojmë ndërhyrjen e shpejtë nga ana juaj në zgjidhjen e këtij problemi.<br><br>Bashkëngjitur do të gjeni edhe pamje (foto) të gjendjes së banesës.<br><br>Për inspektimin nga ana juaj ne banese ju lutem me njoftoni paraprakisht, për arsye se do të doja të isha dhe vete i pranishem dhe jo në cdo moment të dites jam aty për shkak te marredhenieve të punës.<br><br>Mbetem në pritje të një përgjegje nga ana juaj!<br><br>Me respekt,<br><br>Ferid Kolbuçaj | | • Me date 26.10.2023 eshte ekzekutuar prishja e baneses se shtetasit Bajram Myftari, ku nga ana e grupit te punes se ngarkuar per kete proçes nuk janë evidentuar / konstatuar dëme te pretenduara nga ankuesi ( në lidhje me demtimin e objekteve kufitare).<br><br>• E gjithe kjo praktike pune eshte e pasqyruar ne procesverbal nga ku nuk ka shenime te veçanta lidhur me problematiken | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Cel: 0684294440 | | qe ju pretendoni..<br><br>Ju faleminderit! | | |
| 134 | 20.11.2023 | Në kuadër të transparencës publike, duke u bazuar tek ligji për të drejtën e informimit nr. 119/2014, emisioni “Vetting” kërkon si informacion:<br><br>1. Njollën e hartës ku po i zhvillon punimet kompania “ADRIATIC UNION” shpk, e cila ka marrë leje zhvillimi nga Këshilli Kombëtar i Territorit në zonën bregdetare të qytetit të Durrësit.<br><br>2. Vendndodhjen e kantierit ku kanë filluar punimet.<br><br>Kjo kërkesë bazohet në ligjin e sipërpërmendur, i cili shprehet: “Kërkuesit i vihet në dispozicion një kopje e plotë e dokumentit zyrtar, për të cilin kërkon të informohet.” Duke u bazuar në ligjin nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit” këto informacione vihen në dispozicion të publikut | 24.11.2023 | DURRESIT<br><br>To:Vetting <vettingnews24@gmail.com><br>Pershendetje!<br><br>Ne vijim te kerkeses tuaj, ju infomoj se kerksa eshte deleguar per verifikim e trajtim prane Drejtorise Rajonale IKMT Durres e cila na ve ne dijeni si me poshte: *Ne lidhje me kerkesen e emisionit "Vetting" News 24 , pas verifikimeve te grupit te inspektimit ne terren Lagja 13, Plazh, nuk rezulton te kete asnje kantier ne zhvillim nga shoqeria "ADRIATIK UNION" ne adresen e kerkuar.*<br><br><br>Dite te mbare! | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | pa kërkesë specifike dhe të arsyetuar”.<br><br>Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, Drejtor Agim Baçi!<br><br>Për çdo pyetje mund të kontaktoni në Cel-tel: 0682071825<br><br>E-mail: vettingnews24@gmail.com | | | | |
| 135 | 20.11.2023 | Në kuadër të transparencës publike, duke u bazuar tek ligji për të drejtën e informimit nr. 119/2014, emisioni “Vetting” kërkon si informacion:<br><br>1. a) A ka leje ndërtimi subjekti “ELMAND CO” me pronar Astrit Hysën që po zhvillon resort në rrugën “Plazh 13” në Durrës?<br><br>b) Kopje të lejes së ndërtimit nëse ky subjekt e ka.<br><br>2. Kopje të dokumentit që ka lejen e zhvillimit nga Këshilli Kombëtar i Territorit. | | DURRESIT | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Kjo kërkesë bazohet në ligjin e sipërpërmendur, i cili shprehet: “Kërkuesit i vihet në dispozicion një kopje e plotë e dokumentit zyrtar, për të cilin kërkon të informohet.” Duke u bazuar në ligjin nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit” këto informacione vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë specifike dhe të arsyetuar”.<br><br>Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, Drejtor Agim Baçi!<br><br>Për çdo pyetje mund të kontaktoni në Cel-tel: 0682071825<br><br>E-mail: vettingnews24@gmail.com | | | | |
| 136 | 22.11.2023 | Përshëndetje,<br><br>Kemi paraqitur një ankim administrativ (*shih bashkëlidhur*) pranë IKMT dhe IMT Bashkia Kukës, për të cilën nuk ka asnjë reagim sot e kësaj dite. | | KUKESIT | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Ndërkohë, me datë 15nëntor 2023 (*shih linkun më poshtë*) policia dhe IKMT në Kukës nis një aksion për prishjet e ndërtimeve pa leje në Kukës dhe objekti i denoncuar nga klienti ynë nuk preket<br><br>Link:<br>Ndërtimet pa leje, Balla: Policia dhe IKMT po rrisin vigjilencën, s'ka tolerancë për askënd që shkel ligjin<br><br>[redacted]<br><br>**Ndërtimet pa leje, B**<br>**IKMT po rrisin vigj** | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Ministri i Brendshëm Taulant Balla ka reaguar në lidhje me krimet mjedisore<br><br>Nuk e kuptojmë sjelljen selektive që po bëhet, ndaj jeni të lutur të na përcillni një informacion zyrtar lidhur me denoncimin e paraqitur.<br><br>Me respekt,<br><br>Av.Eralda Kalemaj, studio ligjore "HLE" shpk | | | | | |
| 137 | 24.11.2023 | Të nderuar,<br>Më poshtë po ju sjell një Kërkesë për Informacion mbi punimet për portin e portit të hidrokarbureve në Porto-Romano, Durrës, nga “Shoqëria koncesionare Porti MBM (Multi Buoy Mooring)”.<br><br>Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.<br>Me respekt, | | DURRESIT(13.12.2023) | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Erjola Azizolli/ gazetare pranë Medias Amfora | | | | |
| 138 | 09.12.2023 | persh ju uroj nj dite te mbare..pash ne faqen e inspektoriatit t mjedisit qe kishte mundesi punesimi ne qytetin e vlores ku mund t mar me shum info rreth vendit te punes | | Deleguar BURIMEVE NJERZORE | | |
| 139 | 09.12.2023 | Pershendetje<br>Gjeni bashengjitur CV time nese jeni duke kerkuar staf per specialist<br>Ne pritje te nje interviste<br>Gjith te mirat | | Deleguar Burimeve Njerzore | | |
| 140 | 09.12.2023 | Une Zaim Hysenaj administrator I shoqerise AL-EN 2000 kam bere nje ankese me dt 16/11/2022 nr 1365 prot prane IMT Kavaje dhe me dt 28/12/2022 me nr 5804 prane IKMT Tirane per zaptim prone nga ndertime te paligjshme ne zonen golem kavaje pjesa ballore e parceles 41 por deri tani nuk kam marre asnje pergjigje per zgjifhjen e ankeses sime.<br>Ju lutemi merrni masat e duhura ligjore per lirimin e prones time. Dokumentet ligjore jane te gjitha te arshivuara ne ankesen e dates 28.12.2022 me nr.5804.prot. | | IKMT TIRANE<br>Pershendetje,<br><br>Lidhur me ankesen e ardhur ne menyre elektronike nga Z.Naim Hysenaj, bejme me dije se Drikmt Tirane i eshte drejtuar me shkresen nr. 823/3 prot., date 22.11.2023 ASHK-Drejtoria Vendore Kavaje, ku kerkojme konfirmim mbi vertetesine dokumentacionit “Kerkese per legalizim te ndertimit pa leje me nr. Aplikimi 21023 date 07.10.2021. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Bashkelidhje kopje e shkreses! | | |
| 141 | 13.12.2023 | Pershendetje Znj. Cenaj<br><br>Ne pergjigje te kerkeses se institucionit tuaj Nr. Protokolli 11487 me date 04/12/2023 bashkengjitur gjeni dokumentat e kerkuara!<br>Lutem kalimin e dokumentave tek kryeinspektori Z. Herion Rrapaj.<br>Nese ju duhet informacion tjeter lutem me shkruani!<br><br>Faleminderit,<br>Gentian Sinakoli | 15.12.2023 | Pershendetje!<br><br>Ne vijim te emailit tuaj, ju informoj se ne baze te te dhenave qe ju keni derguar rezulton se ky email duhet te ishte derguar prane Inspektoratit te Mbrojtjes se Territorit prane Bashkise Tirane.<br><br>Dite te mbare! | | |
| 142 | 19.12.2023 | Të nderuar,<br><br>Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë letër si një shprehje të shqetësimit tonë serioz në lidhje me një ankesë të dorëzuar më datë 27 gusht, për të cilën ende nuk kemi marrë një përgjigje nga autoritetet përgjegjëse. | 20.12.2023 | Pershendetje<br><br>Ne vijim te ankes tuaj , ju bejme me dije se problematika eshte deleguar per trajtim ne IKMT Drejtoria Rajonale Durres, e cila ma informon se ka percjelle rastin per ndjekje IMT Bashkia Durres me shkresen Nr 454 Prot date 28.08.2023 dhe ka mare kthim | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Ne kemi pasur një pritje të gjatë dhe të palogjikshme për një përgjigje në lidhje me ankesën tonë, dhe ky vonim na ka shqetësuar shumë. Ne e kemi paraqitur ankesën tonë me shpresën që do të ketë një përgjigje efikase dhe zgjidhje të menjëhershme për situatën e shqetësuar.<br><br>Ne nuk kuptojmë arsyen e vonimit dhe mungesën e përgjigjes nga ana e institucioneve përgjegjëse. Në situata të tilla, ka rëndësi që autoritetet të jenë të vendosura për të vepruar menjëherë dhe të sigurojnë transparencë dhe drejtësi për të gjithë qytetarët.<br><br>Nëse nuk marrim një përgjigje të menjëhershme dhe të qartë në lidhje me këtë ankesë, ne do të detyrohemi të përdorim rrugët ligjore dhe të angazhojmë avokatët tanë për të mbrojtur interesat tona në këtë çështje.<br><br>Ju falenderojmë për kohën dhe vëmendjen tuaj në këtë çështje. Presim me padurim një përgjigje | | pergjigjen me nr 1344/1 date 18.09.2023<br>Bashkangjitur shkresat cituar me lart.<br><br>Dite te mbare! | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | sa më të shpejtë dhe të qartë nga ana juaj.<br><br>Me respekt, | | | | |
| 143 | 28.12.2023 | Zonje e nderuar,<br><br>quhem Teuta dhe posedoj ne Shetaj/Kepi i Rodonit nje apartament i cili eshte mare ne dorezim ne mes te vitit 2020. Apartamenti i cili frekuentohet vetem kur jemi me pushime ne vere ndodhet 30 m nga bregu i detit. Gjate qendrimeve tona kemi pare qe muri qe ndan dy dhomat/mur mbajtes ka shfaqur shenja krisje. Vit pas viti keto krisje vertikale jane riparuar nga jasht por pa sukses pasi kete vit konstatojme krisje qe ngjajne me sy te lire me carje tashme jo vetem vertikale por dhe horizontale.<br>Nisur nga kjo gjendje jam e detyruar te drejtohem prane jush si institucion me kerkesen per te ngritur nje grup specialistash te afte per te gjykuar gjendjen reale ne vend.<br>Ne pritje te nje pergjigje nga ana Juaj ju lutem pranoni Zonje | 03.01.2024 | Pershendetje!<br><br>U njohem me ankesen tuaj, IKMT mision Iju informoj ti drejtoheni Bashkise perkatese, Drejtorise se Urbanistikes ose Institutit te Ndertimit per trajtimin e verifikimin e ankeses tuaj.<br><br>Duke ju falënderuar për mirëkuptimin. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | pershendetjet mia me te sinqerta.<br>Teuta Nicolet | | | | |

Shënim:
[1] Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve
[2] Data e regjistrimit të kërkesave
[3] Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
[4] Data e kthimit të përgjigjes
[5] Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
[6] Përgjigja jepet E plotë/E kufizuar/E refuzuar/E deleguar
[7] Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuara nga autoriteti publik.